



Banka Popullore
e Republikës së Maqedonisë së Veriut

RAPORTI VJETOR I VITIT 2023

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut



Raport vjetor i vitit 2023

Shkup, prill 2024

Përmbajtja

Fjalimi i guvernatores	4
I. Politika monetare më 2023	8
1.1. Qëllimet e politikës monetare.....	8
1.2. Pozicionimi i politikës monetare.....	9
II. Mjedisi ndërkombëtar	14
III. Lëvizjet makroekonomike në vitin 2023.....	18
3.1. PBB-ja dhe inflacioni	19
3.2. Tregu i punës	22
3.3. Financat publike.....	24
3.4. Bilanci i pagesave, MIP dhe borxhi i jashtëm	27
3.5. Agregatët monetarë dhe kreditorë	33
3.5.1. Agregatët monetarë.....	33
3.5.2. Aktiviteti kreditor	35
IV. Mjedisi makroekonomik dhe politika monetare në periudhën 2024 - 2026	38
V. Instrumentet monetare	41
Shtojca 1. Lëvizjet e tregut valutor dhe investimet e Bankës Popullore	44
Shtojca 2. Lëvizjet në tregun ndërbankar të depozitave pa kolateral dhe në tregun sekondar të letrave me vlerë.....	46
VI. Menaxhimi dhe investimi i rezervave valutore.....	49
6.1. Gjendja dhe ndryshimet e rezervave valutore.....	49
6.2. Kushtet e tregjeve financiare ndërkombëtare dhe qasja aktive për investimin e rezervave valutore	50
6.3. Struktura e rezervave valutore	51
6.4. Rezultatet e menaxhimit dhe të investimit të rezervave valutore	53
VII. Shërbime e pagesave dhe sistemet e pagesave	56
7.1. Transaksionet e pagesave pa para të gatshme	57
7.1.1. Transaksionet pagesore me transfertë krediti të iniciuara nga persona fizikë dhe juridikë në vend	58
7.1.2. Kartela pagesore	59
7.1. Infrastruktura pagesore.....	60
7.2. Sistemet e pagesave në vend.....	61
7.4. Aktivitetet mbikëqyrëse mbi sistemet e pagesave	62
VIII. Emetimi dhe menaxhimi i kartëmonedhave dhe monedhave të Republikës së Maqedonisë së Veriut - operacionet e thesarit	63
8.1. Paratë e emetuara në qarkullim	63

8.2.	Furnizimi i bankave dhe qendrave të parave të gatshme me kartëmonedha dhe monedha.....	65
8.5.	Kontrolli i zbatimit të standardeve dhe kriterëve për operacionet me para të gatshme në banka dhe qendrat e parasë së gatshme	67
IX.	Auditimi i brendshëm	68
9.1.	Funksionimi i Komitetit të Auditimit.....	69
X.	Menaxhimi i burimeve njerëzore.....	70
XI.	Zbatimi i Programit të Punës për vitin 2023	72
	Qëllimi Strategjik 1 - Përmirësimi i infrastrukturës për udhëheqje të politikës monetare.....	74
	Qëllimi Strategjik 2 – Ruajtja dhe forcimi i mëtejshëm i stabilitetit dhe rezistencës së sistemit bankar	75
	Qëllimi Strategjik 3 – Mbështetja e popullsisë dhe sektorit korporativ nëpërmjet zhvillimit të sistemeve të pagesave të sigurta, inovative dhe efikase	77
	Qëllimi Strategjik 4 – Përmirësimi i politikës investuese dhe sigurimi i kthimit optimal të rezervave valutore në pajtim me parimet e sigurisë dhe likuiditetit	78
	Qëllimi Strategjik 5 - Përshtatje ndaj standardeve të Sistemit European të bankave qendrore ...	79
	Qëllimi Strategjik 6 – Rritje e transparencës dhe llogaridhënies.	80
	Qëllimi Strategjik 7 – Edukim financiar dhe përfshirja	84
	Qëllimi Strategjik 8 - Rritja e vetëdijes për ndryshimet klimatike dhe kontributi për ekonomi të qëndrueshme të gjelbër.....	88
	Qëllimi Strategjik 9 - Forcimi i udhëheqjes me rreziqet në nivel të Bankës Popullore	89
	Kapaciteti institucional: Integriteti dhe besimi në njësinë monetare kombëtare.....	91
	Kapaciteti institucional: Burime njerëzore	91
	Kapaciteti institucional: Sistemi i informacionit.....	92
	Kapaciteti institucional: Të dhënat statistikore	92
	Kapaciteti institucional: Veprimtari hulumtuese	93
	Shtojca 3. Ekspozimi ndaj rreziqeve klimatike dhe efektet e investimeve të qëndrueshme të rezervave valutore	93

Fjalimi i guvernatores

Të nderuar!

Në vitin 2023, ekonomia globale u stabilizua gradualisht pas goditjeve të njëpasnjëshme me të cilat u përball në vitet e mëparshme. Trysni të mbi bankat qendrore u lehtësuan, pasi inflacioni u ngadalësua vazhdimisht gjatë gjithë vitit. Kushtet e shtrënguara monetare dhe normalizimi i kushteve në tregjet botërore të produkteve primare ndikuan në këtë lehtësim gradual të trysnive inflacioniste, sidomos karakteristike për gjysmën e dytë të vitit. Vazhdon të vihet re një rimëkëmbje globale, me njëfarë rezistence ndaj rreziqeve aktuale dhe kushteve financiare më të shtrënguara, si pasqyrim i lëvizjeve të favorshme në kahun e ofertës. **Pavarësisht këtyre prirjeve të stabilizimit gradual, pasiguria dhe rreziqet vazhduan gjatë tërë vitit 2023.** Tendosjet gjeopolitike ishin veçanërisht të theksuara, duke shkaktuar fragmentim të mëtejshëm ekonomik global. U theksuan gjithashtu sfidat që lidhen me nevojën për transformimin strukturor të ekonomive dhe rritjen e produktivitetit të tyre, si dhe ato që lidhen me tranzicionin e gjelbër dhe forcimin e rezistencës klimatike.

Gjatë vitit 2023, Banka Popullore mori masa edhe për ruajtjen e stabilitetit të kursit valutor, uljen e mëtejshme të inflacionit dhe stabilizimin e pritshmërive inflacioniste. Më 2023 vazhduam me rritjen graduale të normës bazë të interesit në nivelin 6.3%, ndërsa në të njëjtën kohë bëmë ndryshime në instrumentin e rezervës së detyrueshme dhe politikën makroprudenciale, të cilat ofrojnë mbështetje shtesë për sinjalet monetare. Përmes ndryshimeve në rezervën e detyrueshme kemi rritur më tej normën e rezervës së detyrueshme të detyrimeve valutore të bankave. Me këtë veprim me qëllim të caktuar dhe inkurajuar kursimin në valutën vendase, pra "denarizimin" më të madh, proces i cili u ndal përkohësisht në mesin e vitit 2021. **Me anë të masave makroprudenciale** siguroam një forcim të mëtejshëm të rezistencës së sistemit bankar, i cili është baza e stabilitetit financiar dhe parakusht për mbështetjen e pandërprerë financiare të ekonomisë nga sistemi.

Kjo qasje në drejtimin e politikës, me një kombinim të përshtatshëm të instrumenteve të disponueshme, bëri të mundur përballimin me sukses të inflacionit, pa rrezikuar ndjeshëm rimëkëmbjen ekonomike apo stabilitetin financiar. Në fund të fundit, në dy vitet e fundit, arritja e kësaj baraspeshe ishte një sfidë e madhe për të gjitha bankat qendrore. **Treguesit e inflacionit më 2023** sugjerojnë një lehtësim gradual të inflacionit, i cili nga niveli më i lartë prej 19,8%, në tetor të vitit 2022, u ul në 3,6%, në fund të vitit 2023. Hendeku i inflacionit me Eurozonën u ngushtua ndjeshëm, si një spirancë e jona monetare. Në fakt, për shkak të karakteristikave tona strukturore, kur ka goditje të forta në tregjet botërore të ushqimit dhe të energjisë, ne i ndjejmë efektet e para shumë më shpejt dhe më drejtpërdrejt se Eurozona, që çon në një kërcim të përkohshëm të rritjes së inflacionit. **Pozicionimi i përshtatshëm i politikës, si dhe normalizimi i çmimeve në tregjet botërore kontribuan në një treg të qëndrueshëm dhe të favorshëm valutor dhe në ndërhyrjet në blerjen e valutave.** Pozicioni i jashtëm i ekonomisë u forcua ndjeshëm, duke pasqyruar përmirësimin e kushteve të këmbimit, besimin në valutën vendase, si dhe perceptimet pozitive të investuesve të huaj. Në këtë kontekst, lëvizjet e tregut valutor ishin të favorshme, ndërsa blerja neto nga Banka Popullore është e ngjashme me vitet e parakrizës. Kjo siguroi rritje solide të rezervave valutore, krahas ruajtjes së mëtejshme të stabilitetit të kursit valutor të denarit.

Masat dhe politikat e Bankës Popullore kontribuan në ruajtjen e stabilitetit financiar, i cili është parakusht për një ekonomi të qëndrueshme, rritje dhe zhvillim

ekonomik. Për të forcuar më tej qëndrueshmërinë e sektorit bankar, Banka Popullore miratoi një masë makroprudenciale për të rritur normën e **shtresës mbrojtëse kundërciklike** të kapitali për ekspozimet e bankave vendase me 0,25 pikë përqindjeje, nga 0,75% në 1% të përcaktuar më parë, me fillimin e zbatimit nga 1 korriku 2024, si dhe mori vendim për futjen e **masave makroprudenciale për cilësinë e kërkesës kreditore**, në përputhje me praktikën europiane. Me miratimin e [Strategjisë së zbatimit të politikës makroprudenciale](#), në Republikën e Maqedonisë së Veriut u forcua qasja e koordinuar e rregullatorëve financiarë për të forcuar më tej stabilitetin financiar. Gjithashtu, u miratua edhe [Ligji i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mbi Bankat](#) si ligj sistemor nga sfera financiare, e me të cilin kontribuohet në ruajtjen dhe forcimin e mëtejshëm të stabilitetit financiar.

Treguesit e sistemit bankar tregojnë një qëndrueshmëri të fortë dhe aftësi për t'u përballur me rreziqet që ekzistojnë ende. Mjaftueshmëria e kapitalit të bankave në vitin 2023 arriti në 18,4% dhe është në nivelin më të lartë në 17 vitet e fundit, që është thelbësore për ruajtjen e stabilitetit në përballjen me rreziqet e mundshme, por edhe nga aspekti i kreditimit dhe të mbështetjes së qytetarëve dhe të firmave. Portofoli kreditor i bankave është i cilësisë së mirë dhe nuk u vërejtën shenja të një realizimi të konsiderueshëm të rrezikut kreditor, kurse pjesëmarrja prej 2,8% e kredive me probleme në totalin e kredive është në nivelin e minimumit historik.

Mënyra e drejtimit të politikës monetare nga ana e Bankës Popullore, si dhe ruajtja e stabilitetit financiar, u vlerësuan pozitivisht nga institucionet e rëndësishme ndërkombëtare. Kështu, në kuadër të konsultimeve të rregullta që dalin nga anëtarësimi i vendit në **Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN)**, si dhe në kuadër të debateve për [Rishikimin e parë të linjës së kredisë së kujdesshme dhe likuiditetit \(PLL\)](#), misioni i FMN-së arriti në përfundimin se Banka Popullore mori masat e duhura për shtrëngimin e politikës monetare, e cila siguroi një përgjysmim të inflacionit në krahasim me maksimumin e vitit të kaluar. Në [Raportin vjetor për vendin më 2023, Komisioni European](#) ritheksoi se harmonizimi në fushën e politikës monetare me rregulloret, standardet dhe praktikën europiane është në nivel të avancuar. **Komiteti i Ekspertëve të Këshillit të Europës për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe të Financimit të Terrorizmit ("Moneyval")** vlerësoi se sistemi i licencimit dhe mbikëqyrjes së Bankës Popullore përmbush standardet ndërkombëtare për luftimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit. Kontribut të rëndësishëm në vlerësimin pozitiv dhanë aktet e shumta nënligjore të miratuara nga Banka Popullore dhe trajnimet e zhvilluara për rritjen e efikasitetit në funksionimin e institucioneve financiare, ndërsa në të njëjtën kohë u vlerësuan pozitivisht edhe masat korrigjuese të Bankës Popullore për përmirësimin e cilësisë së operacioneve të institucioneve financiare në luftën kundër pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit. Mirënjohje për punën e Bankës Popullore mbërriti edhe nga **Banka Qendrore Europiane (BQE)**, e cila edhe në këtë vit mori vendim [për qasje të mëtejshme të bankës tonë qendrore në linjën repo deri më 31 janar 2025](#). Në këtë mënyrë sigurohet qasje e shpejtë në likuiditetin valutor, i cili është një tjetër shtresë mbrojtëse për të garantuar stabilitetin e kursit të këmbimit valutor.

Besimi i publikut është jashtëzakonisht i rëndësishëm për kryerjen e duhur të aktiviteteve të bankës qendrore. Prandaj, për ne ishte veçanërisht e rëndësishme që besimi i publikut në Bankën Popullore u konfirmua në kuadër të **sondazhit të vitit të kaluar të Grupacionit të Bankës Botërore. Sipas këtij hulumtimi**, u konstatua se besimi i qytetarëve dhe i institucioneve në bankën tonë qendrore është në një nivel më të lartë se në disa institucione ndërkombëtare. Gjithashtu, përkundër goditjeve të shumta, vlerësimi është më i lartë krahasuar me vitin 2019, çka është një konfirmim i besimit të publikut në mënyrën se si Banka Popullore i ka menaxhuar krizat në periudhën e kaluar.

Krahas masave për ruajtjen e stabilitetit financiar dhe të çmimeve dhe, ekipi i bankës qendrore punoi shumë në disa fusha, të cilat janë gjithashtu brenda objektivave tona strategjike si një institucion modern, transparent dhe me përgjegjësi shoqërore. Gjatë vitit të kaluar **ne punuam në mënyrë aktive për sqarimin e lajmeve në kuadrin e tregut të shërbimeve të pagesave dhe veçanërisht për sqarimin e shërbimeve të reja inovative të pagesave dhe të përfitimeve për qytetarët.** Për këtë qëllim vendosëm një [vegël të re për krahasimin e kompensimeve ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave](#) me të cilin kontribuojmë për një transparencë më të madhe të bankave dhe për përmirësimin e ndërgjegjësimit të publikut për tarifat e ngarkuara nga bankat, për shërbimet më përfaqësuese që lidhen me llogarinë e pagesave. Për të ofruar mbrojtje më të madhe të konsumatorit, ne miratuam [Qarkore për Institucionet Financiare](#) për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve dhe të praktikave të mira për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të konsumatorëve gjatë përdorimit të shërbimeve financiare nga sektori bankar i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në këtë mënyrë krijohen praktika të mira në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit, duke u zotuar për marrëdhënie të drejta dhe transparente, bazuar në informacione të qarta dhe lehtësisht të kuptueshme për produktet dhe shërbimet që ata ofrojnë. Në të njëjtën kohë filluam me kontrole të posaçme në terren të bankave për të mbrojtur konsumatorët, për të ndjekur funksionimin e tyre dhe qasjen ndaj klientëve.

Vetëdija për nevojën e edukimit financiar në sistemin modern dinamik financiar ishte edhe shtytës i shumë aktiviteteve të Bankës Popullore këtë vit. Krahas aktiviteteve të rregullta, Banka Popullore mbështeti edhe disa nisma të tjera në fushën e edukimit financiar, me kërkesë të veprimtarëve të ndryshëm të shoqërisë, duke hapur dyert si për më të rinjtë, ashtu edhe për të moshuarit.

Viti që kaloi u shënua edhe me forcimin e ndërgjegjësimit kolektiv drejt zbatimit të politikave të qëndrueshme ekonomike që synojnë ekologjinë. Në këtë kontekst, Banka Popullore vazhdoi edhe me aktivitete që mundësojnë ngritjen e vetëdijes për rreziqet e ndryshimeve klimatike. Kështu, me miratimin e [Planit afatmesëm të aktiviteteve të Bankës Popullore në fushën e menaxhimit të rreziqeve që lidhen me ndryshimet klimatike për periudhën 2023 - 2025](#), u vendos një kornizë gjithëpërfshirëse për menaxhimin e rrezikut të ndryshimeve klimatike, e cila parashikon më shumë aktivitete në fushën e rregullimit dhe të mbikëqyrjes së rrezikut klimatik, duke përfshirë testin e stresit të lidhur me ndryshimet klimatike të bankave vendase. Zbatimi i Planit Afatmesëm do të kontribuojë për të kuptuar më mirë rreziqet klimatike, për t'i përfshirë në analizat e sistemit bankar dhe në politikën monetare, si dhe për të ndërtuar një sistem bankar rezistues që do të jetë në gjendje të mbështesë tranzicionin e ekonomisë në të atë të gjelbër dhe të qëndrueshëm. Si pjesë e aktiviteteve të Planit, Banka Popullore miratoi edhe [Udhëzimet për menaxhimin e rreziqeve që lidhen me ndryshimet klimatike](#), të cilat bankat e biznesit do t'i marrin parasysh gjatë formulimit dhe zbatimit të strategjisë së tyre të biznesit dhe gjatë procesit të menaxhimit të rrezikut.

Në kohën e revolucionit të katërt industrial, ku zhvillimi vjen nga digjitalizimi, intelijenca artificiale dhe automatizimi, progresi është i nevojshëm edhe në transformimin digjital të ekonomisë, i cili do të rrisë efikasitetin, produktivitetin, inovacionin dhe konkurrencën. Komisioni i Mbështetjes së Zhvillimit të Inovacioneve në Sistemin Financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut (Komiteti i Sektorit Fintech), që drejtohet nga Banka Popullore, në vitin 2023 miratoi të parën [Strategji për rregullatorët financiarë të sektorit fintech](#), që synon të sigurojë kushte për të mbështetur risitë në fushën e financave, duke marrë parasysh mbrojtjen e konsumatorëve dhe të investuesve dhe stabilitetin e sistemit financiar. Strategjia e miratuar për rregullatorët e sektorit të fintech është pjesa e parë e Strategjisë Kombëtare për Sektorin Fintech, e cila u diskutua në seancën e Komitetit të Sektorit

Fintech. Ky është konkluzioni i aktiviteteve të ndërmarra nga Banka Popullore në vitet e kaluara, të realizuara përmes projektit EFSE të nisur në vitin 2018, për të hedhur themelet e transformimit të sistemit financiar në vendin tonë.

Qatë vitit 2023 **u forcuan aktivitetet kombëtare për integrimin në BE** duke marrë pjesë në pjesën e mbetur të fazës dypalëshe të shqyrtimit analitik, si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE. Në vitin e kaluar, Banka Popullore organizoi **disa takime pune ndërkombëtare ku me përfaqësues të bankave qendrore, institucioneve ndërkombëtare dhe të akademisë u diskutuan sfidat aktuale makroekonomike**. Diskutimet me komunitetin ndërkombëtar lidhur me çështjet aktuale në operacionet e bankave qendrore dhe të sistemit financiar kontribuojnë në përmirësimin dhe zgjerimin e vazhdueshëm të njohurive, si bazë për marrjen e vendimeve të shëndosha në praktikë.

Të nderuar!

Gjatë viteve të fundit, ekonomitë dhe politikëbërësit janë përballur vazhdimisht me pasiguri dhe rreziqe në nivel global. Duke marrë parasysh tendosjet e vazhdueshme gjeopolitike, pasojat e ndryshimeve klimatike, por edhe transformimin e shpejtë teknologjik, i cili përveç përparësive sjell edhe kërcënime, është e qartë se do të vazhdojmë të përballemi me nevojën e një reagimi të shpejtë. Për shkak të ndryshimit të peizazhit ekonomik dhe gjeopolitik, të gjithë duhet të punojmë vazhdimisht për të rritur rezistencën, kapacitetin dhe të marrim masat e duhura për të përmbushur me sukses mandatet tona. Banka Popullore zbaton vazhdimisht politika të përshtatshme dhe punon në ngritjen e kapaciteteve institucionale. E gjithë kjo është si shtesë ndaj nivelit të lartë të gatishmërisë për t'u përballur me sfidat. Ne vazhdimisht ushqejmë dhe përmirësojmë atë përkushtim dhe vullnet të përbashkët për të gjetur zgjidhje dhe për të arritur rezultate.

25 prill 2024
Shkup

Guvernatorja dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
Dr. Anita Angellovska-Bezhoska

I. Politika monetare më 2023

Ngadalësimi i inflacionit

Stabilitet i ruajtur i kursit valutor të denarit


Mbajtja e nivelit të duhur të rezervave valutore

1.1. Qëllimet e politikës monetare

Ruajtja e stabilitetit të çmimeve është objektivi kryesor i përcaktuar ligjërisht i politikës monetare të Bankës Popullore. Një tjetër synim, në varësi të qëllimit kryesor, është të kontribuojë në ruajtjen e një sistemi financiar të qëndrueshëm, konkurrues dhe të orientuar nga tregu. Banka Popullore mbështet edhe politikën e përgjithshme ekonomike, pa rrezikuar arritjen e qëllimit kryesor dhe në përputhje me parimin e ekonomisë së tregut të hapur me konkurrencë të lirë. Nga pikëpamja strategjike, nga tetori i vitit 1995, strategjia e mbajtjes së kursit nominal stabil të denarit është zbatuar deri në vitin 2001 në raport me markën gjermane, e më pas në raport me euron.

Duke u nisur nga dispozitat themelore ligjore, Banka Popullore gjatë vitit 2023 monitoroi me kujdes mjedisin në ndryshim dhe në përputhje me rrethanat përshtati politikën monetare për të arritur qëllimet e përcaktuara me ligj. Banka Popullore vazhdoi me shtrëngimin e politikës monetare, përmes rritjes së mëtejshme gradual të normës bazë të interesit dhe menaxhimit të duhur të likuiditetit përmes ndryshimeve në rezervën e detyrueshme. Qëllimet e politikës monetare u arritën me sukses, që mund të vërehet nëpërmjet ruajtjes së mëtejshme të një kursi të qëndrueshëm valutor, si dhe të rritjes së rezervave valutore që mbetën në zonën e sigurt sipas të gjithë treguesve të mjaftueshmërisë. Për sa i përket stabilitetit të çmimeve, në vitin 2023 u arrit një rritje e ngadaltë e çmimeve vendase, si rezultat i uljes së ndjeshme të trysnisë nga komponentët e çmimeve të ushqimeve dhe të energjisë elektrike, si dhe stabilizimit të trysnive të çmimeve nga kategoritë më pak të ndryshueshme, në përputhje me masat monetare të ndërmarra. Po ashtu, në kuadër të strategjisë së kursit fiks "de facto" të denarit në raport me euron, Banka Popullore ndoqi ndryshimet e politikës monetare të Bankës Qendrore Europiane. Shtrëngimi i politikës monetare kontribuoi në uljen e pritshmërive inflacioniste, në stabilizimin e tregut valutor dhe të inflacionit. Inflacioni mesatar në vitin 2023 u ul në një nivel njëshifror dhe arriti në 9,4%, që është ngadalësim në krahasim me një vit më parë (14,2%). Në fund të vitit, norma vjetore e inflacionit u ngadalësua ndjeshëm, duke e ulur atë në 3,6%. Gjithashtu, në kushtet e lëvizjes së ngjashme të normave të inflacionit në vendin tonë dhe në Eurozonë, hendeuku në raport me inflacionin në Eurozonë është ngushtuar. Në vitin 2023, stabiliteti financiar u ruajt me sukses dhe u morën disa vendime makroprudenciale që kontribuan në forcimin e mëtejshëm të bazës së kapitalit të bankave dhe rezistencën e tyre ndaj goditjeve.

Grafiku 1
Hendeku prodhues dhe inflacioni*



Burimi: EShS-ja dhe BPRMV-ja


* Hendeku prodhues është një tregues i pozicionit ciklik të ekonomisë dhe llogaritet si një shprehje e realizimit nga niveli potencial i PBB-së në raport me nivelin potencial të PBB-së (hendeku prodhues = (PBB e realizuar – PBB potenciale)/PBB potenciale). Për inflacionin total dhe bazë tregohet ndryshimi mesatar vjetor (në %).

Grafiku 2
Rezervat valutore bruto



Burimi: BPRMV-ja.

Grafiku 3
Treguesit e mjaftueshmërisë së rezervave valutore



Burimi: EShS-ja dhe BPRMV-ja


* Sipas rregullit Greenspan-Guidotti, është e nevojshme që vendi të ruajë mbulimin e plotë të borxhit afatshkurtër (maturimi i mbetur) me rezervat valutore.

** Mjetet likuide përbëhen nga aktivja me likuiditet të lartë dhe depozita me afat të shkurtër pranë bankave të huaja. Totali i aktiveve nuk përfshin mjetet e bankat vendase.

*** Treguesi u referohet kredive të sektorit financiar dhe jofinanciar, ndërsa për vitin 2016 të dhënat përfshijnë ndryshime nga ndryshimet rregullatore.

Burimi: BPRMV dhe EShS.

Grafiku 4
Tregues të zgjedhur të stabilitetit financiar



Burimi: BPRMV-ja.

1.2. Pozicionimi i politikës monetare


Gjatë vitit 2023, Banka Popullore vazhdoi të shtrëngoje politikën monetare. Në fakt, për të ulur dhe stabilizuar trynitë e çmimeve dhe pritshmëritë inflacioniste, Banka Popullore rriti gradualisht normën bazë të interesit në gjashtë raste, deri në nivelin prej 6,30%, e cila u mbajt deri në fund të vitit 2023, duke ruajtur njëkohësisht shumën e ofruar të bonove të thesarit në nivelin prej 10.000 milionë denarësh. Njëkohësisht, u rritën normat e interesit për depozitat njëditore dhe ato shtatëditore, në 4,20%, përkatësisht 4,25%. Duke pasur parasysh strategjinë monetare të kursit stabil të denarit në raport me euron, ndryshimet në politikën monetare të brendshme pasuan ndryshimet në politikën monetare të Bankës Qendrore Europiane. Pozicionimi monetar u mbështet edhe nga masat shitesë, pra nga ndryshimet në instrumentin e rezervës së detyrueshme për të reduktuar euroizimin. Gjatë vitit 2023, Banka Popullore rriti në dy raste në mënyrë plotësuese shkallën e rezervës së detyrueshme të detyrimeve valutore të bankave deri në nivelin 21%, si dhe rriti pjesën e rezervës së detyrueshme të detyrimeve në valutë të huaj, e që përmbushet në euro, në 81%. Gjithashtu, norma e rezervës së detyrueshme, e cila zbatohet për detyrimet në denarë me klauzolë valutore, u rrit nga 50% në 100%. Gjatë vitit vazhdoi zbatimi i masës që synon nxitjen e

kreditimit të projekteve për burimet e rinovueshme të energjisë. Për të forcuar më tej rezistencën sistimore të sektorit bankar, si dhe transmetimin e sinjaleve monetare, Banka Popullore miratoi masa makroprudenciale për rritjen e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet e bankave vendase, si dhe masat në lidhje me përcaktimin e kufijve për monitorimin e cilësisë së kërkesës për kredi. Këto masa kanë një qëllim parandalues, duke marrë parasysh kushtet aktuale makroekonomike dhe në përputhje me masat e marra në një numër më të madh vendesh të Bashkimit Europian, si mbrojtje ndaj rreziqeve të mundshme mjedisore. Rritje e përshpejtuar vërehet në totalin e depozitave me bazë vjetore. Rreziqet për ekonominë globale dhe vendase në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme mbeten të theksuara, me zhvillimet e fundit në Lindjen e Mesme dhe luftën në Ukrainë që përfaqësojnë një burim të madh rreziku, veçanërisht në tregjet e energjisë dhe të ushqimit. Banka Popullore monitoron rregullisht dhe me kujdes parametrat kryesorë ekonomikë dhe rreziqet potenciale nga mjedisi i brendshëm dhe i jashtëm, me qëllim të përshtatjes së duhur të politikës monetare për të ruajtur stabilitetin e kursit valutor dhe stabilitetin e çmimeve në afat të mesëm.

Mjedisi makroekonomik i vitit 2023 imponoi nevojën për shtrëngimin e mëtejshëm gradual të kushteve financiare për të stabilizuar tregun valutor dhe të pritshmërive inflacioniste. Gjithashtu, në fillim të vitit, Banka Popullore ndërhyri me shitje neto të valutave, por gjatë vitit këto trysni u shteruan dhe në vazhdimësi u realizua një blerje neto, e cila rezultoi me një blerje neto të lartë të valutave për të gjithë vitin 2023, afër shumave të viteve të parakrizës.

Niveli i çmimeve në ekonominë vendase në vitin 2023 shënoi një rritje mesatare vjetore prej 9,4%, që është një ngadalësim në krahasim me një vit më parë (14,2%). Këto arritje pasqyrojnë uljen e ndjeshme të trysnisë nga komponentët e çmimeve të ushqimeve dhe të energjisë elektrike, si dhe stabilizimin e vërejtur të trysnive të çmimeve nga kategoritë më pak të ndryshueshme, në përputhje me masat monetare të ndërmarra. Megjithatë, norma mesatare e inflacionit në vitin 2023 ishte mbi mesataren historike dhe rregullimi i inflacionit bazë ishte më i ngadalshëm, që imponoi kujdes të mëtejshëm në drejtimin e politikës monetare dhe në miratimin e vendimeve monetare, për të stabilizuar inflacionin dhe pritshmëritë inflacioniste në një bazë më të përhershme.


Grafiku 5
Rishikime të projeksioneve makroekonomike



Burimi: BPRMV dhe EShS. Projektionet për të gjithë treguesit u referohen projeksioneve makroekonomike të BPRMV-së.

Rezervat valutore më 2023 shënuan rritje të ndjeshme, duke qëndruar në zonën e sigurt gjatë vitit. Rritja e rezervave valutore është në pjesën më të madhe rezultat i lëvizjeve më të favorshme në tregun valutor, krahasuar me dy vitet e mëparshme. Për shkak të zvogëlimit të nevojës për valutë me rënien e krizës energjetike, pritshmërive të stabilizuara dhe për shkak të rritjes së besimit në valutën vendase, Banka Popullore ndërhyr në tregun valutor me një blerje neto relativisht të lartë të valutave më 2023, si rezultat i zhvillimeve të favorshme në gjysmën e dytë të vitit. Flukset e forta pozitive financiare brenda llogarisë financiare të bilancit të pagesave, me suficit të moderuar në llogarinë rrjedhëse, mundësuan rritjen shtesë të rezervave valutore.

Grafiku 6
Ndërhjyret e BPRMV-së në tregun valutor (në milionë euro)




Burimi: BPRMV.

Depozitat në sektorin financiar rriten fuqishëm gjatë vitit, me trysni dukshëm më të ulëta nga kriza energjetike dhe me një pozicion të jashtëm të favorshëm të ekonomisë, por edhe me kushte më të favorshme financiare për kursim. Kështu, rritja vjetore e gjithsej depozitave në vitin 2023 arriti në 9,1%. Nga pikëpamja sektorale, rritja rezulton nga rritja e depozitave në të gjithë sektorët, por mbi të gjitha nga rritja vjetore të amvisëritë dhe të sipërmarrjet (kontribute prej 5,1 p.p., përkatësisht 3,8 p.p.), shoqëruar me rritjen e depozitave dhe sektorëve të tjerë (kontribut prej 0,2 p.p.). Lëvizje të favorshme u vërejtën edhe në strukturën valutore dhe të maturimit të depozitave, që tregon për forcimin e besimit në valutën vendase dhe në sistemin bankar, në përputhje me masat e ndërmarra nga Banka Popullore. Kështu, në vitin 2023, dyfishi i rritjes vjetore u realizua të depozitat në denarë (përfshirë paratë e depozituara), krahasuar me rritjen e depozitave në valuta. Gjithashtu, pas prirjes rënës në tre vitet e mëparshme, depozitat afatgjata në vitin 2023 shënuan rritje të lartë vjetore (prej 21,1%), ndërsa situata e depozitave afatshkurtra ishte relativisht e qëndrueshme (rritje e vogël prej 0,6%).

Nga aspekti i *kredive të sektorit privat*, në kushtet kur ka ende pasiguri dhe kushte të shtrënguara kreditimi, rritja e kredive u ngadalësua gjatë vitit 2023, por mbeti në një nivel mesatar prej 5,1%. Nga pikëpamja sektorale, rritja rezulton nga kontributi më i lartë pozitiv i kredive të amvisërive, gjatë kontributit më të ulët pozitiv të kredive të ndërmarrjeve. Në strukturën valutore, kontribut pozitiv kanë kreditë në valutë vendase dhe të huaja (përfshirë kreditë në denarë me klauzolë valutore).

Duke marrë parasysh zbatimin e strategjisë së kursit të qëndrueshëm nominal valutor të denarit në raport me euron, ndryshimet e *normave të interesit në Eurozonë*, si spirancë ekonomike, ato kanë një rol të rëndësishëm në pozicionimin e politikës monetare në vend. Kështu, gjatë vitit 2023 vazhdoi shtrëngimi i politikës monetare, ndërkaq dallimi ndërmjet normave të interesit të Bankës Popullore dhe BQE-së në fund të vitit ishte 1,80 p.p. Sa u përket normave të interesit të bankave në ekonominë vendase, dallimi ndërmjet normës së interesit në denarë dhe normës së interesit për depozitat në valuta, në fund të vitit 2023 shënoi një zgjerim të lehtë (nga 0,7 p.p. në 0,9 p.p.), si rezultat i zhvendosjes pak më të theksuar në rritje të normës së interesit për depozitat në denarë, në raport me rritjen e normës së interesit për depozitat në valuta, në përputhje me masat e ndërmarra nga Banka Popullore.

Grafiku 7
Përhapja e normave bazë të interesit të BPRMV-së dhe BQE-s, në p.p.




Burimi: BPRMV dhe BQE

Norma bazë e interesit e BPRMV-së: norma e interesit për bonot e thesarit të BPRMV-së.

Norma bazë e BQE-së: norma e interesit për operacionet kryesore të rifinancimit të BQE-së.

Grafiku 8
Përhapja e normave të interesit të bankave në ekonominë vendase, në p.p.



Burimi: BPRMV-ja


II. Mjedisi ndërkombëtar

Ekonomia globale u përball me goditje të paprecedentë gjatë katër viteve të fundit, me pasoja afatgjata dhe joproporcionale për aktivitetin dhe tregtinë globale, çmimet, tregun e punës, prirjet fiskale dhe politikën monetare¹. Aktiviteti ekonomik në vitin 2023 vazhdon të jetë rezistues, por efektet e kushteve të shtrënguara financiare globale, rritjes së dobët të tregtisë globale dhe përkeqësimit të besimit të biznesit dhe të amvisërive në rritje ndihen gjithnjë e më shumë. Inflacioni në nivel global është ngadalësuar, pas ritmeve të larta të arritura një vit më parë, por trysnitë inflacioniste nga inflacioni bazë vazhdojnë të jenë të larta. Bankat qendrore vazhduan të shtrëngonin politikën monetare, ndërsa u shtrënguan më tej edhe kushtet e tregut financiar.


Rritja e aktivitetit ekonomik global në vitin 2023 vlerësohet në 3,1%, që paraqet një ngadalësim krahasuar me vitin 2022 (3,5%), e që rezulton nga ngadalësimi i rritjes ekonomike në ekonomitë e zhvilluara (1,6%), me lëvizje divergjente në vende të veçanta. Për dallim nga Shtetet e Bashkuara, ku vlerësohet një rritje e përshpejtuar e aktivitetit ekonomik, Eurozona, si partneri ynë më i rëndësishëm tregtar, përballet me një rritje të ngadaltë dhe të ulët ekonomike, në kushtet e përkeqësimit të besimit të konsumatorëve, efekteve negative afatgjata të çmimeve të larta të energjisë dhe dobësive në aktivitetet industriale dhe investimet e biznesit që janë të ndjeshme ndaj rritjes së normave të interesit. Rritja ekonomike në ekonomitë me rritje të shpejtë dhe në zhvillim mbeti në të njëjtin nivel (4,1%).

Rritja ekonomike globale pritet të stabilizohet dhe inflacioni global të ngadalësohet më tej në vitin 2024, por këto shoqërohen me pasiguri të lartë. Konflikti në Lindjen e Mesme rriti rreziqet gjeopolitike që janë theksuar për shkak të luftës në Ukrainë, si dhe rriti pasigurinë në lidhje me çmimet e produkteve parësore në tregun ndërkombëtar, me efekte të mundshme negative në rritjen globale. Burime të tjera të cenueshmërisë rrjedhin nga inercia më e madhe në inflacionin bazë, e cila mund të ndikojë në shtrëngimin monetar, rritjen më të dobët të aktivitetit ekonomik në Kinë dhe fragmentimin e mëtejshëm të tregtisë globale. Nga ana tjetër, një rënie e mundshme më e fortë e inflacionit, një tërheqje më e ngadaltë e mbështetjes për ekonominë nga politika fiskale, rimëkëmbja më e shpejtë ekonomike e Kinës, zhvillimi i inteligjencës artificiale dhe reformat në fushën e ofertës agregate mund të ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike globale.

Grafiku 9
Rritja ekonomike globale (në %)



Grafiku 10
Rritja ekonomike në vendet e zhvilluara (në %)




Burimi: Anketa Ekonomike Botërore, përditësuar në tetor 2023 dhe janar 2024, FMN.

¹ Analiza bazohet në Anketën Ekonomike Botërore të FMN-së, të përditësuar në tetor 2020 dhe janar 2021; Perspektiva Ekonomike Globale e Bankës Botërore, janar 2021; raportet tremujore të Bankës Popullore.


Inflacioni në nivel global u ngadalësua në vitin 2023 në 6,8% (8,7% në 2022), që është kryesisht një pasqyrim i lëvizjeve të favorshme të çmimeve të karburanteve dhe të ushqimeve në tregun ndërkombëtar, pasi një vit më parë arritën nivelet rekord, si dhe shtrëngimi monetar nga bankat qendrore, i cili kontribuoi në ruajtjen e pritshmërive inflacioniste në nivele të ulëta dhe në lëvizjen në rënie të inflacionit bazë gjatë vitit. Duke parë grupet e vendeve, në vitin 2023 inflacioni në ekonomitë e zhvilluara ra në 4,6% (7,3% më 2022), dhe në ekonomitë me rritje të shpejtë dhe në zhvillim në 8,4% mesatarisht (9,8% më 2022). Trysni të çmimeve nga faktorët vendas, edhe pse ende të pranishëm, u dobësuan në fund të vitit, me më pak shtrëngim në tregun e punës, që pasqyrohet nga një rënie e numrit të vendeve të lira të punës, një rritje e vogël e papunësisë dhe një ofertë më e lartë e fuqisë punëtore.

Grafiku 11
Shkalla globale e inflacionit (në %)



Burimi: Anketa Ekonomike Botërore, tetor 2023 dhe raporti i përditësuar i janarit 2024, FMN.

Grafiku 12
Normat referencë të interesit në vendet e zhvilluara (në %)




Burimi: Bankat qendrore.


Sa u përket treguesve sasiorë që pasqyrojnë mjedisin e jashtëm të ekonomisë maqedonase, kërkesa e huaj efektive e vlerësuar shënon një ngadalësim të mëtijshëm të rritjes në vitin 2023. Konkretisht, vlerësimet tregojnë për një rritje të ulët të kërkesës së huaj efektive prej 0,4% (2,6% në vitin 2022), ku kontributin më të madh pozitiv e kanë vendet fqinje Bullgaria, Serbia dhe Greqia, ndërsa Gjermania si partneri ynë më i rëndësishëm tregtar, ka një ndikim të pafavorshëm në kërkesën e huaj, gjatë vlerësimit të rënies së aktivitetit ekonomik. Rritja më e ngadaltë e kërkesës së huaj efektive është, para së gjithash, pasqyrim i performancës së dobët të vendeve të Eurozonës, të cilat po përballen me një përkeqësim të ndjeshëm të tregtisë së jashtme. Inflacioni i huaj efektiv u ngadalësua gjithashtu në vitin 2023, pas rritjes së lartë të arritur një vit më parë, dhe ishte 7,7% (9,7% më 2022), me Gjermaninë, Serbinë dhe Poloninë që kontribuan më së shumti².

² Inflacioni në Serbi dhe Poloni është përshtatur për ndryshimet e kursit valutor.

Grafiku 13
Kërkesa efektive e huaj




Grafiku 14
Inflacioni i huaj




Burimi: Entet kombëtare të statistikave dhe llogaritjet e BPRMV-së³.

Mesatarisht, në tregjet e mallrave u vërejt rënie e çmimeve në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, kryesisht për shkak të një baze të lartë krahasuese pas përshkallëzimit të luftës në Ukrainë gjatë vitit të kaluar. Çmimi mesatar i naftës së papërpunuar në vitin 2023 është 76,2 euro për fuçi, që paraqet një rënie prej 19,1% krahasuar me vitin 2022 (94,1 euro për fuçi). Në të njëjtën kohë, në mesin e vitit, çmimi i naftës ra nën 70 euro për fuçi, që u nxit nga shqetësimet për perspektivat e rritjes së ekonomisë globale. Pas kësaj, deri në fund të vitit, çmimi u ruajt në një nivel më të lartë, në kuadër të uljes së ofertës nga OPEC+, rënies së rezervave të naftës në nivel global dhe rreziqeve që lidhen me ofertën për shkak të konfliktit në Lindjen e Mesme. Në vitin 2023, çmimet e produkteve ushqimore bazë në bursat botërore shënuan një rënie prej 9,3%, ndërsa rënia e çmimeve të metaleve bazë ishte më e dobët dhe ishte 4,9%.

Grafiku 15
Lëvizja mujore e çmimit të energjisë primare dhe produkteve joenergjetike (euro, indeksi: 2016=100)



Grafiku 16
Lëvizja mujore e çmimeve të naftës bruto, metaleve⁴ dhe e ushqimit (euro, indeksi: 2016=100)



Burimi: Baza e të dhënave të FMN-së për çmimet e produkteve primare.

Në vitin 2023, duke pasur parasysh pritshmëritë se inflacioni do të qëndrojë mbi nivelin e objektivit për një periudhë më të gjatë, bankat qendrore të vendeve të zhvilluara vazhduan

³ Kërkesa e huaj efektive llogaritet si shuma e indekseve të PBB-së së ponderuar të partnerëve më të rëndësishëm tregtarë të vendit tonë. Në përlogaritjen e indeksit janë përfshirë: Gjermania, Greqia, Italia, Holanda, Belgjika, Spanja, Serbia, Kroacia, Sllovenia dhe Bullgaria. Ponderët janë llogaritur në bazë të pjesëmarrjes së eksporteve në këto vende në totalin e eksporteve. Inflacioni i huaj efektiv përfaqëson një shumë të ponderuar të indekseve të çmimeve të konsumit të vendeve partnere më të rëndësishme të vendit tonë, në fushën e importit të mallrave të konsumit. Struktura e ponderimit bazohet në pjesëmarrjen e normalizuar të importit nominal nga secili prej vendeve në totalin e importit nominal në periudhën 2016-2018. Në llogaritjen e këtij treguesi përfshihen: Gjermania, Greqia, Franca, Italia, Spanja, Austria, Sllovenia, Bullgaria, Polonia, Kroacia dhe Serbia.

⁴ Indeksi i metaleve është një indeks i përbërë që përfshin çmimet e bakrit, aluminit, mineralit të hekurit, kallajit, nikelit, zinkut, plumbit dhe uranimit.

të shtrëngojnë politikën monetare, por në mënyrë më të moderuar krahasuar me një vit më parë. Kështu, në korrik, FED-i e rriti për herë të fundit normën e interesit referencë në vitin 2023, për 0,25 p.p., pasi më parë në tre raste dhe me të njëjtin intensitet, bëri një korrigjim në rritje të normës së interesit, përfshirë edhe muajin mars, kur u përball me trazira në sektorin bankar. Kështu, në dhjetor të vitit 2023, ajo lëvizi nga 5,25% në 5,5%. Gjithashtu, gjatë vitit FED-i vazhdoi të reduktojë portofolin e saj të letrave me vlerë të qeverisë dhe të hipotekave. Ashtu si FED-i, Banka e Anglisë vazhdoi me shtrëngime më të forta monetare në gjysmën e parë të vitit, kur norma bazë e interesit u rrit për 1,5 p.p. në total. Në periudhën në vijim, në kushtet e ngadalësimit të inflacionit, norma e interesit referencë u rrit vetëm për 0,25 p.p. në gusht, duke e bërë 5,25% në dhjetor. Po ashtu, gjatë vitit u realizua edhe programi për shitjen e mjeteve, duke reduktuar portofolin e letrave me vlerë në bilancin e bankës qendrore.

Banka Qendrore Europiane (BQE), pas rritjes së tri normave bazë të interesit për 1,0 p.p. në total gjatë tremujorit të parë, në dy tremujorët në vijim të vitit 2023, kreu një korrigjim në rritje prej 0,5 p.p. secili, në kushtet e zbutjes së trysnive të çmimeve (norma e inflacionit në Eurozonë u ngadalësua në 8,4% më 2022, u reduktua në 5,4% më 2023). Në tremujorin e fundit të vitit, gjatë vlerësimit që pozicionimi monetar është i përshtatshëm për të ulur inflacionin brenda nivelit të synuar në periudhën e ardhshme afatmesme, BQE-ja i mbajti të njëjtat normat bazë të interesit, kështu që norma e interesit për depozitat e disponueshme, për operacionet bazë të rifinancimit dhe për kreditë e disponueshme njëditore mbeti në nivelet 4,0%, 4,5%, përkatësisht 4,75%. Për më tepër, nga korriku, BQE-ja ndaloi riinvestimin e letrave me vlerë të maturuara në kuadër të Programit të blerjes së letrave me vlerë (APP), i cili, gradualisht dhe sipas dinamikës së përcaktuar, uli portofolin brenda këtij programi, ndërkaq në mbledhjen e dhjetorit u vendos që gjatë gjysmës së dytë të vitit 2024 të zvogëlohet portofoli gradualisht në kuadër të Programit të blerjes së letrave me vlerë për mbështetjen emergjente të ekonomisë për shkak të pandemisë (PEPP) dhe të ndalohet riinvestimi i letrave me vlerë të maturuara, në kuadër të këtij programi në fund të vitit.

III. Lëvizjet makroekonomike në vitin 2023

Tabela 1

Treguesit bazë të ekonomisë së Maqedonisë

ndryshime vjetore, në%	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Sektori real										
Produkti bruto i brendshëm*	3.6	3.9	2.8	1.1	2.9	3.9	-4.7	4.5	2.2	1.0
Inflacioni	-0.3	-0.3	-0.2	1.4	1.5	0.8	1.2	3.2	14.2	9.4
Norma e papunësisë	28.0	26.1	23.7	22.4	20.7	17.3	16.4	15.4	14.4	13.1
Sektori i jashtëm										
Bilanci i llogarisë rrjedhëse (% e PBB-së)	-0.4	-1.8	-2.6	-0.8	0.2	-3.0	-2.9	-2.8	-6.1	0.7
Bilanci tregtar (% e PBB-së)	-21.7	-20.1	-18.8	-17.8	-16.2	-17.3	-16.6	-19.7	-26.7	-18.2
Investimet e huaja direkte (% nga PBB-ja)	2.3	2.2	3.3	1.8	5.6	3.2	1.4	3.3	5.0	3.7
Borxhi i jashtëm bruto (% nga PBB-ja)	70.0	69.3	74.7	73.4	73.0	72.4	78.7	79.8	79.4	81.3
Rezerva valutore bruto (në milionë EUR)	2,436.5	2,261.8	2,613.4	2,336.3	2,867.1	3,262.6	3,359.9	3,643.3	3,862.9	4,538.5
Sektori monetar										
Oferta monetare (M4)	10.6	6.9	6.2	5.1	11.8	9.3	6.9	7.0	5.1	8.7
Kreditë totale	10.0	9.6	6,5***	5.4	7.3	7,6***	4.7	8.3	9.4	5.1
Depozitat totale (me para të depozituara)	10.5	6.4	6.1	5.0	12.1	9.0	5.7	7.5	4.9	9.1
Sektori fiskal										
Bilanci buxhetor (% nga PBB-ja)	-4.2	-3.5	-2.7	-2.7	-1.8	-2.0	-8.0	-5.3	-4.4	-4.9
Borxhi publik (% nga PBB-ja)	45.8	46.6	48.8	47.7	48.4	49.2	59.7	60.3	59.1	62.1
Sektori bankar										
Norma e përshtatshmërisë së kapitalit (%)	15.7	15.5	15.2	15.7	16.5	16.3	16.7	17.3	17.7	18.1
Kreditë me probleme të sektorit jofinanciar/kredi bruto (%)	11.3	10.8	6.6	6.3	5.2	4.8	3.4	3.2	2.9	2.8
Aktiva likuide / aktiva totale (%)	29.8	28.2	28.9	27.1	26.7	26.9	23.3	23.0	21.3	22.7

Burimi: BPRMV-ja, EShS-ja, Ministria e Financave.

* Informacion paraprak për 2022, informacion i vlerësuar për 2023.

** Pa detyrime për qeverisjen monetare (pa marrëveshje repo)

*** E korrigjuar për shlyerje.


3.1. PBB-ja dhe inflacioni

Më 2023, **rritja reale e ekonomisë maqedonase u ngadalësua duke rënë në 1%⁵**, krahasuar me një vit më parë, kur ishte 2,2%. Ngadalësimi pasqyron pjesërisht mjedisin e jashtëm, i cili vazhdon të jetë i pafavorshëm, me prani të tendosjeve gjeopolitike, ulje të vëllimit të tregtisë dhe ulje të besimit të subjekteve ekonomike, me trysni ende të pranishme inflacioniste dhe kushte të shtrënguara financiare. Në të njëjtën kohë, rënia e investimeve kishte një kontribut më të madh në ngadalësimin e rritjes. Kjo lidhet kryesisht me rregullimin e inventarëve të sektorit të korporatave, pas rritjes së tyre në periudhën e mëparshme për shkak të pasigurisë më të madhe, veçanërisht e theksuar nga lufta në Ukrainë dhe pasiguria në lidhje me disponueshmërinë dhe çmimet e lëndëve të para dhe të karburanteve.

E vështruar përmes komponentëve të veçantë në kahun e kërkesës, rritja e aktivitetit ekonomik në vitin 2023 vjen si pasojë e kontributit pozitiv të eksporteve neto. Ndryshimi në eksportet neto është pasqyrim i reduktimit të importeve, i cili pjesërisht lidhet me rënien e theksuar të investimeve. Nga ana tjetër, një rënie e lehtë është vërejtur në aktivitetin eksportues, i cili vjen pas rritjes së lartë në dy vitet e mëparshme, dhe pjesërisht lidhet me konjunkturën e pafavorshme globale. Kërkesa e brendshme në vitin 2023 ka një kontribut negativ, në kushtet e një rënie të ndjeshme të investimeve bruto, për shkak të rregullimit të inventarëve, si dhe një rënie e vogël është vërejtur edhe në konsumin publik. Konsumi personal vazhdon të rritet, por më ngadalë, kryesisht si rezultat i rritjes së të ardhurave të disponueshme, mbështetjes së kredive, si dhe masave të qeverisë për të mbështetur ekonominë dhe standardin e jetesës së popullsisë.


Grafiku 17

PBB dhe kërkesa e huaj efektive (shkallëz vjetore të ndryshimit real, në %)



Grafiku 18

PBB (rritja reale, në %) dhe komponentët e shpenzimeve të PBB-së (kontributet në rritje, në p.p.)




Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe Eurostat, llogaritjet e BPRMV-së. Të dhënat e PBB-së për vitin 2022 janë të mëparshme, ndërsa për vitin 2023 janë vlerësuar.

⁵ PBB reale gjatë vitit 2023 shënon dinamikën e mëposhtme: në tremujorin e parë – 1,4%, në tremujorin e dytë – 0,9%, në tremujorin e tretë – 1% dhe në tremujorin e katërt – 0,9%.

Grafiku 19


Kontributi në ndryshimin real vjetor të PBB-së (në pikë përqindje)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe Eurostat, llogaritjet e BPRMV-së. Të dhënat e PBB-së për vitin 2022 janë të mëparshme, ndërsa për vitin 2023 janë vlerësuar.

Grafiku 20

Kontributet e aktiviteteve të përzgjedhura në ndryshimin vjetor të prodhimit industrial (në pikë përqindje)




Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe BPRMV.

Pas rritjes së fortë të çmimeve të konsumit në vitin 2022, shkalla vjetore e inflacionit ngadalësohej gradualisht gjatë vitit 2023, në përputhje me lëvizjet e çmimeve të mallrave në tregjet globale, ngadalësimin e inflacionit të importuar nga jashtë, si dhe shtrëngimin e vazhdueshëm gradual të politikës monetare, me ç'rast **inflacioni mesatar u reduktua në**


një nivel njëshifror prej 9,4%. Nga pikëpamja strukturore, ndikimi më të madh në këtë dinamikë ka ulja e kontributit të çmimeve të ushqimeve në inflacion, e plotësuar nga rruga në rënie e rritjes së çmimeve të karburanteve. Po ashtu, masat ekonomike kishin ndikim përkatës në lëvizjen e çmimeve të konsumit, nëpërmjet uljes dhe ngrirjes së çmimeve dhe lehtësimit në fushën e detyrimeve doganore për disa produkte ushqimore.

Grafiku 21
Inflacioni vendas dhe inflacioni efektiv i huaj
(shkallët e rritjes, në %)



Burimi: ESHS, Eurostat dhe llogaritjet e BPRMV-së

Grafiku 22
Komponenti i ndryshueshëm (ushqimi dhe energjia) dhe afatgjatë i inflacionit
(kontributet vjetore, në pikë përqindje)



Pavarësisht ngadalësimit të ndjeshëm, **çmimet e ushqimit** në vitin 2023 shënuan rritje dyshifrore prej 11,8%, duke kontribuar në afërsisht gjysmën e rritjes totale të çmimeve të konsumit. Gjatë vitit 2023, çmimet e produkteve ushqimore bazë në tregun ndërkombëtar lëvizën kryesisht në rënie, ndërsa u zbatuan edhe masa ekonomike për të zbutur trysnitë e çmimeve të produkteve ushqimore⁶. Kjo kontribuoi në ngadalësimin më të ndjeshëm të çmimeve të grupeve të caktuara të produkteve, si "bukë dhe drithëra" dhe "qumësht, djathë dhe vezë", si dhe rënie të çmimeve të vajrave. Mirëpo, çmimet e bukës, drithërave dhe produkteve të qumështit mbetën në nivele të larta, duke kontribuar me 46,3% në rritjen e

⁶ Më 28 shkurt 2023, Qeveria e RMV-së mori vendim për ngrirjen e çmimit të bukës në periudhën nga 1 marsi deri më 31 maj 2023. Në të njëjtën kohë, qeveria mori vendim për heqjen e çmimit të subvencionuar të energjisë elektrike për kompanitë e industrisë ushqimore (lidhje). Më 10 mars, Qeveria mori vendim për uljen, përkatësisht ngrirjen e çmimeve të disa makaronave dhe disa produkteve të qumështit në periudhën 16 mars deri më 31 maj 2023. Kështu, çmimet e makaronave dhe shpagetat u ulën me 15%, krahasuar me ato të zbatuara në tregtinë me pakicë më 1 mars dhe u ngrinë në këtë nivel deri në fund të majit. Veç kësaj, u mor vendim për heqjen e taksës doganore për makaronat për periudhën nga 13 marsi deri më 31 maj 2023. Çmimet e produkteve individuale të qumështit ranë për 10% nga çmimet e shitjes me pakicë më 1 mars dhe u ngrinë në këtë nivel, ndërsa masa ishte në fuqi (lidhje). Më 21 mars, qeveria mori vendim për ngrirjen e çmimeve të vezëve të freskëta të pulës dhe orizit në nivelin që vliente më 15 mars në tregtinë me pakicë, të cilat u zbatuan deri më 30 prill 2023 (lidhje). Gjithashtu, Qeveria mori një vendim më 3 prill (lidhje), ndërsa më 11 prill vendimi u ndryshua (lidhje) për përcaktimin e çmimeve më të larta të llojeve të caktuara të frutave dhe perimeve në tregtinë me pakicë. Kjo masë ishte fillimisht e vlefshme për periudhën prej 5 deri më 30 prill dhe më pas u vendos që masa të zbatohet deri më 31 maj 2023 (lidhje). Krahas ndërhyrjeve në çmimet e produkteve ushqimore, më 29 mars, Qeveria mori vendim për uljen, përkatësisht ngrirjen e çmimeve të një pjese të caktuar të produkteve higjienike për periudhën nga 1 prilli deri më 31 maj 2023. Kështu, çmimet e këtyre produkteve u ulën për 13%, krahasuar me ato të zbatuara në tregtinë me pakicë më 20 mars dhe u ngrinë në këtë nivel ndërkohë që masa është në fuqi (lidhje). Po ashtu, më 25 prill, Qeveria mori vendim për vazhdimin e zbatimit të marzhave më të larta tregtare tashmë të përcaktuara në tregtinë me shumicë dhe pakicë për disa produkte ushqimore deri më 30 qershor 2023 (lidhje). Më 19 shtator, qeveria mori vendim për uljen e çmimeve të produkteve në kuadër të 24 kategorive nga furra buke, qumështore, industria e mishit dhe bujqësia me të paktën 10%, krahasuar me çmimin që kishin në 1 gusht 2023 dhe ngrirje në këtë nivel, ndërsa shitësve me pakicë iu kërkua të shënonin qartë këto produkte me fjalët "çmim i garantuar" (lidhje). Gjithashtu, më 26 shtator, Qeveria mori vendim të posaçëm për caktimin e marzhit në tregtimin (fitimit) në tregtinë e pemëve dhe perimeve të freskëta në shumën totale deri në 10%, në tregtinë me shumicë, si dhe deri në 15%, në tregtinë me pakicë (lidhje). Këto vendime fillimisht ishin të vlefshme deri në nëntor 2023, më pas zbatimi i tyre u zgjat deri në fund të vitit 2023 (lidhje), dhe më pas deri në shkurt 2024 (lidhje). Më 28 shtator, Qeveria miratoi vendim për heqjen e detyrimeve të importit për importin e agrumeve, i cili ishte i vlefshëm që nga dhjetori i vitit 2023, si dhe vendim për uljen e detyrimeve të importit (normat doganore dhe detyrimet speciale) për importin e perimeve të freskëta, i vlefshëm deri në shkurt të vitit 2024 (lidhje). Vendimi i qeverisë për rritjen e normës preferenciale të TVSH-së nga 5% në 10% për disa produkte ushqimore, i miratuar fillimisht më 28 shtator, veçoi në drejtim të kundërt (lidhje), me ndryshime në vendimin e datës 10 tetor (lidhje).

çmimeve të komponentëve ushqimorë, ndërsa çmimet e mishit kishin kontributin më të madh individual. E vështruar në mënyrë dinamike, rritja e çmimeve të ushqimeve në bazë vjetore u ngadalësua gjatë vitit, e cila u ul në 0,8% në tremujorin e fundit, në kushtet e një baze të lartë krahasuese dhe të masave afatshkurtra për uljen dhe ngrirjen e çmimeve të produkteve ushqimore individuale në tregtinë me pakicë.

Çmimet e karburanteve shënuan rritje prej 7,3%, duke formuar rreth 10% të inflacionit total. Çmimet e energjisë elektrike për amvisëritë janë nxitësi kryesor i rritjes së çmimeve në komponentin e energjisë, në përputhje me rritjen e tyre rregullatore në janar dhe korrik⁷, ndërsa kontribut shtesë kishte efekti transferues i rritjes së çmimit të druve të zjarrit nga mesi i vitit 2022. Në drejtim të kundërt veçoi rënia e çmimeve të produkteve të naftës, në kushtet e uljes së çmimeve të naftës bruto në bursat botërore dhe të zhvlerësimit të dollarit. E vështruar në aspekt dinamik, rritja e çmimeve në komponentin e energjisë kishte edhe një rrugë në rënie, me lëvizje të favorshme të çmimeve të karburanteve në tregun ndërkombëtar, si dhe një bazë të lartë krahasuese.

Inflacioni bazë më 2023 është 8,0% dhe kontribuon për 41,7% të rritjes totale të çmimeve të konsumit. Rritja e këtij komponenti ndodh më së shumti për shkak të çmimeve më të larta të shërbimeve të furnizimit me gatesë. Kontribut të rëndësishëm kanë çmimet e produkteve për mirëmbajtjen rutinë të shtëpisë dhe higjienën personale, çmimet e pijeve joalkoolike⁸, si dhe çmimet e produkteve të duhanit, për shkak të rritjes së akcizës⁹. Shkalla vjetore e inflacionit bazë gjatë vitit kishte një ecuri kryesisht në rënie, por mesatarisht është më e lartë krahasuar me një vit më parë (7,1%), duke marrë parasysh se transferimi nga rritja e lartë e çmimeve të importit të energjisë dhe ushqimeve gjatë vitit 2022 mbi çmimet e produkteve dhe të shërbimeve të tjera në indeksin e çmimeve zhvillohet me një vonesë të caktuar dhe ishte më i fortë në fillim të vitit 2023.

3.2. Tregu i punës

Lëvizjet në tregun e punës janë një segment i rëndësishëm i pasqyrës së përgjithshme makroekonomike të ekonomisë vendase, duke marrë parasysh ndikimet e ofertës dhe të kërkesës për punë në rritjen ekonomike, produktivitetin dhe shpenzimet e punës. Mirëpo, ndryshimet në këtë pjesë të statistikave kombëtare në vitet e fundit e bëjnë të pamundur një analizë dinamike gjithëpërfshirëse të këtij segmenti të tregut në vendin tonë. Në fakt, krahas ndryshimeve për shkak të Censurit të Popullsisë 2021, nga fillimi i vitit 2023, ndryshime të mëdha metodologjike u bëmë edhe në Anketën e Fuqisë Punëtore (AFP), për çka në kuadër

⁷ Në përputhje me vendimin e Komisionit Rregullator të Energjetikës (KRE), në janar 2023 janë bërë këto ndryshime në çmimin e energjisë elektrike për furnizuesin universal: çmimi në bllokun e parë dhe të dytë është ulur për 4,11%, përkatësisht 2,95 %, ndërsa çmimi në bllokun e tretë dhe të katërt ka korrigjim në rritje për 0,85%, përkatësisht 7,65% ([kumtesë](#)), kurse çmimi i tarifës së ulët është rritur në 1,3183 den/kWh nga 0,6193 den/kWh më parë. Gjithashtu, në janar 2023, shkalla e taksës për shitjen e energjisë elektrike për amvisëritë u rrit nga 5% në 10%. Në korrik 2023, janë bërë ndryshimet e mëposhtme në çmimin e energjisë elektrike për furnizuesin universal: çmimi në bllokun e parë dhe të dytë u ul për 7,04%, përkatësisht 4,09%, ndërsa çmimi në bllokun e tretë dhe të katërt ka korrigjim në rritje për 2,54%, përkatësisht 2,42% ([kumtesë](#)), ndërsa çmimi i tarifës së ulët është rritur në 1,4013 den/kWh. Po ashtu, nga korriku i vitit 2023, shkalla e taksës për shitjen e energjisë elektrike për amvisëritë është 18%. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës, çmimi mesatar i energjisë elektrike për amvisëritë është rritur për 3,7% në janar dhe 4,2% në korrik, në baza mujore.

⁸ Rritja e çmimeve të pijeve joalkoolike u ngadalësua ndjeshëm në tremujorin e fundit të vitit, duke pasur parasysh se qeveria më 26 shtator 2023 mori vendim për uljen dhe ngrirjen e çmimeve të pijeve joalkoolike, ujit dhe birrës ([viejëz](#)). Ky vendim ishte fillimisht i vlefshëm deri në nëntor 2023, më pas zbatimi i tij u zgjat deri në fund të vitit 2023, me listën e rishikuar të produkteve. ([viejëz](#)), e më pas deri në shkurt 2024 ([viejëz](#)).

⁹ Ndryshimet në akcizën janë bërë në muajt prill dhe nëntor. Në muajin prill është bërë rritje e rregullt vjetore e akcizës, para se të miratohen ndryshimet në Ligjin e Akcizave në vitin 2023, sipas të cilit akciza për cigaret rritet çdo herë për 0,23 denarë për copë (0,2 denarë më parë), deri më 2030. Sa u përket produkteve të tjera të duhanit, ndryshimet mund të shihen në këtë [viejëz](#).

të këtij raporti, nuk mund të analizohen në mënyrë gjithëpërfshirëse lëvizjet e tregut të punës dhe të jepet një pasqyrë e ndryshimeve në krahasim me periudhën e mëparshme¹⁰.

Sipas të dhënave të reja të AFP-së, në vitin 2023, numri i përgjithshëm i të punësuarve në ekonomi është 688.296 persona, me një normë punësimi prej 45,4%. Numri i të papunëve është 103.351 persona, me një shkallë papunësie prej 13,1%. Shkalla e aktivitetit ishte e qëndrueshme gjatë vitit dhe arriti në 52,3%, me aktivitet më të lartë te meshkujt (62%) sesa te femrat (42.8%).

Një rritje nominale e përforcuar e rrogave mesatare të paguara vërehet edhe në vitin 2023. Krahas rritjes së rrogës minimale në ekonomi (për 12,6% në mars 2023), rritja vjetore e rrogave pasqyron më së shumti rritjen e rrogave të punonjësve në sektorin publik dhe atë në disa raste gjatë vitit: së pari me rritjen e rrogës minimale¹¹, pastaj me rritjen e rrogave të funksionarëve¹² në prill të vitit 2023, me rritjen e rrogave të të punësuarve në shëndetësi¹³ në maj të vitit 2023, si dhe me rritjen në shtator në përputhje me marrëveshjen e re kolektive për sektorin publik¹⁴. Në rritjen e përgjithshme të rrogave në ekonomi kontribuon edhe vazhdimësia e disa faktorëve strukturorë, si mungesa e fuqisë punëtore në segmente të caktuara të tregut të punës. Për rrjedhojë, rrogat nominale neto dhe bruto¹⁵ shënuan rritje prej 14,9%¹⁶, përkatësisht 15,3% (11%, përkatësisht 11,1% më 2022). Rritje vjetore të rrogave neto është shënuar në të gjithë sektorët e aktiviteteve, ndërsa rritjen më të lartë e shënojnë aktivitetet e "ndërtimtarisë" (18,9), "administratës publike dhe të mbrojtjes; sigurimi social i detyrueshëm" (17,7%), "veprimtaritë e shërbimeve administrative dhe ndihmëse" (17,2%), "arsimimi" (17,1%), "furnizimi me ujë; mënjanimi i ujërave të ndotura, menaxhimi i mbetjeve dhe aktivitetet e rehabilitimit të mjedisit" (15,9%), "industria përpunuese" (15,8%) dhe "objektet e akomodimit" (15%). Në kushtet e ngadalësimit të rritjes së nivelit të përgjithshëm të çmimeve të konsumit, rrogat reale neto dhe bruto u rritën për 5,1%, përkatësisht 5,4% (kundrejt një rënieje prej 2,8%, përkatësisht 2,7% më 2022).

¹⁰ Të dhënat e fuqisë punëtore për vitin 2023 nuk janë të krahasueshme me të dhënat e viteve të mëparshme, sepse në vitin 2023 EShS prezantoi rregulloren e re të BE-së. Zbatimi i rregullores së re shkaktoi ndryshime në anketë, duke filluar nga ndryshimet në paraqitjen e pyetësorit, ndryshimi i renditjes së pyetjeve, ndryshimi dhe heqja e pyetjeve ekzistuese dhe shtimi i pyetjeve të reja, ndryshime në fushëveprimin dhe përkufizimin e punësimit dhe të papunësisë. Ndryshimet e përmendura shkaktuan një ndërprerje në të dhënat e serive kohore. Prandaj, kjo pjesë e Raportit Vjetor është në formë të modifikuar dhe të shkurtuar, në pritje të marrjes së të dhënave të përpunuara dhe të harmonizuara për vitet e kaluara.

¹¹ Në përputhje me ndryshimet dhe plotësimet e fundit ligjore për rritjen e rrogës minimale ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 58/23) nga marsi i vitit 2023, rroga minimale neto u rrit për 2.175 denarë. Lartësia e rrogës minimale në shumën bruto, duke filluar nga marsi 2023 deri në shkurt 2024, është 29.739 denarë (më parë 26.422 denarë), përkatësisht rroga minimale në shumën neto është 20.175 denarë (paraprakisht 18.000 denarë). Kjo rritje llogaritet në përputhje me metodologjinë e vitit të kaluar, me të cilën rroga minimale do të harmonizohet, ndërkohë llogaritet në përputhje me rritjen për vitin pararendës të rrogës mesatare të paguar në RMV dhe indeksit të shpenzimeve të jetesës - 50% e rritjes nga secili tregues në mënyrë përkatëse. Veç kësaj, është përcaktuar se rroga minimale nuk mund të jetë më e ulët se 57% e shumës së rrogës mesatare neto të paguar në RMV për vitin pararendës. Në përputhje me Ligjin e Rrogës Minimale, për rrogat në administratën shtetërore pason rritje lineare prej 2.175 denarësh për të harmonizuar rrogën me atë minimale, në përputhje me rregulloret ligjore.

¹² Nga prilli 2023, rrogat e zyrtarëve u rritën për 78%.


¹³ <https://vlada.mk/node/33235>

¹⁴ Në korrik të vitit 2023, qeveria nënshkroi një marrëveshje të re kolektive për sektorin publik, e cila përfshin një rritje rrogash prej 10% nga shtatori i vitit 2023, një rritje shtesë rrogash në shtator 2024, nëse norma vjetore e inflacionit në gjashtë muajt e parë të vitit 2024 kalon 3% (rroga bazë bruto rritet në përqindje për dallimin deri në 3%), dhe rishikimi i metodologjisë së përcaktimit të rrogave nga marsi i vitit 2025 që lidh rrogën bazë bruto me atë bruto mesatare në nivel shtetëror me një rritje të koeficientit të ndërlíkueshmërisë prej të paktën 5%. Gjithashtu, koeficienti i ndërlíkueshmërisë së punës do të përputhet me rritjen nominale të PBB-së, nëse është më i ulët se rritja e rrogës mesatare bruto.


¹⁵ Totali i rrogave bruto të paguara përfshin: rrogat neto të paguara për muajin raportues, tatimin personal të paguar dhe kontributet e paguara (për sigurim pensional dhe invalidor, për sigurim shëndetësor, për punësimin, për sëmundje profesionale). Të dhënat u referohen rrogave të paguara.

¹⁶ Normat me të cilat paguhen kontributet në vitin 2023 janë 18,8% për sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor dhe 7,5% për sigurimin shëndetësor të detyrueshëm, pra njësoj si një vit më parë.

Grafiku 13
Rrogat mesatare bruto dhe neto
(ndryshimet vjetore, në %)



Grafiku 24
Rrogat mesatare neto sipas sektorëve
(ndryshimet vjetore, në %)




Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe llogaritjet e BPRMV-së.

3.3. Financat publike

Gjatë vitit 2023, vërehet një thellim mesatar i deficitit buxhetor, i cili arriti në 4,9% të PBB-së (4,4% e PBB-së një vit më parë). Rritja e deficitit është rezultat i rritjes më të fortë të shpenzimeve buxhetore në raport me rritjen e të hyrave në buxhet, e cila më së shumti vjen si pasojë e shpenzimeve më të larta kapitale që lidhen me financimin e projekteve të infrastrukturës për korridoret 8 dhe 10d. Përkundrejt kësaj bilanci primar buxhetor¹⁷ është në nivelin 3,4% të PBB-së, ngjashëm me vitin 2022.

Gjatë vitit 2023 nuk kishte rebalancim të buxhetit, por vetëm dy rishpërndarje, me ndryshime në strukturën e shpenzimeve dhe të financimit të deficitit (përmes huamarrjes më të madhe të brendshme dhe rritjes së mjeteve në llogarinë e shtetit në Bankën Popullore). Deficiti i realizuar në fund të vitit është pak më i ulët se ai i planifikuar, për 1.336 milionë denarë ose për rreth 0,2 p.p. të PBB-së.

Grafiku 25
Tregues fiskalë (% të PBB-së)




Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritjet e BRPMV-së.

¹⁷ Bilanci primar buxhetor paraqet dallimin ndërmjet të hyrave totale buxhetore dhe shpenzimeve totale buxhetore, e reduktuar nga shlyerja e detyrimeve aktuale në bazë të huave të marra (interesi). Ky tregues fiskal konsiderohet më i përshtatshëm në analizën e rrjedhës aktuale të politikës, për faktin se nuk integron shpenzimet fiskale që lidhen me sjelljen e mëparshme të politikës fiskale në raport me borxhin publik.

Grafiku 26

Të hyrat dhe shpenzimet totale buxhetore dhe përbërësit kryesorë të tyre (% të PBB-së)



Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritjet e BRPMV-së.

Të hyrat totale buxhetore në vitin 2023 janë më të larta për 14,0% në bazë vjetore (pas rritjes prej 11,5% në vitin pararendës). Rritja e të hyrave totale rezultojnë nga rritja në pothuajse të gjitha kategoritë¹⁸, duke përfshirë të hyrave jotatimore, të cilat shënuan rënie. Gjatë vitit 2023, shpenzimet buxhetore shënuan rritje prej 14,3% në bazë vjetore (rritje prej 8,4% në vitin pararendës). Rritja e shpenzimeve është kryesisht për shkak të shpenzimeve kapitale, të cilat janë më të larta për 52,0% në bazë vjetore (rritje nga 22,3% në vitin pararendës), me një rritje të njëkohshme të shpenzimeve aktuale për 10,0% në bazë vjetore (rritje prej 7,0 % në vitin pararendës). Rritja vjetore e shpenzimeve kapitale është pothuajse tërësisht si pasojë e transfereve në Ndërmarrjen Publike të Rrugëve Shtetërore, për fillimin e ndërtimit dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore për korridoret 8 dhe 10d. Rritja e shpenzimeve aktuale rezultojnë më së shumti nga rritja e kategorisë së "transfereve"¹⁹, që lidhet me mbështetjen financiare të sektorit të energjisë²⁰ dhe shpenzimet më të larta për pensionet²¹. Deficiti buxhetor i realizuar në vitin 2023 është financuar kryesisht nëpërmjet huamarrjes neto të shtetit në tregun e brendshëm²², dhe nëpërmjet huamarrjes neto në tregun²³ e huaj, me rritje minimale të depozitave të shtetit në Bankën Popullore.

¹⁸ Në mars të vitit 2023 kishte rritje të donacioneve të huaja për shkak të grantit të marrë nga Bashkimi Europian në vlerë prej rreth 72 milionë euro, të paracaktuara për përballimin e krizës energjetike, ndërsa në periudhën tetor - dhjetor kishte një grumbullim të rreth 3.000 milionë denarë nga tatimi i solidaritetit.

¹⁹ Kategoria "transfereve" u referohet shpenzimeve për pensionet, shpenzimeve të mbrojtjes sociale, shpenzimeve të kujdesit shëndetësor dhe transfereve të tjera (kryesisht subvencione).


²⁰ Në periudhën maj-qershor 2023, për sektorin e energjisë janë paguar 3000 milionë denarë ndihmë shtetërore.

²¹ Shpenzimet për pensionet janë rritur për shkak të një rritjeje prej 8,4% në mars dhe 5,3% në shtator të vitit 2023, bazuar në rregullimet e rregullta të pensioneve (me rritjen e shpenzimeve të jetesës). Po ashtu, në periudhën nga janari deri në shkurt 2023, secilit pensionist me pension prej deri në 11.525 denarë i është paguar ndihmë prej 1.500 denarë në muaj dhe për pensionistët me pension prej 11.525 deri në 14.000 denarë, 750 denarë, në përputhje me masat për të ndihmuar grupet më të cenueshme të qytetarëve të miratuara në tetor të vitit 2022. Gjithashtu, në muajin nëntor u miratua pakaja e nëntë - masa e shtetit, sipas të cilave, të papunëve dhe shfrytëzuesve të ndihmës sociale në muajin dhjetor u janë paguar nga 3.000 denarë. Duke filluar nga dhjetori i vitit 2023, në pesë muajt e ardhshëm, pensionistët me pension deri në 14.000 denarë do të marrin 3.000 denarë në muaj; ata me pension nga 14.000 deri në 16.000 denarë do të marrin 2.000 denarë në muaj dhe pensionistët me të ardhura prej 16.000 denarë, deri në 19.000 denarë, në pesë muajt e ardhshëm do të kenë mbështetje prej 1.500 denarë.

²² Huamarrja e shtetit në tregun vendor, përveç letrave shtetërore të emetuara të vazhdueshme që emetohen sipas procedurës së rregullt, rezultojnë edhe nga disa obligacione të tjera, përkatësisht të sapofutura si: obligacione qytetare dhe të gjelbra. Në muajin korrik u emetua obligacioni i parë qytetar në vlerë prej 1.448 milionë denarë, me interes prej 5% dhe afat maturimi dyvjeçar dhe obligacioni i dytë qytetar në muajin nëntor në vlerë prej 1.085 milionë denarë, me interes prej 5% dhe afat maturimi dyvjeçar. Po ashtu, në tetor u emetua edhe obligacioni i parë i gjelbër në vlerë prej 600 milionë denarë, me interes prej 4,75% dhe afat maturimi dyvjeçar.

²³ Në mars u emetua eurobondi i nëntë në vlerën prej 500 milionë euro, me kupon 6,96%, me afat maturimi katërvjeçar. Në të kundërt, në korrik u pagua plotësisht eurobondi i emetuar në korrik 2016, në vlerën 450 milionë euro, për 7 vite dhe me interes prej 5,625%. Në dhjetor janë marrë këto kredi: nga Banka Botërore, në shumën prej rreth 94 milionë euro; nga OPEC, në shumën prej rreth 50 milionë euro dhe nga banka KfV, në shumën prej rreth 90 milionë euro.

Grafiku 27
Struktura e financimit të bilancit buxhetor*
(në milionë denarë)



* Ndryshimi negativ i depozitave në strukturën e financimit të bilancit buxhetor paraqet rritjen e depozitave shtetërore.
Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritjet e BRPMV-së.


Në aspektin e financimit përmes tregut vendor primar të letrave me vlerë, teprica e letrave me vlerë të emetuara u rrit për 33.264 milionë denarë dhe në fund të vitit ishte 186.586 milionë denarë. Emetimet e reja të letrave me vlerë të shtetit kryesisht kishin një afatizim më të gjatë se afati i letrave me vlerë që ishin maturuar, që kontribuoi në rritjen e maturimit mesatar të letrave me vlerë të shtetit të emetuara, kurse për rrjedhojë edhe në thellimin e këtij segmenti të tregut financiar, si dhe në rritjen e pjesëmarrjes së obligacioneve të shtetit në strukturën e letrave me vlerë të qeverisë. Krahas kësaj, vijon prirja e ndryshimeve të favorshme në strukturën valutore, e cila vihet re përmes rritjes së madhe të letrave me vlerë të emetuara të shtetit në valutën vendase.

Grafiku 28
Struktura valutore e letrave me vlerë të shtetit
(në milionë denarë)



Burimi: Ministria e Financave dhe BPRMV.

Grafiku 29
Struktura e maturimit të letrave me vlerë të shtetit
(në milionë denarë)




Për sa i përket humamarrjes totale të shtetit, borxhi i qeverisë qendrore ishte 53,0% e PBB-së në vitin 2023, krahasuar me 50,4% të PBB-së në vitin 2022. Gjatë uljes minimale të

borxhit të jashtëm të qeverisë qendrore, i cili është 30,5% të PBB-së (30,6% e PBB-së në vitin pararendës), rritja e totalit të borxhit rezulton nga rritja mesatare e borxhit të brendshëm, i cili është 22,5% të PBB-së (19,8% e PBB-së në vitin pararendës). Lëvizjet në totalin e borxhit publik janë të ngjashme²⁴, që në fund të vitit 2023 arriti në 62,1% të PBB-së (59,1% e PBB-së në vitin pararendës), me një borxh publik të jashtëm pak më të lartë (39,1% të PBB-së) dhe një rritje mesatare të borxhit të brendshëm publik (22,9% të PBB-së). Në kuadër të borxhit publik, borxhi i përgjithshëm shtetëror (borxhi i qeverisë qendrore, fondeve publike dhe bashkive) në vitin 2023 është 53,1% të PBB-së dhe është më i lartë për 2,6 p.p. krahasuar me një vit më parë, ndërsa borxhi i ndërmarrjeve publike (të garantuara dhe të pagarantuar)²⁵ është rritur në 8,9% të PBB-së. Për sa i përket strukturës së borxhit, njëlloj si në vitin 2022, nuk vërehen ndryshime të dukshme, kështu që në fund të vitit 2023 pjesëmarrja e borxhit shtetëror në totalin e borxhit publik është 85,6%, ndërsa borxhi i ndërmarrjeve publike (i garantuar dhe e pagarantuar) merr pjesë me 14,4%.

Grafiku 30

Borxhi i qeverisë qendrore dhe borxhi publik total (% e PBB-së)



Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritjet e BPRMV-së.

3.4. Bilanci i pagesave, MIP dhe borxhi i jashtëm


Në vitin 2023, stabilizimi gradual i ekonomisë globale dhe kushtet më të favorshme të tregtisë, veçanërisht çmimet më të ulëta të energjisë, çuan në përmirësimin e ndjeshëm të pozicionit të bilancit të pagesave. U arrit një rritje e ndjeshme e rezervave valutore, në kushtet e **suficitit të realizuar në llogarinë rrjedhëse dhe hyrjeve neto në llogarinë financiare**. Gjithashtu, bilanci pozitiv në llogarinë rrjedhëse në vitin 2023 është 0,7% e PBB-së, që është një përmirësim i dukshëm krahasuar me vitin e kaluar, kur u realizua një deficit

²⁴ Borxhi publik përkufizohet me Ligjin e Borxhit Publik ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 62/2005, 88/2008, 35/2011, 139/2014 dhe 98/2019), sipas të cilit përfaqëson shumën e borxhit shtetëror dhe borxhit të ndërmarrjeve publike të themeluara nga shteti ose nga komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit, si dhe shoqëritë tregtare që janë në pronësi të plotë ose të shumicës së shtetit ose komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit.

²⁵ Në përputhje me ndryshimet në Ligjin e Borxhit Publik, nga maji i vitit 2019, borxhi i pagarantuar i ndërmarrjeve publike dhe i shoqërive aksionare të themeluara nga shteti ose nga komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit llogaritet në borxhin publik ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 62/ 2005, 88/2008, 35/2011, 139/2014 dhe 98/2019).


prej 6,1% të PBB-së. Arsyeja kryesore e përmirësimit është ngushtimi i deficitit tregtar, me 7,8 p.p. nga PBB-ja, për të cilën kontributin kryesor e ka korrëgjimi në rënie i komponentit të importit, gjatë rënies minimale në të njëjtën kohë të eksportit të mallrave. Përmirësimi i kushteve të këmbimit ndërkombëtar dhe shterimi gradual i efekteve të rritjes së inventarëve të lëndëve të para në periudhën e mëparshme ndikuan në uljen e ndjeshme të trysnive të importeve në tregun e produkteve. Lëvizjet e favorshme ishin veçanërisht të rëndësishme në tregun e energjisë, ku u arrit një ulje më e madhe e çmimeve, e cila, së bashku me uljen e varësisë së ekonomisë vendase nga importet e energjisë dhe rritjen e prodhimit vendas të energjisë elektrike, kontribuoi në një përmirësim të ndjeshëm të bilancit energjetik dhe ngushtoi deficit tregtar. Në raport me komponentët e tjerë të bilancit të pagesave, suficiti në të ardhurat dytësore kontribuoi në përmirësimin e bilancit të llogarisë rrjedhëse, i cili u rrit më tej me bazë vjetore (për 0,5 p.p. të PBB-së dhe arriti në 19,7% të PBB-së), në kushtet e rritjes së mëtejshme vjetore të blerjes së efektives nga tregu valutor, por edhe rritjes së transfereve zyrtare. Nga ana tjetër, lëvizjet në komponentët e tjerë të llogarisë rrjedhëse janë më pak të favorshme krahasuar me vitin e kaluar. Kështu, u arrit një deficit më i lartë i të ardhurave parësore (për 1,1 p.p. të PBB-së), për shkak të daljeve më të larta të të ardhurave nga investimet, që më së shumti pasqyron stabilizimin e funksionimit të kapaciteteve të huaja dhe rritjen e fitimit të ri. Në këmbimin e shërbimeve u arrit një suficit më i ulët krahasuar me vitin e kaluar (për 0,4 p.p. të PBB-së), që është pasqyrim i faktorëve specifikë, pra rritjes së importit të shërbimeve që lidhen me ndërtimin e infrastrukturës rrugore (korridori 8 dhe 10d).

Grafiku 31
Llogari rrjedhëse dhe financiare
(në miliona euro)



Burimi: BPRMV.

Grafiku 32
Komponentët bazë të llogarisë rrjedhëse
(% e PBB-së)




Në vitin 2023, në llogarinë financiare të bilancit të pagesave u realizuan hyrje neto në vlerën 451,6 milionë euro ose 3,3% të PBB-së – më të ulëta krahasuar me vitin e kaluar. Flukset hyrëse neto në llogarinë financiare janë kryesisht për shkak të hyrjeve neto të realizuara të investimet e drejtpërdrejta, si dhe hyrjeve neto të huat. Investimet e huaja të drejtpërdrejta, neto, në vitin 2023 arrijnë në 523,1 milionë euro ose 3,8% të PBB-së dhe ndonëse janë më të ulëta në krahasim me vitin 2022 (për 1,2 p.p. të PBB-së), vazhdojnë të jenë solide dhe mbi mesataren e arritur në dy dekadat e fundit. E analizuar në aspekt strukturor, flukset e realizuara të investimet e huaja të drejtpërdrejta janë të favorshme, është realizuar një rritje në të tre komponentët, me pjesëmarrjen më të madhe të flukseve hyrëse neto në komponentin pa borxhe, në kapitalin aksionar. Një burim i rëndësishëm hyrjesh në llogarinë financiare në vitin 2023 ishte huamarrja e sektorit privat, por edhe e shtetit²⁶, me një kontribut më të vogël në aktivitetet e bankës qendrore për administrimin e rezervave

²⁶ Për të ofruar mbështetje financiare për tejkalimin e vështirësive ekonomike si pasojë e krizave të njëpasnjëshme në periudhën e kaluar, në dhjetor të vitit 2023, shteti lidhi marrëveshje kredie me "KFV Bank" (90 milionë euro), me Bankën Botërore (93,8 milionë euro) dhe me Fondin Ndërkombëtar të Zhvillimit në kuadër të Organizatës së Vendeve Eksportuese të Naftës (OPEC) (Marrëveshja e Huas për Programin e Qëndrueshmërisë dhe të Rezistencës – 50 milionë euro).

valutore (flukse hyrëse neto të realizuara në kreditë afatshkurtra). Nga ana tjetër, flukse dalje neto të larta janë vërejtur në kategorinë valutë dhe depozita, e cila u detyrohet tërësisht daljeve neto në sektorë të tjerë. Investimet e institucioneve depozituese në letrat me vlerë të borxhit dhe investimet e institucioneve të tjera financiare në letra me vlerë të kapitalit kontribuan në daljet mbi bazë neto në investimet e portofolit. Zhvlerësimi i sektorit të korporatave, pra ulja e detyrimeve të bazuara në operacionet tregtare, çoi në dalje neto në kategorinë e kredive dhe paradhënieve tregtare.

Grafiku 33


Llogaria financiare (% e PBB-së)



Burimi: BPRMV.

Grafiku 34

Investimet e drejtpërdrejta (% e PBB-së)




Pas zgjerimit të deficitit tregtar në dy vitet e fundit, ndërkaq në kushtet e goditjeve të pafavorshme globale, në vitin 2023 u shënua një ulje e ndjeshme me bazë vjetore prej 26,1% (ose për 8,7 p.p. të PBB-së). Ngushtimi i deficitit është kryesisht pasojë e trysnive të reduktuara ndaj importeve, me kushte të përmirësuara të ndjeshme të këmbimit. Reduktimi i importeve pasqyron edhe shterimin gradual të efekteve të rritjes së inventarëve të kompanive në dy vitet e fundit me pasiguri jashtëzakonisht të lartë.

Përkundër ritmeve të rritjes nominale dyshifrore të eksportit të mallrave (mesatarisht rreth 20%), në vitin 2023 u arrit një rritje minimale vjetore prej 0,3%. Rritje të eksporteve u vërejtën në kapacitetet industriale që lidhen me industrinë e automobilave, e cila vihet re përmes rritjes së eksporteve të pajisjeve dhe makinerive, automjeteve dhe mobileve. Kontribut shtesë kanë aktivitetet tradicionale, veçanërisht rritja e eksportit të ushqimeve, pijeve dhe duhanit, produkteve nga industria farmaceutike dhe tekstile. Nga ana tjetër, konjunktura e pafavorshme e tregjeve botërore, ulja e çmimeve të aksioneve dhe kërkesa për eksport, ndikuan në ecurinë negative të eksportit të industrisë së përpunimit të metaleve dhe minierave, të cilat ishin kategoritë nga të cilat u ul rritja e eksporteve. Ndikim të ngjashëm, por me një kontribut më të vogël, kishte edhe reduktimi i eksportit të energjisë, duke pasqyruar uljen e eksportit të derivateve të naftës, në kushtet e rritjes së mëtejshme, por më të ngadaltë të eksportit të energjisë elektrike. Rritja e prodhimit vendor të energjisë elektrike, me konsum më të ulët të brendshëm, pjesërisht për shkak të kushteve jashtëzakonisht të ngrohta të motit në periudhën e dimrit, kontribuoi në rritjen e mëtejshme të eksportit të energjisë elektrike në baza vjetore.

Nga ana tjetër, importi i mallrave në vitin 2023 shënoi rënie prej 8,1%, në bazë vjetore, kryesisht për shkak të arritjeve më të mira në komponentin energjetik, i cili kontribuoi në rreth 70% të reduktimit të importit. Në të njëjtën kohë, gjysma e kontributit të importit të reduktuar të energjisë i takon importit të energjisë elektrike, para së gjithash si rezultat i rritjes së prodhimit vendor të energjisë elektrike, me lëvizje të njëkohshme në rënie të çmimeve të aksioneve në tregjet e energjisë. Në zvogëlimin e importeve kontribuojnë edhe burimet e tjera


të energjisë, si ulja e importit të naftës e derivateve të naftës dhe gazit, që kryesisht paraqet efekt çmimi, me çmime dukshëm më të ulëta të importit, të shoqëruara me ulje të vëllimit të importeve në baza vjetore. Importet më të ulëta të lëndëve të para patën të njëjtin ndikim, duke marrë parasysh bazën e lartë krahasuese nga viti i kaluar kur inventarët u rritën, dhe në një masë më të vogël për shkak të aktivitetit më të dobët të kapaciteteve të industrisë metalike.

Grafiku 35
Kontributet në ndryshimin vjetor të eksporteve
(në p.p.)




Burimi: ESHS.

Grafiku 36
Kontributet në ndryshimin vjetor të importeve
(në p.p.)




Sa u përket treguesve të konkurrencës së çmimeve të ekonomisë vendase²⁷, në vitin 2023, kursi real efektiv valutor i deflatuar nga shpenzimet e jetesës arriti një mbivlerësim prej 2,5% në bazë vjetore, ndërsa indeksi i llogaritur me çmimet e prodhuesve industrialë arriti një mbivlerësim prej 3,7%. Në të njëjtën kohë, kursi efektiv nominal valutor u vlerësua për 2,8% në bazë vjetore, si rezultat i nënvlerësimit të mëtejshëm të lirës turke në raport me denarin. Shpenzimet relative të jetesës pësuan rënie të lehtë prej 0,3%, ndërsa çmimet relative të prodhuesve të mallrave industriale u rritën për 0,8%.

Grafiku 37
NEDK dhe REDK, duke përjashtuar produktet
primare të llogaritura sipas indeksit të
shpenzimeve të jetesës dhe çmimeve të
prodhimit (2015=100)



Burimi: BPRMV.

Grafiku 38
Çmimet relative (2015=100)




²⁷ Analiza e treguesve të konkurrencës së çmimeve bazohet në indekset REDK, të llogaritura me ponderët e bazuar në tregtinë e jashtme pa produkte primare. Produktet primare që nuk përfshihen në përlogaritje janë: nafta dhe derivatet e naftës, hekuri dhe çeliku, xehet dhe lëndët e para të importuara për kapacitetet e reja industriale në pronësi të huaj.

Në fund të vitit 2023, pozicioni negativ i investimeve ndërkombëtare neto (NIP) i ekonomisë vendase është 8.500,1 milionë euro ose 62,2% të PBB-së. Krahasuar me situatën në fund të një viti më parë, është më e mirë për 0,3 p.p. të PBB-së, në kushtet e rritjes më të lartë të mjeteve ndërkombëtare sesa rritja e detyrimeve ndërkombëtare (për 2,8 p.p., përkatësisht 2,5 p.p. të PBB-së). Analiza sektorale e MIP-it tregon se përmirësimi vjen më së shumti nga rritja e mjeteve neto të bankës qendrore në bazë vjetore, si rezultat i rritjes së rezervave valutore. Të njëjtin ndikim kishin edhe detyrimet neto më të ulëta në institucionet depozituese. Nga ana tjetër, pjesa tjetër e sektorëve shënoi rritje të detyrimeve neto me bazë vjetore, si rezultat i rritjes së detyrimeve në bazë të investimeve të drejtpërdrejta. Pozicioni neto negativ i shtetit është rritur gjithashtu, si pasojë e rritjes së detyrimeve neto të bazuara në investimet e portofolit, pra letrat me vlerë të borxhit, si dhe të bazuara në kreditë afatgjata.

Grafiku 39


Pozicioni i investimeve ndërkombëtare (% e PBB-së)



Burimi: BPRMV.

Grafiku 40


Pozicioni i investimeve ndërkombëtare, sipas sektorëve (% e PBB-së)



Borxhi i jashtëm bruto në fund të vitit 2023 është 11.097 milionë euro²⁸ ose 81,3% e PBB-së, e cila paraqet një rritje me bazë vjetore (për 1,9 p.p. të PBB-së). Ky realizim vjen kryesisht nga rritja e borxhit të sektorit publik për 1,6 p.p. të PBB-së, me një rritje të vogël të borxhit privat për 0,3 p.p. të PBB-së. Borxhi më i lartë i sektorit publik është në pjesën më të madhe rezultat i rritjes së borxhit të qeverisë qendrore me detyrime më të larta në bazë të letrave me vlerë të borxhit, si dhe në bazë të kredive afatgjata. Nga ana tjetër, rritja vjetore e borxhit privat rezulton kryesisht nga rritja e borxhit ndërmjet kompanive të subjektet e lidhura me kapitalin.

Grafiku 41

Borxhi i jashtëm bruto, sipas huamarrësve dhe sektorëve institucionalë (% e PBB-së)



Burimi: BPRMV

²⁸ Të dhënat e borxhit të jashtëm bruto dhe neto nuk përfshijnë detyrimet e bankës qendrore bazuar në marrëveshjet repo.

Treguesit e borxhit të jashtëm të ekonomisë së brendshme vazhdojnë të jenë në zonën e sigurt. Pjesëmarrja e borxhit të jashtëm bruto në PBB vazhdon të tregojë një huamarrje të lartë, ndërsa të gjithë treguesit e tjerë tregojnë huamarrje të ulët të ekonomisë vendore. Megjithatë, pjesëmarrja e lartë strukturore në borxhin e jashtëm bruto të detyrimeve bazuar në investimet e drejtpërdrejta, si formë relativisht e qëndrueshme e financimit të kompanive me kapital të huaj, si dhe të detyrimeve të bazuara në kreditë tregtare që janë instrument financimi në tregtinë ndërkombëtare, zbut profilin e rrezikut në lidhje me pozicionin e borxhit të ekonomisë. Në fakt, niveli i borxhit të jashtëm bruto, pa përfshirë kreditë tregtare dhe borxhin ndërmjet kompanive, është më i ulët dhe arrin në 50,3% të PBB-së²⁹, që është tregues i huamarrjes mesatare.

Tabela 2
Treguesit e huamarrjes së jashtme

Treguesi i borxhit të jashtëm	Aftësia paguese				Likuiditeti		
	Shlyerja e interesit/ eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyrave tjera	Borxhi bruto/ eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyrave tjera	Borxhi bruto/ PBB	Shlyerja e interesit/ eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyrave tjera	Rezerva valutore/ borxh afatshkurtër	Rezerva valutore/ borxh afatshkurtër me maturim të mbetur*	Borxh afatshkurtër/ Borxhi total
	në %				raport	raport	në %
31.12.2004	2.4	129.3	47.3	12.4	1.1	0.9	30.3
31.12.2005	2.7	147.0	54.2	11.1	1.7	1.0	26.7
31.12.2006	3.4	131.3	49.8	21.7	2.0	1.3	29.0
31.12.2007	2.8	119.3	51.3	19.4	1.3	1.1	39.8
31.12.2008	2.7	116.9	54.1	10.2	1.3	0.9	35.2
31.12.2009	2.4	131.0	57.8	11.8	1.3	0.9	32.9
31.12.2010	3.2	140.4	59.7	13.9	1.5	1.0	27.9
31.12.2011	3.1	148.4	64.6	16.8	1.8	1.2	25.2
31.12.2012	2.9	142.1	67.6	13.1	1.6	1.0	26.7
31.12.2013	2.5	137.3	67.3	15.8	1.6	1.1	23.3
31.12.2014	3.0	148.9	74.0	17.2	1.8	1.1	22.3
31.12.2015	2.7	143.4	73.2	19.9	1.7	1.1	21.3
31.12.2016	2.4	148.8	79.3	14.8	1.7	1.2	21.9
31.12.2017	2.7	138.6	76.9	12.7	1.3	0.9	23.9
31.12.2018	2.2	130.7	77.3	15.7	1.4	1.0	25.8
31.12.2019	2.0	121.9	76.3	9.0	1.6	1.0	25.6
31.12.2020	1.9	122.3	77.9	13.6	1.9	1.1	20.4
31.12.2021	2.2	126.6	83.4	16.3	1.8	1.3	21.5
31.12.2022	1.8	123.4	86.9	9.4	1.5	1.0	24.7
31.12.2023	2.4	115.2	86.4	14.7	1.8	1.2	22.6
Kritere për debitim të moderuar	12 - 20%	165 - 275%	30 - 50%	18 - 30%	1.00		

*Kriteri për debitim të moderuar është marrë sipas metodologjisë së Bankës Botërore për përgaditjen e treguesve të debitimit, e cila nënkupton përdorimin e mesatareve lëvizëse trevjeçare të PBB-së dhe eksportit të mallrave dhe shërbimeve dhe të hyrave tjera, si emërues në llogaritjen e treguesve.

E hartuar në pajtim me "External debt statistics: Guide for compilers and users", i emetuar nga FMN-ja.

Sipas rregullës së Grinspan dhe Guidoti, e nevojshme është që vendi ta ruaj mbulimin e tërë të borxhit afatshkurtër (maturim i mbetur) me rezerva valutore.

Burimi: BPRMV-ja.

Më 31.12.2023, borxhi i jashtëm neto është 4.093 milionë euro ose 30% e PBB-së, që krahasuar me fundin e një viti më parë paraqet një rënie prej 0,8 p.p. të PBB-së. Kjo vjen si pasojë e uljes së borxhit publik neto (për 1,8 p.p. të PBB-së), ndërsa në të njëjtën kohë borxhit neto privat më të lartë (për 1,0 p.p. të PBB-së).

²⁹ Ka të bëjë me borxhin pa marrëveshjet repo.


3.5. Agregatët monetarë dhe kreditorë³⁰

3.5.1. Agregatët monetarë

Gjatë vitit 2023 paraja e gjerë dhe totali i depozitave në sektorin financiar³¹ realizuan rritje solide, që ishte më e fortë krahasuar me një vit më parë. Rritja e parasë më të gjerë më të madhe M4 dhe e depozitave korrespondon me stabilizimin gradual të flukseve ekonomike, me pozicionin jashtëzakonisht të favorshëm të jashtëm të ekonomisë, si dhe me kushtet më tërheqëse të kursimit. Mjedisi kryesisht më i mirë perceptohet edhe nëpërmjet përmirësimit të strukturës së afatizimit dhe valutore të kursimeve, që tregon për rritjen e besimit në valutën vendase dhe të besimit në sistemin bankar, në të cilën kontribuojnë edhe masat e ndërmarra nga Banka Popullore. Gjithashtu, gjatë vitit 2023, shteti pagoi ndihma financiare për mbështetjen e sektorit energjetik në përballjen me krizën energjetike dhe në fund të vitit pagoi edhe mbështetje financiare për kategoritë e cenueshme të amvisërive në kuadër të paketës së miratuar të masave kundër krizës, të cilat gjithashtu kontribuan në rritjen e shtuar të parasë së gjerë dhe të totalit të depozitave në sektorin financiar.

Grafiku 42


Paraja e gjerë M4 dhe depozitat totale



Burimi: BPRMV

Grafiku 43

Paraja e gjerë M4, pjesëmarrja në PBB



Në vitin 2023, paraja e gjerë më e madhe M4 shënoi rritje vjetore të forcuar, e cila arriti në 8,7% (rritje prej 5,1% në vitin 2022). Vështruar në aspekt strukturor, rritje vjetore vërehet në të gjithë komponentët, por nxitësit e rritjes së parasë së gjerë janë paraja depozituese dhe depozitat afatgjata (me rritje prej 12,4%, përkatësisht 21,1%). Treguesi e pjesëmarrjes së ndryshimit vjetor të parasë së gjerë në PBB u rrit dhe në fund të vitit ishte 5,7% (3,3% më 2022). Në të njëjtën kohë, pjesëmarrja e parasë së gjerë M4 në PBB në fund të vitit ishte 70,8%, kundrejt 68,2% në vitin pararendës.

³⁰ Të dhënat për totalin e depozitave dhe të kredive të gushtit të vitit 2020 e në vazhdim nuk përfshijnë të dhënat për një bankë të cilës i është hequr licenca e themelimit dhe e punës në gusht të vitit 2020 dhe inicoi procedurë falimentimi. Për të perceptuar më realisht flukset e realizuara në sistemin bankar, pa efekt të një ndryshimi të tillë në paraqitjen e të dhënave në statistikën monetare, në realizimin e totalit të flukseve të depozitave dhe kredive në vitin 2020, janë bërë përshtatjet e rrjedhshme me të dhënat për bankën përkatëse. Konkretisht, përshtatja për gjithsej depozitat bëhet duke përfshirë shumën e depozitave që nuk i nënshtrohet kompensimit përmes FOD në gjendjen aktuale të gjithsej depozitave, ndërsa rregullimi për totalin e kredive bëhet duke përfshirë të dhënat e korrikut për gjendjen e kredive të bankës në gjendjen aktuale të totalit të kredive.


³¹ Të dhënat kanë të bëjnë me depozitat e sektorit joshjetëror në banka dhe bankat e kursimit, mjetet e institucioneve të tjera financiare në llogaritë në Bankën Popullore dhe mjetet e njësive të vetëqeverisjes lokale në llogaritë në Bankën Popullore. Të dhënat korrespondojnë me ndryshimet metodologjike të të qershori të vitit 2018 të Bankës Popullore. Më shumë informacion rreth ndryshimeve metodologjike mund të gjeni në këtë vjeggj: http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nspk.

Tabela 3
Komponentët e parasë së gjerë - kushtet dhe ndryshimet

	Gjendja			Ndryshimi vjetor		
	2021	2022	2023	2021	2022	2023
	në miliona denarë			në %		
Para të gatshme në qarkullim	44,480	47,494	49,826	1.8	6.8	4.9
Para të depozituara	177,716	188,036	211,402	10.5	5.8	12.4
M1	222,196	235,530	261,228	8.7	6.0	10.9
Depozita afatshkurtër në denarë deri 1 vit	40,033	39,429	40,454	-9.1	-1.5	2.6
Depozita afatshkurtër valutore deri 1 vit	160,778	175,061	175,405	19.1	8.9	0.2
M2	423,007	450,020	477,087	10.3	6.4	6.0
Depozita afatgjatë në denarë mbi 1 deri 2 vite	27,727	28,003	32,088	-9.6	1.0	14.6
Depozita afatgjatë valutore mbi 1 deri 2 vite	24,020	21,779	19,912	8.6	-9.3	-8.6
M3	474,753	499,803	529,087	8.8	5.3	5.9
Depozita afatgjatë në denarë mbi 2 vite	29,376	25,521	31,162	-15.3	-13.1	22.1
Depozita afatgjatë valutore mbi 2 vite	16,876	22,031	34,725	4.9	30.5	57.6
Depozita totale (pa para të depozituara)	298,809	311,825	333,746	5.8	4.4	7.0
Depozita në total	476,525	499,861	545,149	7.5	4.9	9.1
M4	521,005	547,355	594,975	7.0	5.1	8.7


Burimi: BPRMV

Grafiku 44
Paraja e gjerë, ndryshimi vjetor dhe struktura



Në vitin 2023, rritja e totalit të depozitave në sektorin financiar u përshpejtua ndjeshëm dhe arriti në 9,1% me bazë vjetore (nga 4,9% më 2022). Nga pikëpamja sektoriale, depozitat shënuan rritje në të gjithë sektorët, por më së shumti te amvisëria dhe ndërmarrjet (me një kontribut prej 5,1 p.p., përkatësisht 3,8 p.p.), me një kontribut të vogël edhe nga sektorët e tjerë (0,2 p.p.). Nga aspekti valutor, ka rritje më të theksuar te depozitat në denarë (përfshi edhe paratë depozituese), me rritje më mesatare të depozitave në valuta.

Grafiku 45
Totali i depozitave (me para depozite), ndryshimi vjetor dhe kontributi në ndryshim nga këndvështrimi sektoral




Burimi: BPRMV.

Depozitat e amvisërive³² shënuan rritje vjetore prej 7,9% më 2023 (5,8% më 2022). Makromjedisi relativisht i favorshëm, rritja e të ardhurave të disponueshme, mbështetja nga shteti nëpërmjet masave fiskale, si dhe lëvizja në rritje e normave të interesit të depozitave kontribuan në rritjen më të fortë të kursimeve të amvisërive. Ndryshimet në strukturën valutore dhe të maturimit të depozitave të popullsisë në favor të kursimeve në valutën vendase dhe në afate më të gjata tregojnë përmirësime të ndjeshme dhe të qëndrueshme të pritshmërive të subjekteve ekonomike.

³² Të dhënat e depozitave përfshijnë edhe paratë e depozituara.

Grafiku 46


Totali i depozitave të amvisërive, ndryshimi vjetor dhe kontributi në ndryshim sipas maturimit dhe strukturës valutore



Burimi: BPRMV.

Grafiku 47

Totali i depozitave të korporatave, ndryshimi vjetor dhe kontributi në strukturën e maturimit dhe atë valutore



Në vitin 2023, depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje të fortë prej 13,2% (3,7% në vitin 2022). Trysni të pakësuar të kompanive për nevojat e likuiditetit çuan në rritje të depozitave të korporatave gjatë vitit 2023, në ndryshim nga viti 2022 kur kishte më shumë shpenzime nën ndikimin e krizës energjetike dhe të importe më të shtrenjta. Nga pikëpamja strukturore, depozitat afatshkurtra dhe afatgjata të ndërmarrjeve janë në rritje, me bazë vjetore. Nga pikëpamja valutore, kontributi i depozitave në denarë (përfshirë paratë e depozituara) është dukshëm më i lartë se depozitat në valuta të ndërmarrjeve.


Shkalla e euroizimit, e matur nga pjesëmarrja e depozitave me komponent valutore në totalin e depozitave të sistemit bankar u pakësua në vitin 2023 dhe u ul në 43,1% (44,5% një vit më parë). Në mesin e depozitave të amvisërive, pjesëmarrja e depozitave me komponent valutore gjithashtu u pakësua dhe u ul në 50,2% (52% një vit më parë).

3.5.2. Aktiviteti kreditor

Gjatë vitit 2023, sektori bankar vazhdon të ofrojë mbështetje solide kreditore për ekonominë vendase, megjithëse rritja e totalit të kredive u ngadalësua dhe ishte 5,1% (9,4% më 2022). Aktiviteti mesatar kreditues i bankave është në përputhje me drejtimin e politikës monetare, duke ruajtur qëndrueshmërinë e bilanceve të bankave, që shihet nëpërmjet treguesve të aftësisë së pagesës, likuiditetit dhe cilësisë së portofolit. Rritja vjetore e totalit të kredive në fund të vitit 2023 ishte gjithashtu më mesatare dhe ishte 2,6% të PBB-së (4,5% e PBB-së më 2022), ndërsa pjesëmarrja e kredive në PBB për vitin 2023 ishte 52,9% (52,7% më 2022).

Grafiku 48


Totali i kredive dhe norma aktive e interesit



Burimi: BPRMV.

Grafiku 49

Totali i kredive, pjesëmarrja në PBB




Sipas Anketës për aktivitetin kreditor të Bankës Popullore, në vitin 2023 vërehet një rënie neto e kërkesës për kredi, më e fortë tek amvisëritë dhe më mesatare te ndërmarrjet, me një shtrëngim neto të kushteve të kreditimit në të dy sektorët, krahasuar me vitin e kaluar. Nga aspekti i rreziqeve që analizohen në bazë të pritshmërive të bankave për aktivitetin e përgjithshëm ekonomik, vazhdon të ketë një rritje të perceptimit të rrezikut te ndërmarrjet, por më mesatare krahasuar me vitin 2022, ndërsa tek amvisëritë perceptimet e rrezikut janë rritur ndjeshëm krahasuar me vitin 2022.

Vëzhguar nga këndvështrimi sektorial, rritja e mbështetjes kreditore të bankave për kompanitë në vitin 2023 ishte dukshëm më mesatare dhe ishte 3,3% me bazë vjetore (11,5% më 2022), me ulje të nevojave për likuiditet të kompanive dhe stabilizim të situatës së krizës energjetike dhe furnizimit të tregjeve. Për sa i përket kreditimit të amvisërive³³, në vitin 2023 u vu re një ngadalësim i lehtë i rritjes, në 6,8% (7,4% më 2022). Analiza sipas llojeve individuale të kredive tregon për një rritje më të dobët të kredive banesore, me dinamikë relativisht të njëjtë të rritjes së kredive konsumatore, krahasuar me vitin 2022. Sa i përket strukturës valutore të rritjes së gjithsej kredive, kontribut më të madh pozitiv kanë kreditë në valutë vendore, ndërsa më të dobët kreditë në valuta të huaja (përfshirë kreditë në denarë me klauzolë valutore).

³³ Pa kreditë e kryerësve të pavarur të veprimtarisë me kontribut personal.

Grafiku 50


Totali i kredive, ndryshimi vjetor dhe struktura sektorale



Burimi: BPRMV.

Grafiku 51


Totali i kredive të amvisërive, ndryshimi vjetor dhe struktura sipas qëllimit



*Në totalin e kredive të popullsisë nuk janë të përfshira kreditë e individëve të vetëpunësuar.

Grafiku 52

Oferta dhe kërkesa (përqindjet neto)*




* Për sa u përket kushteve të kreditimit, një normë neto negative e interesit nënkupton lehtësim të kushteve të kreditimit. Në kërkesë, një përqindje neto negative nënkupton një ulje të kërkesës.

Informacion më të hollësishëm në lidhje me anketat e aktivitetit kreditor mund të gjenden në faqen e internetit të BPRMV-së.

Burimi: Anketa e aktivitetit kreditor, BPRMV.

Grafiku 53

Perceptimet e rrezikut nga bankat (përqindjet neto)*



* Në rastin e amvisërive, tregohet mesatarja e përqindjeve neto të faktorëve të rrezikut që ndikojnë në kushtet e kreditimit gjatë miratimit të kredive banesore dhe konsumatore.

IV. Mjedisi makroekonomik dhe politika monetare në periudhën 2024 - 2026

Politika monetare e Bankës Popullore do të vazhdojë të synojë ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, si objektiv bazë monetar i përcaktuar në përputhje me dispozitat ligjore³⁴. Në periudhën e ardhshme, Banka Popullore do të kontribuojë edhe në ruajtjen e një sektori bankar të qëndrueshëm dhe konkurrues dhe do të mbështesë politikën e përgjithshme ekonomike dhe rimëkëmbjen ekonomike, pa e rrezikuar arritjen e qëllimit kryesor. Për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj, Banka Popullore do të vazhdojë me strategjinë e mbajtjes stabile të kursit nominal të denarit në raport me euron. Rëndësia e kursit valutor për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe pritshmëritë e qëndrueshme inflacioniste të subjekteve ekonomike burojnë nga karakteristikat e ekonomisë vendase, si e vogël dhe e hapur, me një varësi të lartë nga importet. Këto aspekte janë veçanërisht të rëndësishme në kushtet e trysnive të theksuara të çmimeve të jashtme dhe goditjeve në anën e ofertës. Kuadri operacional i politikës monetare, si edhe më parë, do të vendoset mbi baza të përshtatshme, për të ruajtur stabilitetin dhe likuiditetin e tregut valutor dhe stabilizimin e inflacionit në periudhën afatmesme. Në këtë mënyrë, politika monetare do të kontribuojë në ruajtjen e stabilitetit të përgjithshëm makroekonomik, si faktor kyç në krijimin e një mjedisi të favorshëm për rritjen e qëndrueshme ekonomike.

Gjatë vitit 2023, Banka Popullore vazhdoi shtrëngimin e politikës monetare, e cila filloi në fund të vitit 2021. Konkretisht, gjatë vitit 2023, norma bazë e interesit u rrit gjashtë herë, në total për 1,55 p.p. Kështu, norma e interesit për bonot e thesarit nga fundi i shtatorit 2023 u vendos në nivelin 6,30%, ndërsa normat e interesit për depozitat njëditore dhe shtatëditore në nivelet 4,20%, përkatësisht 4,25%. Shtrëngimi i politikës monetare u kushtëzua nga nevoja për stabilizimin e mëtejshëm të inflacionit dhe pritshmëritë inflacioniste në baza më të qëndrueshme. Pozicionimi monetar u mbështet më tej nga ndryshimet në instrumentin e rezervës së detyrueshme. Për të forcuar efektet pozitive të këtyre masave të deritashme, në gusht dhe shtator, Këshilli i Bankës Popullore miratoi dy amendamente shtesë të instrumentit të rezervës së detyrueshme (zbatimi i të cilave ka hyrë në fuqi në nëntor, përkatësisht dhjetori 2023), për të mbështetur më tej procesin e denarizimit të balanceve të bankave. Masat makroprudenciale të miratuara, pra rritja e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit, si dhe masat lidhur me përcaktimin e kufijve të monitorimit të cilësisë së kërkesës së kreditimit, janë të përshtatshme për ndryshimet monetare. Kështu, në tremujorin e fundit, Banka Popullore miratoi një masë makroprudenciale për të rritur më tej normën e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet e bankave vendase në vend, në nivelin 1,5%, për të forcuar më tej pozicionin kapital të bankave. Niveli aktual i normës bazë të interesit, së bashku me ndryshimet në rezervën e detyrueshme, si dhe me masat makroprudenciale të ndërmarra, lejojnë që inflacioni të ngadalësohet në përputhje me pritshmëritë dhe të ruhet stabiliteti i kursit valutor. Po ashtu, duke pasur parasysh strategjinë monetare të kursit të qëndrueshëm valutor të denarit në raport me euron, ndryshimet në politikën monetare vendore pasqyrojnë edhe pozicionimin e politikës monetare të Bankës Qendrore Europiane, e cila ka kontribuar edhe në ashpërsimin e politikës monetare.

Sipas parashikimeve të fundit zyrtare makroekonomike të Bankës Popullore, në periudhën e ardhshme pritet një përmirësim i mjedisit të jashtëm, i cili në kombinim me disa faktorë specifikë vendorë, veçanërisht të lidhur me ciklin e infrastrukturës publike, do të mbështeste përsheptimin e rritjes ekonomike të vendit. Kështu, pritet që në vitin 2024 rritja e PBB-së të arrijë në 3%. Për vitin 2025, vlerësohet se rritja do të përsheptohet, duke shkuar

³⁴ Ky seksion ofron një pasqyrë të parashikimeve makroekonomike të Bankës Popullore të tetorit 2023.

në 4%, dhe me këtë dinamikë do të lëvizë edhe në vitin 2026. Nga pikëpamja strukturore, rritja do të ishte si pasojë e kërkesës së brendshme, me një kontribut negativ nga eksportet neto. Në kuadër të kërkesës së brendshme, kontributi më i madh pozitiv pritet nga investimet bruto dhe konsumi i amvisërive do të jetë një faktor i rëndësishëm i rritjes. Në fakt, në periudhën e ardhshme pritet një rimëkëmbje më e ndjeshëm e investimeve bruto, për shkak të përmirësimit të performancës së projekteve kapitale të infrastrukturës që lidhen me ndërtimin e korridoreve rrugore dhe investimeve private vendase dhe të huaja, të cilat do ta bëjnë këtë komponent më të rëndësishmin për rritjen. Në të njëjtën kohë, pritet një rritje mesatarisht më e fortë e konsumit personal, e cila do të rezultojë kryesisht nga dinamika e të ardhurave të disponueshme, brenda së cilës niveli i rrogave është shtytësi kryesor i rritjes. Rritje solide pritet edhe në eksportin e mallrave dhe shërbimeve, si rezultat të rimëkëmbjes së kërkesës së huaj, e cila do të nxiste segmentin tradicional dhe atë të ri të eksportit. Rritja e eksporteve dhe e kërkesës së brendshme dhe mbi të gjitha investimet që lidhen me aktivitetet në ndërtimin e infrastrukturës rrugore që do të kryhet nga një kontraktor i huaj, do të kontribuojnë në rritjen e importit të mallrave dhe shërbimeve në afat të mesëm. Për më tepër, në skenarin aktual, nuk supozohen përshkallëzime të mëdha në lidhje me veprimet ushtarake në Ukrainë dhe Lindjen e Mesme.

Nga pikëpamja e çmimeve të konsumit, norma mesatare e inflacionit do të vazhdojë të ngadalësohet, duke u ulur në 3,5% - 4% në vitin 2024, ndërsa për periudhën 2025 - 2026 do të ulet në mesataren historike prej 2%. Pritet një rregullim në rënie i çmimeve në periudhën e ardhshme për të tre komponentët, në kushtet kur vlerësohet një rënie e mëtejshme e çmimeve në bursë të ushqimeve dhe naftës, një ngadalësim i mëtejshëm i inflacionit të jashtëm efektiv dhe mungesës së trysnive të ndjeshme nga kanali i kërkesës së brendshme dhe hendeikut të prodhimit. Rreziqet për projeksionin e inflacionit vazhdojnë të jenë të lidhura me pasigurinë me lëvizjet e ardhshme të çmimeve botërore të energjisë dhe ushqimeve, për shkak të tensioneve gjeopolitike dhe ndryshimeve klimatike, si dhe me politikat që ndikojnë në kërkesën agregate në ekonominë vendase.

Vlerësimet e lëvizjeve në sektorin e jashtëm tregojnë një rritje të lehtë të deficitit të llogarisë rrjedhëse për vitin 2024 në nivelin 2,4% të PBB-së. Kjo do të rezultonte nga thellimi mesatar i deficitit tregtar, si pasojë e rritjes graduale të tregtisë dhe normalizimit të dinamikës së importit të mallrave, si dhe nga pritshmëritë për uljen e mëtejshme të suficitit në të ardhurat dytësore (si pjesëmarrje në PBB), për shkak të stabilizimit të transfereve private. Nga ana tjetër, pritet që të vazhdojnë arritjet solide të eksportit në shërbime, ndërsa nga viti 2024 pritet një efekt pozitiv edhe nga eksporti i shërbimeve që lidhen me zbatimin e projekteve të infrastrukturës rrugore, që do të çonte në një suficit më të madh në këtë komponent. Në periudhën afatmesme, deficitin e llogarisë rrjedhëse pritet të stabilizohet (2,4% e PBB-së në vitin 2025, pra 2,3% e PBB-së në vitin 2026). Flukset hyrëse financiare neto të pritshme në periudhën e projektimit 2024-2026 do të mundësonin financimin e plotë të deficitit të llogarisë rrjedhëse, si dhe rritjen shtesë të rezervave valutore. Nga pikëpamja strukturore, pjesa më e madhe e hyrjeve financiare mbi bazën neto priten në formën e investimeve të huaja të drejtpërdrejta dhe të huamarrjes afatgjate të shtetit. Është e rëndësishme të theksohet se gjatë gjithë periudhës së projeksionit, pritet që rezervat valutore të ruhen në nivelin që korrespondon me standardet ndërkombëtare për ruajtjen e stabilitetit të kursit valutë.

Aktiviteti kreditues i sistemit bankar vazhdon të jetë një nga faktorët e rëndësishëm për mbështetjen e rritjes ekonomike. Me përsheptimin gradual të rritjes ekonomike dhe stabilizimin e pritshmërive, në periudhën e ardhshme pritet përsheptimi i rritjes dhe i aktivitetit kreditor, ku rritja e kredive për periudhën 2024 - 2026 do të ishte mesatarisht 6,9%. Nga këndvështrimi i burimeve të financimit, pritet që rritja e kredive, si më parë, të mbështetet nga rritja e depozitave, të cilat pritet të kenë ritme solide rritjeje gjatë gjithë periudhës së

projeksionit, duke pasur parasysh kushtet më tërheqëse për kursime, si pasqyrim i masave të ndërmarra nga Banka Popullore dhe rritja e besimit në valutën vendase, por edhe për shkak të rritjes së pritshme të të ardhurave monetare të popullsisë.

Rreziqet kryesore në lidhje me rritjen globale dhe mjedisin e jashtëm në periudhën e ardhshme janë të balancuara. Konkretisht, pritet që ulja më e shpejtë e inflacionit, e cila do të çonte në zbutjen e kushteve financiare globale, tërheqjen më të ngadaltë të mbështetjes fiskale për shtetet, si dhe nxitjen më të fortë të reformave strukturore që do të kontribuojnë në produktivitet më të lartë, janë rreziqe në rritje që do të nxisnin një rritje më të fortë globale. Nga ana tjetër, rreziku më i madh i rënies vazhdon të jetë konflikti në Lindjen e Mesme, i cili rriti rreziqet gjeopolitike dhe shtoi pasigurinë në lidhje me çmimet e produkteve parësore në tregun ndërkombëtar, me ndikime të mundshme negative në rritjen ekonomike globale dhe në inflacionin. *Rreziqet e mjedisit vendor në afat të shkurtër* lidhen me ndikimin e ciklit politik në ekonomi në vitin 2024, ndërsa si rreziqe pozitive në afat të mesëm rivlerësohen efektet e anëtarësimit në NATO, të përparimit në bisedimet e anëtarësimit në BE, të cilat mund të përshpejtojnë reformat strukturore, si dhe nga shfrytëzimi i mundshëm i përparësive gjeografike të ekonomisë sonë në kuadër të procesit të nisur të rregullimit të zinxhirëve globalë.

Në sferën fiskale, në periudhën afatmesme pritet një konsolidim gradual buxhetor. Deficiti buxhetor do të financohej nga një kombinim i burimeve të brendshme dhe të jashtme. Politika e përcaktuar fiskale shoqërohet me rreziqe që, ashtu si politika monetare, rrjedhin nga ndikimi i zhvillimeve gjeopolitike në aktivitetin ekonomik botëror dhe të çmimet botërore, si dhe nga ndryshimet në kushtet financiare dhe gjendjen e tregjeve financiare ndërkombëtare.

Banka Popullore monitoron me kujdes të dhënat makroekonomike dhe rreziqet e mundshme nga mjedisi vendas dhe i jashtëm dhe është e gatshme të përdorë të gjitha instrumentet e nevojshme dhe të marrë masa që do të kontribuojnë në ruajtjen e stabilitetit të kursit valutor, stabilizimin e pritshmërive inflacioniste dhe stabilitetin e çmimeve në afat të mesëm.

V. Instrumentet monetare



Në vitin 2023, gjatë zbatimit të politikës monetare, Banka Popullore u mbështet në instrumentet monetare për tërheqjen e mjeteve të tepërta likuide nga sistemi bankar dhe ndërmori masa që mundësojnë ruajtjen e stabilitetit të kursit valutor dhe rritjen e mëtejme të kursimeve në denarë. Në të njëjtën kohë, karakteristikat dhe struktura e instrumenteve monetare siguruan fleksibilitet në administrimin e likuiditetit dhe mbështetje në parimet e tregut në zbatimin e politikës monetare.

Norma e interesit të instrumentit kryesor të politikës monetare, bonot e thesarit, nga janari deri në shtator 2023 u rrit në gjashtë raste radhazi³⁵ për gjithsej 1,55 p.p. deri në nivelin prej 6,30%³⁶. Ndryshimet në normën referencë të interesit u plotësuan me një rritje të qëndrueshme (për 1,55 p.p.), si në normat e interesit të depozitave njëditore, ashtu edhe në ato shtatëditore, në nivelin 4,20%, përkatësisht 4,25%.


Cikli i shtrëngimit të kushteve monetare përmes rritjes së normave të interesit u mbështet dhe u forcua nga ndryshimet e mëtejshme të instrumentit të rezervës së detyrueshme, me qëllim të veprimit më të përcaktuar në procesin e denarizimit. Kështu, Banka Popullore e rriti raportin e rezervës së detyrueshme për detyrimet në valutë nga 18% në dhjetor 2022, në 21% deri në fund të vitit, si dhe e rriti normën për detyrimet në denarë me klauzolë valutore nga 50% në 100%. Për detyrimet në denarë të bankave vazhdonte të zbatoheshin norma e rezervës së detyrueshme prej 5%³⁷. Për të forcuar efektin e ndarjes së normave nga këndvështrimi valutor, Banka Popullore rriti edhe pjesën e rezervës së detyrueshme në valutë të huaj që bankat plotësojnë në euro, nga 75% në 81%. Me këto ndryshime, Banka Popullore synoi të forcojë ndryshimet e nisura në politikën e interesit të bankave dhe të inkurajojë një rritje më të fortë të kursimeve në valutën vendase.

³⁵ Nga prilli 2022 deri në shtator 2023, norma kryesore e interesit u rrit katërmëdhjetë herë me një total prej 5,05 p.p. Në tremujorin e fundit të vitit 2023, në përputhje me kushtet në ekonominë vendase dhe duke marrë parasysh rreziqet që vijnë nga faktorë të jashtëm dhe të caktuar të brendshëm, Banka Popullore mbajti të njëjtat norma interesi.

³⁶ Rrjedhimisht, norma më të larta interesi u zbatuan për ankandet repo për krijimin e likuiditetit dhe për kreditë e disponueshme njëditore, norma e interesit të cilave është e barabartë, pra më e lartë për 0,5 p.p. krahasuar në mënyrë përkatëse me normën e interesit të bonove të thesarit.


³⁷ Në vitin 2022, në kushtet e rritjes së pasigurisë për shkak të konfliktit ushtarak në Ukrainë dhe prirjes më të madhe për të kursyer në valutë, norma e rezervës së detyrueshme në denarë u ul nga 8% në 5%, ndërsa norma e rezervës së detyrueshme për detyrimet në valuta u rrit nga 15% në 18%.

Grafiku 54
Korridori i normave të interesit




*D7D; DNj – depozitat njëditore; KNj – kredi njëditore

Grafiku 55
Rrjedha e likuiditetit nga faktorë autonomë




* FTA – Faktorë të tjerë autonomë

Grafiku 56
Bonot e thesarit dhe teprica e mjeteve likuide të bankave³⁸



Burimi: BPRMV.

Grafiku 57
Gjendja e instrumenteve monetare



Në tregun valutor, lëvizjet ishin më të favorshme, krahasuar me vitet e mëparshme, duke pasqyruar nevojën e reduktuar për fonde valutore nga kompanitë, me një rritje të vazhdueshme të njëkohshme të ofertës neto për valutë nga personat fizikë dhe këmbimoret në tregun e këmbimit dhe të valutave. Në rrethana të këtilla dhe në kushtet e likuiditetit valutor përgjithësisht të mirë dhe relativisht të lartë të bankave³⁹, në vitin 2023, Banka Kombëtare ndërhyri me një blerje neto relativisht të lartë (311,8 milionë euro) të mjeteve në valutë⁴⁰ nga sistemi bankar, i cili mundësoi krijimin e likuiditetit në denarë në vlerë prej rreth 19,1 miliardë denarë. Paraja e gatshme në qarkullim kishte rritje të vazhdueshme dhe ndoqi kryesisht dinamikën e viteve të parakrizës (duke arritur rritje vjetore prej rreth 3,4 miliardë denarë ose 6,2%). Ndërsa depozitat e shtetit në Bankën Popullore u rritën në baza vjetore (për rreth 3 miliardë denarë), për çka kontributin më të madh e kishte rritja e huamarrjes në tregun vendas të letrave me vlerë të shtetit. Kjo dinamikë e flukseve autonome kontribuoi në

³⁸ Teprica e mjeteve likuide të bankave i referohet ditës së parë të periudhës së rezervës së detyrueshme kur mbahet ankand i bonove të thesarit dhe paraqet shumën totale të mjeteve në llogaritë e rregullta të bankave në Bankën Popullore, shumën e detyrueshme të bonove të thesarit dhe depozitat e disponueshme në BPRMV dhe të kërkesave të tregut të parasë, të reduktuara nga detyrimet e tregut të parasë dhe shumën e rezervës së detyrueshme për periudhën në vijim.

³⁹ Duke pasur parasysh likuiditetin e përshtatshëm të mjeteve valutore të bankave dhe nivelin më të lartë historik të rezervave valutore, Banka Popullore nuk përdori mjete nga linja e repove me BQE-në në vitin 2023, e cila siguron qasje në likuiditet në valutë në shumën totale prej 400 milionë euro. Linja e repove u krijua në gusht të vitit 2020, por duke pasur parasysh mjedisin e pasigurt ekonomik dhe pasigurinë gjeopolitike të shtuar, BQE-ja zgjati mundësinë e përdorimit të linjës së repove në katër raste, deri në janar 2025.

⁴⁰ Menaxhimi i likuiditetit valutor të bankave përfshiu edhe mundësinë e vendosjes së plasmaneve pa rrezik në euro pranë Bankës Popullore me afat maturimi 1 dhe 3 muaj, e cila u aktivizua si instrument në gusht të vitit 2020, por duke pasur parasysh nivelin relativisht të ulët të bankave, ankandet e depozitave në valuta u çaktivizuan në maj 2023.

rritjen vjetore më të theksuar të mjeteve në denarë të bankave, në bazë neto për 14,4 miliardë denarë, kështu që likuiditeti në sistemin bankar në fund të vitit e tejkaloi nivelin e vitit 2019⁴¹.

Në periudhën e analizuar, Banka Popullore menaxhoi edhe likuiditetin në sistem nëpërmjet zbatimit të instrumenteve monetare që thithin para të tepërta të lira nga sistemi bankar^{42,43}. Banka Popullore gjatë gjithë vitit ka mbajtur shumën e bonove të thesarit në nivelin prej 10 miliardë denarësh⁴⁴, kurse teprica e mjeteve në denarë u drejtuan kryesisht në depozitat në dispozicion, të cilat mundësojnë fleksibilitet në menaxhimin e ndryshimeve afatshkurtra të likuiditetit dhe disponueshmëri të lartë të mjeteve. Shfrytëzimi i depozitave në dispozicion në Bankën Popullore ishte në përputhje me rritjen e tepricës së mjeteve në denarë në sistemin bankar, prandaj në fund të vitit shuma më e madhe e parave ishte vendosur në këtë instrument, mesatarisht rreth 53 miliardë denarë. Nga pikëpamja e maturimit, në vitin 2023, gjatë administrimit operacional të likuiditetit, bankat përdorën shumë fort depozitat shtatëditore.

Rritjen më të lartë vjetore e ka pasur detyrimi i bankave për ndarjen e rezervave të detyrueshme (8,4 miliardë denarë), që më së shumti është pasqyrim i ndryshimeve në sistemin e rezervës së detyrueshme, ndërsa kontributi i ndryshimeve në detyrimet në denarë dhe valutë të bankave⁴⁵ ishte relativisht më mesatar. Në të njëjtën kohë, rezerva e detyrueshme që bankat e plotësojnë në euro shënoi rritje relativisht të lartë prej 8,9 miliardë denarë (duke arritur në 39,1 miliardë denarë), për të cilën kontributin më të madh (rreth 94%) e ka zbatimi i shkallëve më të larta të detyrimeve në valuta dhe rritja e pjesës së rezervës së detyrueshme në valuta që plotësohet në euro. Në anën tjetër, rezerva e detyrueshme në denarë në baza vjetore shënoi rënie prej 515 milionë denarë (në nivel prej 22,1 miliardë denarë), me kontributin më të madh në rënie nga ndryshimet në sistemin e rezervës së detyrueshme në vlerë prej 1,3 miliardë denarë. Rritja solide e depozitave në denarë kishte efekt të kundërt, duke kontribuar në rritjen e detyrimeve për 755 milionë denarë, ndërsa efekti neto nga zbatimi i masave jostandarde në rezervën e detyrueshme ishte neutral.

⁴¹ Në vitin 2019, likuiditeti i bankave në denarë arriti nivelin më të lartë, për të cilin kontribuan edhe intervenimet e Bankës Popullore për blerjen e tepricës së valutave.

⁴² Seti i instrumenteve monetare të Bankës Popullore përfshinte mundësinë që bankat të përdorin mjete likuide nga banka qendrore në baza të rregullta përmes kredive në dispozicion njëditore dhe ankandeve të repove për të krijuar likuiditet në sistemin bankar. Megjithatë, për shkak të pozicionit të lartë të likuiditetit, në vitin 2023 bankat nuk kishin interes për këto instrumente monetare.


⁴³ Nga fundi i vitit 2022, të gjitha institucionet financiare që mbledhin depozitat kanë qasje në instrumente monetare për tërheqjen e likuiditetit dhe, për rrjedhojë, kanë detyrimin për të përmbushur një rezervë të detyrueshme. Pra, kursimoret, përveç bankave, kanë të drejtën e qasjes në ankandet e bonove të thesarit dhe të drejtën e plasimit të mjeteve në depozitat në dispozicion në Bankën Popullore.

⁴⁴ Në ankandet e bonove të thesarit, të cilat mbahen në ditën e parë të periudhave të rezervës së detyrueshme, zbatohet një tender me shuma (shuma e kufizuar e ofertës dhe norma fikse interesi), ndërsa maturimi i bonove të thesarit përcaktohet në përputhje me kohëzgjatjen e periudhave të rezervës së detyrueshme. Duke pasur parasysh se në fillim të vitit vendimmarrja për pozicionimin e politikës monetare u përafhua me dinamikën vendimmarrëse të BQE-së, u ndryshua edhe kalendari/gjatësia e periudhave të mbajtjes së rezervës së detyrueshme, e cila për rrjedhojë kontribui në ndryshimin e maturimit të bonove të thesarit të ofruara nga 28/35 ditë në 42/49 ditë. Në shumicën e ankandeve, bankat dhe kursimoret kanë pasur kërkesë në nivelin e shumës së ofruar.

⁴⁵ Më shumë hollësi rreth ndryshimeve në bazën e depozitave të bankave në rubrikën Agregatët Monetarë.

Grafiku 58


Ndryshimi në rezervën e detyrueshme të bankave



Burimi: BPRMV.

Grafiku 59

Normat e rezervës së detyrueshme



Periudha e dhjetorit të plotësimit të rezervës së detyrueshme në vitin 2022 ishte periudha e fundit kur u zbatua masa jostandarde për nxitjen e aktivitetit kreditues të ndërmarrjeve nga aktivitetet që u prekën më shumë nga kriza shëndetësore. Si rezultat, në janar 2023, rezerva e detyrueshme në denarë u rrit për 200 milionë denarë. Në vitin 2023, Banka Popullore vazhdoi me zbatimin e masës jostandarde (e aktivizuar në tetor të vitit 2022) e cila mundëson lehtësimin e kushteve të kreditimit për prodhimin vendor të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme. Zbatimi i kësaj mase në vitin 2023 mundësoi zvogëlimin për rreth 219 milionë denarë të detyrimit të bankave për të ndarë rezervë të detyrueshme në denarë në Bankën Popullore⁴⁶. Masa synon të inkurajojë ndryshimet strukturore në ekonominë vendase dhe të mbështesë financimin e qëndrueshëm të sektorit privat. Me masën mundësohet zvogëlimi i bazës për detyrimin e bankave për rezervë të detyrueshme në denarë, për shumën e kredive të reja të miratuara për financimin e projekteve të prodhimit vendor të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme. Aktiviteti kreditues i bankave për kompanitë për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme në vitin 2023 ishte solid dhe kontribuoi në rritjen e gjendjes së raportuar të këtyre kredive për rreth 4,4 miliardë denarë. Pjesa më e madhe e kredive të miratuara të raportuara në vitin 2023 (rreth 96%) janë afatgjata dhe janë të paracaktuara për ndërtimin e kapaciteteve të reja të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, dhe pjesa tjetër për rritjen e fuqisë së instaluar të kapaciteteve ekzistuese.


Shtojca 1. Lëvizjet e tregut valutor⁴⁷ dhe investimet e Bankës Popullore

Në vitin 2023, lëvizjet e tregut valutor në transaksionet e klientëve ishin dukshëm më të favorshme se në tre vitet e fundit, mes një stabilizimi gradual të goditjeve të ofertës globale dhe rritjes së besimit në valutën vendase. Konkretisht, ulja e trysnive të çmimeve nga burimet e energjisë dhe normalizimi gradual i fluksit të mallrave çoi në një prirje në rënie të çmimeve të produkteve primare në tregjet botërore, e cila u pasqyrua në uljen e çmimeve të importit të mallrave. Këto ndryshime ndikuan pozitivisht në këmbimin tregtar të jashtëm të ekonomisë vendase, nëpërmjet uljes së kërkesës për valutë nga sektori i energjisë elektrike dhe i rritjes së ofertës së likuiditetit valutor nga kompanitë vendase.


⁴⁶ Shuma e përgjithshme e mjeteve të liruara nga fillimi i zbatimit të masës është 259 milionë denarë.

⁴⁷ Tregu valutor në kuadër të kësaj analize përfshin transaksionet ndërmjet bankave dhe klientëve të tyre dhe tregtimin ndërbankar.


Grafiku 60
Shitjet neto të valutave të huaj në banka për klientët e tyre




Grafiku 61
Ndryshimi vjetor i ofertës dhe i kërkesës për valuta, sipas klientëve



Grafiku 62
Kërkesa për valuta nga kompanitë në tregun valutor, sipas tremujorëve



Grafiku 63
Oferta e valutave nga kompanitë në tregun valutor, sipas tremujorëve




Burimi: BPRMV.

Kompanitë e prodhimit dhe të tregtimit të naftës dhe të energjisë elektrike kishin nevojë dukshëm më të ulët për likuiditet valutor (për 32% ose 653 milionë euro në vit) krahasuar me vitin pararendës. Kërkesë më të lartë shënuan kompanitë e sektorit të ndërtimit dhe më mesatare, kompanitë e tregtisë dhe të prodhimit të ushqimeve, pijeve dhe duhanit dhe të tregtisë me shumicë, të cilat kontribuan në nivelin ende më të lartë të çmimeve. Nga ana tjetër, normalizimi i tregjeve të shkëmbimit të mallrave dhe shërbimeve kontribuoi në një rritje më të ndjeshme të ofertës së valutave nga kompanitë e orientuara drejt eksportit që operojnë në zonat industriale, veçanërisht nga kompanitë e industrisë së automobilave, të cilat kanë kontributin më të madh (rreth 70 p.p.) në rritjen vjetore të ofertës së mjeteve valutore nga sektori i korporatave, të ndjekura nga kompanitë e sektorit të informatikës dhe kompanitë e ndërtimit. Me një rritje vjetore më të lartë të ofertës, shitja neto e valutës së bankave për nevojat e sektorit të korporatave ishte më e ulët për 445 milionë euro në bazë vjetore.

Në ecurinë më të mirë vjetore të bankave në segmentin e klientëve kontribuoi edhe oferta më e lartë e vazhdueshme e mjeteve valutore nga personat fizikë në tregun valutor dhe të këmbimit, me rreth 30 p.p., që është një sinjal i stabilizimit gradual të pritshmërive inflacioniste dhe të rritjes së besimit në valutën vendase. Në fakt, këto subjekte gjatë gjithë vitit kishin një ofertë neto mbi mesataren e mjeteve të huaja të pagesës, që çon në blerjen neto vjetore më të lartë historike, e cila ishte edhe dy herë më e lartë se oferta mesatare neto e këtyre subjekteve në vitet 2018 - 2019. Në tregun valutor, oferta e mjeteve të huaja efektive të pagesës nga personat fizikë mbeti në nivele relativisht të larta dhe të qëndrueshme krahasuar me vitin 2022 dhe kontribuoi në rritjen e mëtejshme (me rreth 70 milionë euro, në bazë vjetore) të tepicës së valutave të huaja të cilat këmbimoret ua ofrojnë bankave vendase.

Grafiku 64


Blerja e valutës nga bankat nga këmbimoret, sipas tremujorëve



Burimi: BPRMV.

Grafiku 65


Oferta/kërkesa neto e valutave nga personat fizikë në tregun valutor, sipas tremujorëve



Shitjet neto të valutave të bankave për nevojat e klientëve në vitin 2023 (97,2 milionë euro) janë më të ulëta për 744 milionë euro në bazë vjetore dhe janë në nivelin e shitjeve neto në vitin 2018 dhe 2019. Për shkak të prirjeve dukshëm më të mira të bilancit të pagesave dhe likuiditetit të përgjithshëm të lartë valutor të bankave, Banka Popullore në tregun valutor, për herë të parë pas krizës shëndetësore, synon blerjen neto të valutave në vlerë prej 311,8 milionë euro, që është vetëm një shumë mesatarisht më e vogël se blerjet neto të realizuara më 2018 dhe 2019. Duke pasur parasysh kërkesën më të lartë për valuta nga sektori i korporatave në fillim të vitit, Banka Popullore ndërhyri në të dyja drejtimet në gjashtëmujorin e parë, me një shitje neto prej 116 milionë euro. Lëvizjet e favorshme të tregut dhe likuiditetit i lartë valutor i bankave në gjysmën e dytë të vitit çuan në një ofertë të vazhdueshme më të lartë të valutave në tregun ndërbankar të tregut valutor dhe në ndërhyrjet e Bankës Popullore nëpërmjet blerjes së tepricës së mjeteve valutore, në një shumë relativisht të lartë prej 427,8 milionë euro. Kështu, ndërhyrjet e Bankës Popullore në tregun valutor kontribuan në rritjen shtesë të nivelit tashmë solid dhe të përshtatshëm të rezervave valutore, dhe kursi i denarit në raport me euron mbeti në nivel stabil.

Grafiku 66


Ndërhyrjet e BPRMV-së në tregun valutor



Burimi: BPRMV.

Grafiku 67

Kursi i mesëm i denarit ndaj euros




Shtojca 2. Lëvizjet në tregun ndërbankar të depozitave pa kolateral dhe në tregun sekondar të letrave me vlerë⁴⁸

Duke pasur parasysh sasinë e lartë të mjeteve të lira në denarë, në vitin 2023 bankat kishin nevojë shumë të vogël dhe të rrallë për huamarrje në tregjet vendore financiare.

⁴⁸ Analiza e tregut të parasë në Maqedoninë e Veriut u referohet këtyre segmenteve: tregu i depozitave pa kolateral, tregu sekondar i letrave me vlerë afatshkurtra dhe letrave me vlerë afatgjatë të shtetit (me përjashtim të obligacioneve strukturore), tregu i depozitave të siguruar (tregu i repove).

Grafiku 68


Qarkullim në tregun ndërbankar të depozitave pa kolateral



Burimi: BPRMV.

Grafiku 69

Teprica likuide në sistemin bankar dhe huamarrja e bankave




Nevojat e rastësishme, afatshkurtra për likuiditet, më së shumti u kompensuan nga bankat në tregun ndërbankar të depozitave të pasiguruara, ku qarkullimi ishte më i ulët për 94% në bazë vjetore dhe ishte vetëm 2,4 miliardë denarë, që është vëllimi më i ulët vjetor i tregtimit në këtë segment tregu. Nevoja e dobët për huamarrje u pasqyrua edhe në borxhin mesatar ditor të bankave (97 milionë denarë), i cili ishte dukshëm më i ulët në krahasim me vitin 2022. Sa i përket strukturës së maturimit të depozitave pa kolateral të tregtuara, bankat siguruan pjesën më të madhe (rreth 69%) të mjeteve të nevojshme me afat maturimi deri në një javë, ndërsa përfaqësimi i kredive me maturim njëditor është relativisht më i ulët, pra rreth 28%. Përveç këtyre dy maturimeve, u kryen edhe dy transaksione me depozita pa kolateral me afat maturimi deri në një muaj, pjesëmarrja e të cilave në vëllimin e përgjithshëm të tregtimit është relativisht e qëndrueshme dhe e ulët (3%).

Normat e realizuara të interesit në tregun pa kolateral të depozitave ndërbankare në vitin 2023 ndoqën ciklin e normave të interesit të politikës monetare. Norma mesatare e interesit ndërbankar e të gjitha transaksioneve (MBKS) në fund të vitit ishte 4,30% dhe ishte më e lartë për 1,76 p.p. në krahasim me nivelin e dhjetorit të vitit 2022. Në një nivel më të lartë, për 1,75 p.p. në bazë vjetore, ishte norma e interesit të kredive pa kolateral ndërbankar, më të tregtuara, me afat maturimi prej një javë, e cila arriti në 4,30% në fund të vitit, dhe norma e interesit të depozitave pa kolateral, me maturim njëditor në fund të dhjetorit ishte 4,20% (më e lartë për 2 p.p. në vit). Për shkak të nevojës së herëpashershme për të tregtuar me depozita njëditore pa kolateral dhe të prirjes së shtuar për të tregtuar me afat maturimi prej një javë, në vitin 2023 u kryen një numër i vogël transaksionesh (rreth 17% e shumës totale të tregtuar), të cilat përdoren për llogaritjen e normës së interesit MKDONIA, niveli mesatar i së cilës ishte 3,81%.

Prirje në rënie ka edhe vëllimi i letrave me vlerë të tregtuara në tregun sekondar të letrave me vlerë në sportel, të organizuar nga Banka Popullore, ku qarkullimi i përgjithshëm në vitin 2023 ishte vetëm 445 milionë denarë. Sa u përket llojeve të transaksioneve, tregtia e reduktuar vjen si pasojë e aktivitetit më të dobët të segmentit të tregut të repove ndërbankare, ku duke pasur parasysh tepricën e likuide, në vitin 2023 u realizuan vetëm dy transaksione me bono thesari në vlerë prej 210 milionë denarë. Vëllim i zvogëluar dhe pothuajse i njëjtë i tregtimit u vërejt edhe në transaksionet përfundimtare, ku janë tregtuar vetëm letrat me vlerë të shtetit, në vlerë prej 235 milionë denarë. Në totalin e letrave me vlerë të tregtuara të shtetit, mbizotëron tregtia ndërmjet bankave (me 85%).

Grafiku 70


Qarkullimi në tregun sekondar të letrave me vlerë



Burimi: BPRMV.

Grafiku 71

Struktura e transaksioneve përfundimtare me letrat me vlerë të shtetit⁴⁹



⁴⁹ Koeficienti i likuiditetit të LVSh-ve është një raport ndërmjet qarkullimit të realizuar nga transaksionet me LVSh në tregun sekondar gjatë vitit dhe gjendjes mesatare të LVSh-ve të emetuara në të njëjtën periudhë.

VI. Menaxhimi dhe investimi i rezervave valutore

Rritje e lartë vjetore e rezervave valutore

Siguri dhe likuiditet të rezervave valutore

Menxhim aktiv i rezervave valutore

Në vitin 2023, rezervat valutore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: rezervat valutore) shënuan rritje të ndjeshme, që më së shumti vjen si pasojë e ndërhyrjeve të Bankës Popullore në tregun valutor për blerjen e tepricës së valutave për të ruajtur një nivel të qëndrueshëm të vlerës së kursit nominal të denarit në raport me euron. Gjatë vitit, në kushtet e pasigurisë së lartë për dinamikën e ardhshme të normave të interesit të ekonomive kryesore, një pjesë e madhe e mjeteve u ruajtën në formën më likuide brenda portofolit operacional të rezervave valutore, ndërkohë që pjesa më e madhe e investimeve të reja u drejtuan në obligacionet e sigurta shtetërore të Eurozonës. Ndryshueshmëria e normave të kthimit në tregjet financiare është përdorur për menaxhimin aktiv të rezervave valutore, për të pasur realizime të favorshme nga investimet në instrumente borxhi nga portofoli i investimeve. Si pasojë, menaxhimi i rezervave valutore në vitin 2023 u dallua me kujdes të jashtëzakonshëm dhe përshtatje të vendimeve për investime me zhvillimet në ndryshim të tregut vendas valutor dhe të tregjeve financiare ndërkombëtare, të cilat mundësonin realizimin e mëtejshëm të parimeve bazë: siguri dhe likuiditet të rezervave valutore.

6.1. Gjendja dhe ndryshimet e rezervave valutore


Në vitin 2023 rezervat valutore u rritën për 675,6 milionë euro dhe në fund të vitit arritën në 4.538 milionë euro. Në kushtet e prirjeve dukshëm më të mira të tregut dhe përgjithësisht të lartë të likuiditetit valutor të bankave, Banka Popullore për herë të parë pas krizës shëndetësore u orientua drejt blerjes neto të valutave në tregun valutor në një sasi relativisht të lartë (311,8 milionë euro), të cilat kontribuan në rritjen e ndjeshme të rezervave valutore, të cilat sigurisht ishin në nivele të larta dhe të përshtatshme. Rritja e rezervave valutore erdhi kryesisht nga rritja e rezervës së detyrueshme të ndarë në euro dhe mjeteve të bankave vendase në llogaritë MIPS-EUR (238,3 milionë euro), të ardhurat nga investimet (88,9 milionë euro), si dhe nga flukset hyrëse nga transaksione repo klasike të lidhura (72,2 milionë euro), të cilat përdoren gjatë administrimit aktiv të rezervave valutore⁵⁰. Rritja e vlerës së arit kishte një kontribut përkatës në ndryshimin e rezervave valutore⁵¹ çmimi i të cilit shënoi rritje në tremujorin e fundit të vitit, në kushtet e prirjes së investuesve për të investuar në instrumente të sigurta, mes shqetësimeve të shtuara për shkak të veprimeve ushtarake në Izrael. Në drejtim të kundërt vepruan flukset dalëse neto të shtetit nga transaksionet me

⁵⁰ Krahas huamarrjes së rregullt të letrave me vlerë nëpërmjet transaksioneve klasike dhe të anasjelltë të repove në të njëjtën shumë, gjatë vitit u realizuan edhe transaksione të tjera klasike të repove, të nxitura nga kërkesa e lartë globale për letra me vlerë të cilësisë së lartë që janë pjesë e rezervave valutore. Për rrjedhojë, këto transaksione kontribuan në rritjen e mjeteve monetare në rezervat valutore.

⁵¹ Çmimi i arit i shprehur në dollarë amerikanë u rrit për 13,8%, krahasuar me fundin e vitit 2022, pavarësisht zhvlerësimit të dollarit amerikan ndaj euros për 3%, i cili kontriboi në rritjen e vlerës së arit në rezervat valutore për rreth 10% dhe dallimin pozitiv të rreziqeve të çmimit dhe të këmbimit prej rreth 27,8 milionë euro.


jashtë (53,5 milionë euro), si dhe depozitat e maturuara në valuta të bankave⁵² (rënie prej 14 milionë euro).

Grafiku 72
Faktorët e ndryshimit të rezervave valutore
në miliona euro



Burimi: BPRMV.

Grafiku 73
Portofoli i rezervave valutore
niveli mesatar, në miliona euro



Edhe në vitin 2023, rezervat valutore u shpërndanë në tre portofol (portofoli operativ, likuiditeti dhe investimi), vëllimi i të cilave u rregullua në mënyrë aktive në përputhje me nevojat afatshkurtra për mjete likuide të tregut vendas valutor dhe shlyerjet e ardhshme të borxhit të jashtëm publik. Flukset hyrëse në rezervat valutore u mbajtën më së shumti brenda portofolit operativ, i cili u ruajt në një nivel më të lartë për shkak të mundësisë së realizimit të të hyrave të favorshme nga interesat nga plasmanet në llogaritë e depozitave pranë bankave qendrore, duke u mbrojtur njëkohësisht nga rreziku i interesit dhe ai kreditor. Në të njëjtën kohë, teprica e mjeteve që tejkaluan kufirin bazë⁵³ për mbajtjen e mjeteve në llogaritë rrjedhëse pranë bankave qendrore, në varësi të kushteve të tregut, vendoset në depozitat afatshkurtra pranë bankave afariste me klasifikim të lartë kredie, me norma interesi të krahasueshme me normën e depozitave të BQE-së. Në strukturën e rezervave valutore, nëpërmjet një portofoli të veçantë administrohej më tej edhe ari, siguria dhe likuiditeti i të cilit është veçanërisht i theksuar në kushtet e ndryshimit të lëvizjeve në tregjet financiare.

6.2. Kushtet e tregjeve financiare ndërkombëtare dhe qasja aktive për investimin e rezervave valutore


Në vitin 2023, ekonomia globale u përball me disa sfida, duke përfshirë pasojat e shtrëngimit të politikave monetare nga bankat qendrore të ekonomive kryesore, shqetësimet e përkohshme për stabilitetin e sistemeve bankare në SHBA dhe Europë, veprimet e mëtejshme ushtarake në Ukrainë, dhe më vonë tendosjet në Lindjen e Mesme. Por, performanca ekonomike në mbarë botën ishte relativisht më e favorshme se sa pritej në fillim të vitit, me rritjen ekonomike të moderuar, por të qëndrueshme në mes të rimëkëmbjes globale nga pandemia Covid-19, konsumit të fortë personal dhe performancës së favorshme të sektorit të shërbimeve, shpenzimeve të qëndrueshme publike, si dhe tejkalimit të sfidave

⁵² Ankandet e depozitave në valutë për hedhjen e plasmaneve pa rrezik në euro pranë Bankës Popullore, si instrument për menaxhimin e likuiditetit valutor të bankave, u aktivizuan në gusht të vitit 2020, ndërsa u çaktivizuan në maj të vitit 2023.

⁵³ Kufiri bazë në bankat qendrore (Anglisht Tier 1) përcaktohet nga çdo palë kontraktuese individualisht dhe mjetet e mbajtura deri në kufirin e specifikuar marrin një normë interesi të barabartë me normën e depozitave të BQE-së. Për tepricën e mjeteve mbi këtë kufi, bankat qendrore paguajnë një normë interesi të barabartë me normën e interesit të plasmaneve, pa kolateral, ndërbankare në euro njëditore, të reduktuar për 20 pikë bazë.

në zinxhirët e furnizimit. Përballë normave të tjera më të larta të inflacionit, BQE-ja dhe FED-i vazhduan të rrisin normat bazë të interesit në disa raste në vitin 2023. Gjatë vitit, normat e inflacionit në Eurozonë dhe SHBA u përgjysmuan në krahasim me vitin 2022. Rrethanat e përmendura çuan në lëvizje të ndryshueshme të normave të kthimit të obligacioneve shtetërore në tregjet financiare ndërkombëtare gjatë vitit, ndërkohë që në fund të vitit nuk ka pasur ndryshime të dukshme në bazë vjetore. Në fakt, normat e kthimit të obligacioneve shtetërore me afat më të shkurtër maturimi u rritën, që fillimisht rezultuan nga indikacionet e mbajtësve të politikës monetare për rritjen e mëtejshme të normave të interesit, si dhe në gjysmën e dytë të vitit edhe nga pritshmëritë që bankat kryesore qendrore të ruajnë normat e larta të interesit për një periudhë më të gjatë kohore. Nga ana tjetër, normat e kthimit të obligacioneve shtetërore me afat më të gjatë ishin mesatarisht më të ulëta, kryesisht për shkak të rritjes së theksuar të rreziqeve të rënies ndaj rritjes ekonomike të eurozonës dhe kërkesës më të fortë për instrumente të sigurta, si dhe përparimit të befasishëm në lehtësimin e trysnive inflacioniste.

Grafiku 74
Struktura valutore⁵⁴ dhe ekspozimi i rezervave valutore (mesatarja në vit)



Burimi: BPRMV.

Normat relativisht të larta të interesit dhe normat e kthimit të instrumenteve brenda rezervave valutore ndikuan në vendimet e investimeve gjatë vitit. Në të njëjtën kohë, u shfrytëzua mundësia për realizimin e të hyrave të favorshme nga interesat nga plasmanet në llogaritë e depozitave pranë bankave qendrore, të cilat gjatë vitit u ruajtën në nivelin relativisht të lartë. Luhatshmëria e normave të kthimit të tregut të huaj dhe pasiguria në lidhje me lëvizjet e ardhshme të normave të interesit vazhduan të kufizojnë mundësitë për investime afatgjata. Në kushte të këtilla, u mbajt një qasje më e kujdesshme ndaj investimeve dhe u mor rreziku më i ulët i normave të interesit duke ulur kohëzgjatjet e rregulluara të portofolit të tregtimit të euros. Me këtë qasje investimi, sigurohet mbrojtja e portofoleve nga rritja e mundshme e normave të kthimit, potenciali më i madh i likuiditetit, si dhe mundësia e investimit sipas normave të kthimit më të larta në të ardhmen. Nga ana tjetër, lëvizjet e ndryshueshme të normave të kthimit mundësuan tregtimin aktiv dhe realizimin e të hyrave shtesë nëpërmjet blerjes dhe shitjes së letrave me vlerë. Të hyrat shtesë u arritën edhe nga transaksionet e huamarrjes afatshkurtër të obligacioneve në tregun e transaksioneve repo, duke plasuar njëkohësisht mjetet e fituara në instrumente afatshkurtra me normë kthimi më të lartë në tregun e parasë, duke huazuar letra me vlerë mbi baza të sigurta dhe duke përfunduar transaksionet repo të anasjellta si dhe transaksionet e para (swap) të arit.

6.3. Struktura e rezervave valutore

Gjatë vitit 2023, **në strukturën valutore** të rezervave valutore vazhduan të ishin më të përfaqësuara mjetet e investuara në instrumente financiare të shprehura në euro, me një


⁵⁴ Struktura bazë valutore e rezervave valutore është në përputhje me strukturën valutore të ndërhyrjeve në tregun valutor vendas, detyrimet e shtetit jashtë vendit, tregtinë e jashtme dhe nevojat e tjera për likuiditet. Struktura taktike valutore përcaktohet në bazë të një rishikimi periodik të shpërndarjes strategjike të rezervave valutore, brenda shmangieve të lejuara nga struktura bazë valutore.

pjesëmarrje mesatare prej rreth 99%⁵⁵, që është në përputhje me strategjinë monetare për kurs të qëndrueshëm valutor të denarit ndaj euros.

Qasja e kujdesshme dhe aktive për menaxhimin e rezervave valutore, e cila përfshinte shënjestrimin e instrumenteve më të sigurta financiare për të përmbushur parimin e sigurisë së rezervave valutore, kontribuoi në rritjen e pjesëmarrjes mesatare të instrumenteve të emetuara nga emetuesit/vendet me **nota më të larta për klasifikim kreditor** (nga "AAA" në "AA-") në rreth 77%. Këto instrumente kanë një ekspozim të ulët ndaj rrezikut kreditor dhe konsiderohen si investimet më të sigurta. Në të njëjtën kohë, për të arritur një normë kthimi më të lartë nga investimet dhe për të ruajtur vlerën e rezervave valutore, një pjesë e investimeve (ose mesatarisht rreth 12%) janë investuar edhe në instrumente me vlerësim krediti nga "A+" në "A-". Instrumentet me vlerësim kredie nga BBB+ në BBB- përbënin mesatarisht 10% të rezervave valutore dhe përfshinin letrat me vlerë të shtetit dhe mjetet në llogaritë rrjedhëse në bankat qendrore në Eurozonë.

Grafiku 75


Struktura mesatare vjetore e investimeve sipas klasifikimit të kreditor



* Në kategorinë "të tjera" klasifikohen FMN, BIS.
Burimi: BPRMV.

Grafiku 76

Struktura mesatare vjetore gjeografike e investimeve



* IFN-të dhe BZhN-të – Institucionet financiare ndërkombëtare dhe bankat zhvillimore ndërkombëtare.

Kjo shpërndarje u pasqyrua në mënyrë përkatëse edhe mbi **strukturën gjeografike** të plasmaneve të rezervave valutore. Kështu, në vitin 2023 shumica e investimeve ishin në instrumente të emetuara nga ekonomitë kryesore të Eurozonës (mesatarisht 54%)⁵⁶, por edhe në vende të tjera nga Eurozona dhe Bashkimi Europian (18,5%)⁵⁷, të cilat përfitojnë nga mbështetja e ekonomisë së përbashkët duke ofruar norma thimi mesatarisht më të larta.

Nga aspekti i **llojeve të instrumenteve në të cilat janë investuar rezervat valutore**, pjesa më e madhe e mjeteve vazhduan të ishin të investuara në letra me vlerë (64%). Ndër llojet e letrave me vlerë, mbizotëronin letrat me vlerë të shtetit dhe letrat me vlerë të emetuara me garanci shtetërore, të cilat konsiderohen si investimet më të sigurta. Rritja e normave të interesit referencë gjatë vitit rriti atraktivitetin e plasmaneve në depozita pranë bankave qendrore dhe tregtare. Në fakt, plasmanet afatshkurtra në bankat komerciale u përfaqësuan me vëllim më të madh se mesatarja në vitin 2022, dhe mjetet në llogaritë rrjedhëse në bankat qendrore kishin një pjesëmarrje më të madhe (rreth 19,4% mesatarisht).


⁵⁵ Struktura valutore analizohet në raport me gjendjen e rezervave valutore të reduktuara për sasinë e arit.

⁵⁶ Ata u referohen të ashtuquajturave "Bërthama Euro", e cila përfshin: Gjermaninë, Austrinë, Luksemburgun, Finlandën, Holandën, Francën, Irlandën dhe Belgjikën.

⁵⁷ Në "vendet e tjera të Eurozonës dhe BE-së" përfshihen: Italia, Portugalia, Spanja, Danimarka, Letonia, Lituania, Polonia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Kroacia, Bullgaria, Republika Çeke dhe Suedia.

Grafiku 77


Struktura e investimeve sipas instrumenteve - mesatarja në vit



Burimi: BPRMV.

Grafiku 78

Struktura sipas llojit të letrave me vlerë - mesatarja në vit




Në strukturën e rezervave valutore, pjesëmarrja mesatare e **arit** u zvogëlua nga 11,1% në vitin 2022, në 9,9% në vitin 2023, që me një sasi të pandryshuar dhe çmim më të lartë të arit, është tërësisht rezultat i rritjes së rezervave valutore.

6.4. Rezultatet e menaxhimit dhe të investimit të rezervave valutore


Rezultatet e administrimit dhe investimit të rezervave valutore lidhen kryesisht me shpërndarjen e tyre sipas portofoleve, duke marrë parasysh detyrimet dhe qëllimet e ndryshme të rezervave valutore në periudha të ndryshme kohore. Për rrjedhojë, krahas mjeteve të mbajtura në llogaritë rrjedhëse pranë bankave qendrore, rezervat valutore u investuan më së shumti në instrumente me normë kthimi fiks, të cilat mund të tregtohen në kushte të favorshme tregu dhe mundësojnë fitim nga ndryshimet në vlerën e tregut të instrumenteve. Normat pozitive të interesit të depozitave në euro dhe normat e kthimit relativisht të larta në vitin 2023 ndikuan pozitivisht në investimet e reja në instrumente financiare dhe për rrjedhojë, krahas atyre aktuale, kanë efekt të favorshëm edhe në rezultatet e pritura financiare në vitet në vijim. Po ashtu, efekti i normës së kthimit u plotësua nga realizimet e favorshme nga menaxhimi aktiv i portofolit të rezervave valutore, ku **shkalla totale e kthimit nga investimet dhe administrimi i rezervave valutore ishte pozitive dhe ishte 2,28%.**

Grafiku 79
Shkallët e kthimit të rezervave valutore⁵⁸
Në përqindje



Burimi: BPRMV.

Shkallët e kthimit sipas portofoleve më 2023



Diversifikimi i plasmaneve sipas instrumenteve, menaxhimi aktiv i rezervave valutore, d.m.th. investimi në instrumente me kthim më të lartë, zgjedhja e një momenti të përshtatshëm për investim, përshtatja e pozicionit të investimit me kushtet e ndryshuara financiare dhe mënyra e strukturimit të portofolit kontribuan në arritje më të mira dhe në tejkalimin e rezultateve në raport me portofolet përkatëse të referencës⁵⁹.

Analizuar sipas portofoleve, portofoli operativ në euro, i cili përmban kryesisht mjete në llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me afat, ka kontribut pozitiv në të ardhurat nga investimi i rezervave valutore, duke marrë parasysh rritjen e normave të interesit referencë në Eurozonë dhe në ShBA gjatë vitit 2023. Portofoli i investimeve në euro, i cili përfshin pjesën më të madhe të rezervave valutore dhe përfshin instrumente me maturim më të gjatë (pavarësisht instrumenteve më të sigurta, gjithashtu përmban investime në instrumente që ofrojnë prim rreziku kreditor) dhe portofoli i likuiditetit në euro⁶⁰, i cila është me kohëzgjatje më të shkurtër, ka pasur arritje më të larta, krahasuar me arritjet e portofoleve referente përkatëse.

Në fillim të vitit 2023, brenda portofolit të investimeve formohet portofol i veçantë, i cili menaxhohet sipas modelit të biznesit për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe shitjen e aktiveve financiare. Në këtë mënyrë, synimi për të blerë letrat me vlerë pasqyrohet më qartë, dhe në të njëjtën kohë regjistrimin e tyre kontabël si aktive financiare, efektet e të cilave maten me vlerën e drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, mundëson mbrojtjen e rezultatit financiar gjatë rritjes së mëtejshme të rendimenteve, nën ndikimin e pikëpamjeve të forcuara për shtrëngimin e politikës monetare nga autoritetet monetare në Eurozonë. Në të njëjtën kohë, ky portofol ka arritur kthimin më të lartë gjatë vitit (5,03%).

⁵⁸ Norma e kthimit nga rezervat valutore përfshin kthimin nga investimi dhe menaxhimin e rezervave valutore, duke përfshirë ndryshimet e llogaritura të çmimeve të letrave me vlerë, ndryshimet e realizuara të kursit valutor nga arbitrazhet valutore dhe operacionet në ar dhe instrumente derivative.

Qëllimi Strategjik 1 - Përmirësimi i infrastrukturës për udhëheqje të politikës monetare



Gjatë vitit 2023, Banka Popullore ka punuar me përkushtim në realizimin e aktiviteteve për **përmirësimin e infrastrukturës për zhvillimin e politikës monetare**, për të cilën edhe këtë vit duhej mbikëqyrje vigjilente e situatave globale dhe të brendshme dhe vigjilencë në vendimmarrje, duke patur parasysh zhvillimet specifike gjeopolitike dhe reflektimin e tyre në ekonominë globale dhe të brendshme. Në kuadër të këtyre aktiviteteve Banka Popullore e **informon rregullisht publikun për vendimet monetare të marra**.

Gjatë vitit 2023, Banka Popullore ka bërë kontrole të zakonshme në modelet ekzistuese të projeksonit afatshkurtër, me qëllim përmirësimin e tyre, ndërsa ka punuar edhe në ngritjen e modeleve të reja duke përdorur qasje të reja dhe variabla të rinj në procesin e **përgatitjes së projeksioneve makroekonomike**. Gjatë vitit janë kontrolluar rregullisht arritjet e modelit MAKPAM dhe nëse është e nevojshme janë bërë korrigjime të vogla në strukturën e tij dhe nga ky vit është pasuruar përmbajtja e raporteve nga vetë modeli, me analizë më të detajuar të pozicionimit të politikës monetare. U përditësuan rregullisht bazat e të dhënave, përmes të cilave rivlerësohen analizat e rëndësishme në marrjen e vendimeve për politikën monetare (analizat e qëndrueshmërisë së borxhit publik dhe të jashtëm, të kursit real të këmbimit ekuilibër dhe të transmetimit monetar).

Për të perceptuar zhvillimet e fundit në ekonominë e Maqedonisë në tërësi dhe në sektorë të veçantë të ekonomisë vendase, si dhe u përgatitën vlerësimi i ndikimeve të tyre në politikën monetare [raporte të rregullta \(Treguesit më të fundit makroekonomikë, raportet tremujore, si dhe Raportin vjetor për operimin e Bankës Popullore\)](#). Gjithashtu, janë përgatitur më shumë materiale analitike për tema aktuale në fushën e makroekonomisë, si dhe janë publikuar analiza makroekonomike, në formën e [shtojcave analitike](#) dhe shënimeve brenda raporteve të rregullta tremujore.

në baza të rregullta tremujore u realizuan **Anketa për aktivitetin kreditor dhe anketa të pritjeve dhe pritjeve inflacioniste mbi lëvizjen e PBB-së reale**, raportet, prezantimet dhe rezultatet e të cilit janë publikuar në faqen e internetit të Bankës Popullore. Gjithashtu, në dy raste është realizuar anketa e planeve të biznesit të eksportuesve dhe importuesve më të mëdhenj, me qëllim përgatitjen e projeksioneve makroekonomike.



Në procesin e zbatimit të politikës monetare, Banka Popullore realizoi rregullisht operacione monetare, të cilat mundësojnë menaxhim efikas të likuiditetit të sistemit bankar. Përmes ndryshimeve të shumta në rregullore, Banka Popullore thjeshtoi dhe modernizoi sistemin e rezervës së detyrueshme, kryesisht me qëllim të uljes së euroizimit të detyrimeve të bankave. Në të njëjtën kohë, në kuadër të aktiviteteve të zbatimit të politikës monetare, **vazhojnë aktivitetet për përshtatjen e sistemit të rezervës së detyruar me praktikën e BQE-së** për sa i përket shpeshtësisë dhe kohëzgjatjes së periudhave të mbajtjes së rezervës së detyrueshme. Për këtë qëllim, Banka Popullore miratoi kalendar të ri tregues të periudhave të mbajtjes së rezervës së detyrueshme, me të cilat periudhat janë plotësisht në pajtueshmëri me dinamikën e mbajtjes së rezervave të detyrueshme në Eurosistem.

Për nevojën e emetimit të obligacionit civil nga Ministria e Financave, dhe duke pasur parasysh rolin e dhënë ligjërisht të Bankës Popullore si agent fiskal në procesin e emetimit të letrave me vlerë të qeverisë në tregun e brendshëm, Banka Popullore ka pasur

aktivitete të shumta për ndryshime në aktet nënligjore në këtë fushë, si dhe për krijimin e mundësive operacionale për përgatitjen e sistemit elektronik dhe procedurave operacionale për koordinimin ndërmjet institucioneve individuale pjesëmarrëse, duke marrë parasysh masivitetin e pritshëm të kërkesës. Të gjitha aktivitetet e Bankës Popullore kontribuan në mbajtjen me sukses të dy ankandeve në vitin 2023.

Qëllimi Strategjik 2 – Ruajtja dhe forcimi i mëtejshëm i stabilitetit dhe rezistencës së sistemit bankar



Në kushtet e pasigurive të shkaktuara nga zhvillimet gjeopolitike në kornizat globale, Banka Popullore i vlerësoi efektet në sistemin bankar dhe financiar dhe **ndërmori disa veprime për ruajtjen dhe forcimin e mëtejshëm të stabilitetit dhe rezistencës së sistemit bankar.**

Kuadri ligjor i mirë vendosur kontribuon në stabilitetin e përgjithshëm të sistemit bankar dhe në efikasitetin e tij në përmbushjen e objektivave të tij. Për shkak të kësaj, Banka Popullore ka punuar në mënyrë aktive në **zhvillimin e rregulloreve të reja dhe përmirësimin e rregulloreve ekzistuese ligjore.** Gjatë vitit ka vazhduar hartimi i Ligjit të ri të Bankave⁷⁹, miratimi i të cilave lidhet me pajtueshmërinë e mëtejshme me rregulloret e BE-së, por edhe me zbatimin e Ligjit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme⁸⁰ dhe projektligji i ri për sigurimin e depozitave. Gjithashtu, u miratua [Vendimi i ri për metodologjinë e menaxhimit të rrezikut të kredisë](#)⁸¹ dhe [Vendimi i ri për publikimin e raporteve dhe të dhënave nga bankat](#)⁸². Në vitin 2023 ka vazhduar hartimi i rregulloreve të reja për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit si aktivitet afatmesëm. Ata punuan në mënyrë aktive për promovimin dhe aktet e tjera nënligjore që përmirësonin funksionimin dhe standardet në sektorin bankar.



Në mënyrë të rregullt **është realizuar edhe testimi i stresit për të vlerësuar rezistencën e sektorit bankar** të goditjeve, dhe aktualisht po punohet për zbatimin e rekomandimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar për përmirësimin e kornizës së testimit të stresit, duke përfshirë edhe kuadrin të testimit të makro-stresit, për testimin e ndjeshmërisë dhe rritjen e rezistencës së sektorit bankar ndaj goditjeve. Gjithashtu, **në kuadër të zbatimit të aktiviteteve për qëllime të politikës makroprudenciale, Banka Popullore prezantoi disa masa makroprudenciale.** Kështu, rreziqet sistemike janë vlerësuar dhe mbikëqyr rregullisht, si dhe është përcaktuar shuma e shtresës mbrojtëse të kapitalit për bankat me rëndësi sistemike dhe për shtresën mbrojtëse kundërciklike të kapitalit⁸³. Në prill, për herë të parë, u prezantuan masat makroprudenciale për përdoruesit e kredisë për të përmirësuar

⁷⁹ Përpunimi i këtij ligji varet në masë të madhe nga statusi i ndryshimeve të propozuara për direktivën dhe rregulloren europiane për institucionet e kreditit, të cilat ende nuk janë miratuar në BE.

⁸⁰ Ligji i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme u miratua nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut më 3 tetor 2023 dhe do të fillojë të zbatohet nga 13 tetor 2025.

⁸¹ Vendimi është marrë nga Këshilli i Bankës Popullore në shkurt të vitit 2023 dhe bazohet në standardet e prezantuara në BE për identifikimin dhe menaxhimin e ekspozimeve kreditore me probleme dhe të ristrukturuara. Vendimi prezanton metodë të re të përcaktimit të ekspozimeve kreditore me probleme, e cila është plotësisht në pajtim me kërkesat e parashikuara në rregulloret përkatëse europiane dhe udhëzimet e Autoritetit Bankar Europian. Gjithashtu, vendimi përmirëson rregullat për mbikëqyrjen dhe kontrollin e ekspozimeve kreditore me probleme dhe të ristrukturuara, dhe një nga risitë më domethënëse ka të bëjë me aktivitetet që bankat duhet të ndërmarrin me rritjen e sasisë së ekspozimeve kreditore me probleme.

⁸² Vendimi është miratuar nga Këshilli i Bankës Popullore në shkurt të vitit 2023. Ai është në pajtim më tej me dispozitat e Rregulloreve të Bashkimit Europian për kërkesat për kapital të institucioneve të kreditit nr. 575/2013, si dhe me aktet nënligjore të Bankës Popullore, të cilat parashikojnë përgatitjen e disa raporteve që banka është e detyruar t'i publikojë.

⁸³ Në disa raste gjatë vitit 2023, u morën vendime për rritjen e shkallës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit - deri në 1,5% e zbatueshme nga Tr.1 2025.

cilësinë e kërkesës për kredi. Strategjia për zbatimin e politikës makroprudenciale është miratuar nga Komiteti i Stabilitetit Financiar në prill 2023. Mbahen rregullisht mbledhjet e Nënkomitetit për mbikëqyrjen e rreziqeve sistematike dhe marrjen e masave makroprudenciale⁸⁴. **Strategjia fintek për rregullatorët financiarë** u miratua nga Komiteti për të mbështetur zhvillimin e inovacioneve në sistemin financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut (Komisioni për sektorin e fintekut) në prill të vitit 2023. Me miratimin e Strategjisë është pranuar propozimi për formimin e grupeve punuese që do të punojnë në zbatimin e rekomandimeve nga Strategjia. Në nëntor të vitit 2023, përfaqësues nga të gjithë rregullatorët financiarë pjesëmarrës në grupet e punës morën pjesë në punëtori të fintekut të mbajtur në Bankën Popullore, ku u përcaktuan hapat e ardhshëm për zbatimin e rekomandimeve të Strategjisë.

Gjatë vitit 2023 rregullisht **janë kryer aktivitetet mbikëqyrëse në terren**, vendosja e masave korrigjuese ndaj bankave dhe bankave të kursimeve dhe mbikëqyrja e veprimeve të tyre, mbajtja e takimeve të rregullta vjetore me shoqëritë e auditimit të jashtëm, si dhe aktivitetet e licencimit të bankave, kursimoreve, këmbimoreve dhe institucioneve të pagesave. Në gjysmën e dytë të vitit, ka pasur komunikim me ofrues të interesuar ofrues jobankar të shërbimeve të pagesave dhe kanë nisur procedurat për licencimin e institucioneve të para të pagesave, e cila do të përfundonte në gjysmën e parë të vitit 2024. Në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar, është ofruar asistencë teknike për të nxitur përdorimin e testimit të stresit në procesin e vlerësimit të rrezikut mbikëqyrës⁸⁵.



Kontrollet në terren janë kryer rregullisht në pajtim me dinamikën e planifikuar. Është përditësuar edhe baza e të dhënave për gjetjet nga kontrollet në terren të kryera gjatë vitit 2023. Gjithashtu, gjatë vitit janë dorëzuar rregullisht në Drjetorinë e Inteligjencës Financiare raporte individuale lidhur me gjetjet e konstatuara në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për kontrollet e kryera në terren ku objekt i kontrollit ishte vlerësimi i rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Në janar 2024, në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, i cili parashikon raportimin vjetor në UFR, Banka Popullore gjithashtu ka dorëzuar në Drejtori një raport vjetor për të gjeturat e konstatuara në vitin 2023.

⁸⁴ Deri më 31 dhjetor 2023 janë mbajtur gjithsej 6 seanca me detyrim ligjor për mbledhjet tremujore.

⁸⁵ Gjatë qershorit të vitit 2023, është ofruar asistencë teknike nga përfaqësues të FMN-së, me qëllim përcaktimin e mënyrës më të mirë të zbatimit të praktikave botërore për përdorimin e procesit të testimit të stresit në përcaktimin e vlerësimit të përgjithshëm të SREP dhe kërkesës për kapital minimal. Është dorëzuar propozim raport në të cilin jepen rekomandimet kryesore për futjen e këtij procesi. Në pajtim me Propotim-raportin, është planifikuar që asistencë teknike të vazhdojë edhe në vitin 2024 dhe 2025.

Tabela 5

1.1.2023-31.12.2023 ⁸⁶			
Lloji i subjektit	Numri i përgjithshëm i subjekteve	Numri total i kontrolleve në terren	Numri i kontrolleve në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të kombinuara me kontrollet e rrezeqeve të tjera
Banka	13	6	5
Kursimore	2	2	2
Ofruesit e shërbimit të transferimit të parave	4 (së bashku me bankat 8)	4	4
Këmbyes të autorizuar	254 (së bashku me bankat 265)	146	146

Bo Në vitin 2023, Banka Popullore mori pjesë aktive në përgatitjen dhe miratimin e Raportit për Republikën e Maqedonisë së Veriut në kuadër të raundit të pestë të vlerësimit të Këshillit të Europës (Moneyval). Raporti u miratua në seancën e 65të plenare të Komitetit Manival në maj të vitit 2023.



informativ.

Zyra e Mbikëqyrjes së Sistemeve Informative zbatoi kontrollet e planifikuara në terren për menaxhimin e rrezikut të TI-së në pajtim me planin vjetor të miratuar për vitin 2023. Në pajtim me planin, u krye kontroll i menjëhershëm tematik i nivelit të arritur objektiv të gatishmërisë kundër sulmeve nga hapësira digjitale. Me këtë kontroll tematik të një shembulli të përzgjedhur bankash, u kontrollua niveli i gatishmërisë së arritur dhe harmonizimi i bankave me kërkesat përkatëse të Vendimit për Metodologjinë për sigurinë e sistemit

Qëllimi Strategjik 3 – Mbështetja e popullsisë dhe sektorit korporativ nëpërmjet zhvillimit të sistemeve të pagesave të sigurta, inovative dhe efikase⁸⁷



Roli rregullator, por edhe zhvillimor dhe katalitik i Bankës Popullore në fushën e sistemeve të pagesave dhe shërbimeve pagesore shënoi vitin 2023. Për zbatimin efikas të Ligjit të Shërbimeve Pagesore dhe Sistemeve të pagesave, i cili filloi të zbatohet nga fillimi i vitit 2023, komunikim më i shpeshtë me palët e interesuara për të qartësuar zbatimin praktik të akteve nënligjore në kompetencë të Bankës Popullore.

Në pajtueshmëri me kuadrin e ri rregullator, për herë të parë në historinë e shërbimeve pagesore në vendin tonë, Banka Popullore ofroi një mënyrë të shpejtë dhe të thjeshtë në të cilën qytetarët, si përdorues të shërbimeve pagesore, mundën që në një vend në faqen e internetit të Bankës Popullore të **krahasojnë ofertat e ofruesve të shërbimeve pagesore në lidhje me tarifat për shërbimet më të përdorura në lidhje me llogaritë pagesore.** Në këtë mënyrë, Banka Popullore kontribuon në transparencë më të madhe për tarifat për shërbimet pagesore, inkurajimi i konkurrencës ndërmjet ofruesve të shërbimeve pagesore dhe forcimi i mbrojtjes së konsumatorëve nëpërmjet ndërgjegjësimit të tyre më të madh.

⁸⁶ Gjatë vitit 2023 nuk janë kryer kontrolle tematike në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

⁸⁷ Më shumë detaje në Kapitullin VII. Shërbimet pagesore dhe sistemet e pagesave.

Banka Popullore ka vazhduar me pjesëmarrjen aktive edhe në kuadër të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal për **krijimin e tregut të përbashkët rajonal të vendeve të Ballkanit Perëndimor** me mbështetjen e Bankës Botërore. Në bashkëpunim me ekipin e ekspertëve të Bankës Botërore, i cili gjithashtu ka kryer një mision njëjavor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Banka Popullore ka drejtuar ekipin e saj të ekspertëve që të **përgatisë në mënyrë të përshpejtuar të aplikacionit për anëtarësim në Zonën e Vetëm Euopiane të Pagesave (SEPA)**. Gjithashtu, në kuadër të kësaj iniciative, Banka Popullore filloi bashkëpunimin teknik me ekspertë të Bankës Botërore me qëllim përgatitjen e analizave fillestare të mundësive, avantazheve dhe rreziqeve të mundshme të emetimit të monedhës digjitale, **denarit digjital**, si formë digjitale e dekretrit (fiat) në valutë të denarit.

Banka Popullore dhe Banka Qendrore e Holandës, e organizuan për të pesëmbëdhjetën herë [Konferencën e 15-të për pagesat dhe infrastrukturën e tregut](#)⁸⁸, duke vazhduar traditën e gjatë të një kuptimi të përbashkët të mundësive dhe sfidave në shërbimet e pagesave përmes diskutimit të hapur dhe të frytshëm. Banka Popullore organizon funksionimin e sigurt dhe të qetë të operacioneve kritike që lidhen me funksionimin e sistemeve të pagesave në vend, shlyerjen e transaksioneve që lidhen me zbatimin e politikës monetare dhe administrimin e rezervave valutore dhe kryerjen e pagesave me jashtë për autoritetet shtetërore, duke kryer kështu me sukses **rolin operativ** në këtë fushë. Në të njëjtën kohë, Banka Popullore, si operatore dhe pronare e Sistemit Pagesor Ndërbankar të Maqedonisë (MIPS), bëri vetëvlerësimin e parë për harmonizimin e punës së sistemit me kërkesat e parimeve ndërkombëtare, duke konstatuar se ai është në pajtueshmëri.

Nga aspekti i **rolin mbikëqyrës në sistemet e pagesave**, Banka Popullore ka vazhduar me aktivitetet e mbikëqyrjes së menjëhershme të sistemeve të pagesave për të cilat ka filluar mbikëqyrja në vitet e kaluara me qëllim të përgatitjes së raporteve, dhënies së rekomandimeve dhe mbikëqyrjes së zbatimit të rekomandimeve. Nga këto inspektime shihet se operatorët e sistemeve të pagesave e kryejnë punën e tyre pa probleme, duke respektuar standardet për funksionimin e tyre të përcaktuara nga Banka Popullore.

Qëllimi Strategjik 4 – Përmirësimi i politikës investuese dhe sigurimi i kthimit optimal të rezervave valutore në pajtim me parimet e sigurisë dhe likuiditetit⁸⁹



Pasiguria e lartë e tregjeve financiare ndërkombëtare, shkaktuar nga cikli i përshpejtuar i shtrëngimit të politikës monetare të bankave qendrore më me ndikim, imponoi nevojën për **përshtatjen e menaxhimit të portofolit të rezervës valutore me ndryshimin e pritjeve të tregut**. Në këtë kuptim, pozicioni i investimit dhe ekspozimi ndaj rreziqeve të tregut janë rishikuar për këtë qëllim **qasjet më e kujdesshme ndaj investimit duke ofruar potencial më të madh likuiditeti, si dhe më pak interes dhe rrezik kredie**. Gjithashtu janë shfrytëzuar kushtet e ndryshimit të tregut për **tregtimin aktiv të instrumenteve brenda portofolit të rezervave valutore, në vëllim jashtëzakonisht të lartë**, gjatë së cilës u arritën rezultate pozitive. Në të njëjtën kohë, bazuar në përfitimet e vendosura, gjithçka filloi me **zbatimin e modelit të ri të biznesit në menaxhimin e rezervave valutore**, për të cilat janë bërë një sërë **rregullimesh në fushën e matjes së rrezikut, rezultatet e investimit të rezervave valutore dhe raportimi**.

⁸⁸ Në Konferencë morën pjesë përfaqësues nga Banka Qendrore Europiane dhe bankat qendrore të vendeve të Bashkimit Europian, bankat qendrore të vendeve të rajonit, Banka për Shlyerjet Ndërkombëtare, Këshilli Europian për Pagesat, rregullatorët financiarë vendas, sektori bankar vendas, si dhe institucionet vendase dhe të huaja nga fusha e sektorit të fintekut.

⁸⁹ Shtojca 3. Ekspozimi ndaj rreziqeve klimatike dhe efektet e investimeve të qëndrueshme në rezervat valutore.

Qëllimi Strategjik 5 - Përshtatje ndaj standardeve të Sistemit European të bankave qendrore



Gjatë vitit 2023 vazhduan aktivitetet lidhur me përcaktimin strategjik të Bankës Popullore për të adoptuar praktikat më të mira europiane. Aktivitetet kombëtare të integrimit në BE ishin intensive gjatë gjithë vitit duke marrë pjesë në pjesën e mbetur të fazës së shqyrtimit analitik dypalësh si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE.

Faza dypalëshe e rishikimit analitik me BE-në, e cila filloi në gjysmën e dytë të 2022, vazhdoi gjatë gjithë vitit 2023. Në të njëjtën kohë, përfaqësues nga Banka Popullore morën pjesë në [takimet](#) kushtuar kapitullit 4. Lëvizja e lirë e kapitalit, kapitulli 9. Shërbimet financiare, kapitulli 17. Bashkimi Ekonomik dhe Monetar. Banka Popullore kontribuoi gjithashtu në Kapitullin 8. Politika dhe konkurrenca dhe kapitulli 28. Mbrojtja e konsumatorit. Në grupet punuese u përfshinë edhe përfaqësues të Bankës Popullore për: kapitullin 6. E drejta e shoqërive tregtare, kapitulli 31. Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes dhe kapitulli 33. Dispozitat financiare dhe buxhetore.

Përfaqësuesit e Bankës Popullore morën pjesë në aktivitetet e rregullta në kuadër të procesit të integrimi europian (takimet e rregullta të Nënkomitetit për Çështje Ekonomiko-Financiare dhe Statistika dhe Nënkomiteti për Treg të Brendshëm dhe Konkurrencë, pjesëmarrje në përgatitjen e Programit për reforma ekonomike, si dhe pjesëmarrje në përgatitjen e kontributit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për Raporti vjetor i Komisionit European). Është përgatitur Raporti i rregullt për pjesëmarrjen, rekomandimet dhe aktivitetet e Bankës Popullore në proceset integruese në BE në periudhën tetor 2022 - nëntor 2023, i cili i dorëzohet Këshillit të Bankës Popullore. **Banka Popullore mori pjesë edhe në takimet bilaterale me institucionet e Bashkimit European**, në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësim në Bashkimin European, për temat që lidhen me rregullimin dhe mbikëqyrjen bankare, zgjidhjen e bankave dhe stabilitetin financiar.

Edhe gjatë vitit 2023, u zbatua faza e dytë e [Programit regjional për bankat qendrore të vendeve të Ballkanit Perëndimor II](#), i cili financohet nga BE-ja dhe pritet të zgjasë deri në shtator 2025. Qëllimi i Programit është të forcojë më tej kapacitetet institucionale të vendeve përdorues fundor, veçanërisht duke përmirësuar mjetet dhe politikat e tyre analitike dhe duke transferuar standardet më të mira ndërkombëtare dhe europiane në praktikat kombëtare. Në kuadër të Programit Rajonal, gjatë vitit 2023 janë realizuar 8 trajnime në fushën e: sistemeve të pagesave, tregjeve financiare, politikave monetare dhe hulumtimit, auditimeve të brendshme, mbikëqyrjeve, TI dhe operacioneve të thesarit. Gjithashtu, u realizua praktikë në fushën e statistikave dhe praktikë në fushën e rregullimit bankar dhe zgjidhjes së bankave, si dhe pjesëmarrja në një seminar mbi sistemet e pagesave të nivelit të lartë. Gjatë vitit filloi zbatimi i 3 masave dypalëshe të parashikuara në kuadër të Programit - në fushën e TI-së, kontabilitetit dhe menaxhimit të të dhënave.

KE-ja e aprovoi projektin "Forcimi i kapaciteteve të Bankës Popullore në lidhje me statistikën e jashtme dhe sistemet e pagesave dhe statistikën" i cili synon pajtueshmërinë e mëtejshme me legjislacionin e BE-së dhe përmirësimin e kapaciteteve statistikore duke krijuar një magazinë statistikore dhe duke futur sistem të ri të shlyerjes bruto në kohë reale bazuar në standardin e ri ISO20022⁹⁰.

⁹⁰ Projekti do të financohet nga IPA III dhe do të përfshijë Drejtorinë e Statistikave dhe Drejtorinë e Sistemeve të Pagesave në bashkëpunim me Departamentin e IT.



Transparenca dhe llogaridhënia janë veçanërisht të rëndësishme për Bankën Popullore. Në kuadër të aktiviteteve të saj, Banka Popullore synon hapjen e gjithanshme në punën e saj dhe ndërgjegjësimin për vendimet, masat, vëzhgimet, pikëpamjet dhe vlerësimet e saj, të cilat janë me rëndësi për subjektet ekonomike dhe qytetarët. Gjatë vitit 2023, Banka Popullore ka realizuar aktivitete, projekte dhe ngjarje të shumta për të arritur këtë qëllim strategjik.

Komunikimi me publikun gjithmonë e më shumë, merr rol më të rëndësishëm për të mundësuar zbatimin më të mirë të politikave të stabilitetit monetar dhe financiar, por edhe për kryerjen e aktiviteteve me interes më të madh tek qytetarët, si mbrojtja e konsumatorit, edukimi financiar dhe disponueshmëria e informacionit të nevojshëm për marrjen e vendimeve të duhura financiare. Intensiteti i komunikimit me publikun gjatë vitit 2023 është në nivele të larta. Kështu, në vitin 2023 janë bërë 237 njoftime për publikun përmes mediave, si mjeti më i përdorur i komunikimit. Në të njëjtën kohë, publiku është informuar rregullisht për vendimet e marra nga Këshilli, si dhe vendimet e marra nga KOMP-i, si pjesë e sistemit të vendosur të raportimit të publikut lidhur me masat dhe instrumentet e përdorura nga Banka Popullore për arritjen e qëllimeve të përcaktuara.

Për të shënuar pavarësinë monetare janë regjistruar dhe publikuar 13 video incizime (TË FESTOJMË DENARIN!)⁹¹ i profesorëve, akademikëve, ish-guvernatorëve dhe viceguvernatorëve lidhur me rrugën e zhvillimit dhe arritjet e Bankës Popullore ⁹².

⁹¹ Incizimet e videove janë në dispozicion në kanalin "Jutub" të Bankës Popullore.


⁹² Iniciativa e Vjenës, festimi i Ditës së Muzeve, dhënien e Çmimit Vjetor për Hulumtuesit, organizimi i Klubit të Hulumtuesve.

Në vitin 2023, aktiviteti i Bankës Popullore në mediat sociale vazhdon të rritet, për të transmetuar mesazhe/informacione te brezi i ri i qytetarëve, të cilët zakonisht informohen përmes mediave sociale.



Banka Popullore gjithashtu u angazhua për rritjen e komunikimit të drejtpërdrejtë me mediat. Për këtë qëllim dhe për të kuptuar më mirë mesazhet e Bankës Popullore, u mbajt punëtori për njohjen e gazetarëve me dispozitat e Ligjit të Shërbimeve Pagesore dhe Sistemeve të pagesave, dhe mënyrën e zbatimit të tij. Punëtorja u mbajt në fillim të muajit mars dhe në lidhje me të u publikuan disa materiale në media (portale të internetit dhe TV). Me qëllim të informimit sa më të mirë të publikut për sfidat lidhur me stabilitetin financiar, të cilat u diskutuan në takimin e institucioneve në kuadër të iniciativës së Vjenës, në muajin mars u mbajt edhe takim pune me gazetarë.

Lidhur me fushat dhe temat për të cilat Banka Popullore komunikon me mediat dhe publikun, gjatë vitit, pjesa më e madhe e përmbajtjeve të publikuara mediatike iu dedikuan funksioneve kryesore të Bankës Popullore, që pasqyron në fakt interesin kryesor të komunikimit me publikun dhe interesin e publikut në këto fusha.



Në fillim të qershorit u mbajt punëtori me gazetarë ku u prezantua [veglës për shkarkimin e të dhënave statistikore nga përdoruesit](#), e ndjekur nga informacioni mbi kalendarin e njoftimeve për shtyp dhe përmbledhjet e mediave sociale mbi statistikën e publikuara rishtazi. Në tetor, u mbajt punëtori me gazetarët për të sqaruar mundësinë e re të krahasimit të komisioneve për shërbimet pagesore.



[Funksioni i Strategjisë dhe Rreziqeve Operative](#) si linjë e dytë e mbrojtjes brenda Zyrës së Strategjisë dhe Parandalimit, është përgjegjës për organizimin dhe zbatimin e procesit të planifikimit strategjik. Realizimi i [qëllimeve strategjike](#) dhe misioni dhe grupi i vizionit të Bankës Popullore u zhvillua nëpërmjet [aktiviteteve dhe projekteve programore](#)⁹³. Është raportuar rregullisht për rezultatet e arritura, përmes [raporteve për realizimin e Programit të Punës](#) gjë që mundësoi mbikëqyrjen dhe vlerësimin e rezultateve dhe efektivitetit të masave dhe aktiviteteve të ndërmarra, si dhe më tej **forcimin e transparencës dhe llogaridhënies**. Në prill 2023, Këshilli i Bankës Popullore e miratoi [Raportin e punës së Bankës Popullore për vitin 2022](#) nga i cili është i përbërë [Raporti i realizimit të Programit të Punës në vitin 2022](#)⁹⁴. Në lidhje me projektet e zhvillimit të softuerit, statusi i zbatimit të tyre mbikëqyret rregullisht dhe funksioni i Strategjisë dhe Rreziqet Operacionale raporton për të në seancat e NOIS (**Këshilli mbikëqyrës për sistemin informativ të Bankës**

⁹³ Programi i punës për vitin 2023, përveç formatit të tekstit, u përgatit në formën e prezantimit, i cili u vendos në faqen e BP-së me qëllim rritjen e transparencës dhe njohjen e publikut me aktivitetet e Bankës Popullore për vitin 2023.

⁹⁴ U vazhdua me prezantimin e një pjese të përmbajtjes së Raportit përmes infografikës me qëllim të përmirësimit të mënyrës së informimit për punën e Bankës Popullore dhe afrimit të saj me lexuesin e gjerë.

Popullore⁹⁵). Në pajtueshmëri me [Planin Strategjik 2022-2024](#) Banka Popullore e përpiloi [Programin e Punës së vitit 2024](#). Ai parasheh gjithsej 178 aktivitete, gjegjësisht 120 aktivitete të rregullta programore, 26 projekte nga fusha të caktuara në funksionimin e Bankës Popullore, 8 projekte për organizimin e ngjarjeve dhe 24 projekte për zhvillimin e softuerit. Në interes të publikut të gjerë u përgatit edhe [Prezantimi](#) i Programit të Punës për vitin 2024.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2023 janë shpallur **pasqyrat financiare vjetore** të Bankës Popullore për vitin 2022 (përgatitur në pajtim me SNRF dhe miratuar nga Këshilli i Bankës Popullore) së bashku me opinionin e auditorit të jashtëm të pavarur. **Prokurimi publik** janë kryer në mënyrë transparente dhe me kohë për funksionimin dhe funksionimin pa probleme të Bankës Popullore, duke pasur parasysh përdorimin racional të mjeteve të Bankës Popullore. Vëmendje e veçantë i është kushtuar veprimit transparent, nxitjes së konkurrencës dhe mundësisit të trajtimit të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, si parime bazë të këtij procesi, të përcaktuara me ligj.



Muzeu i Bankës Popullore zhvilloi aktivitetet e saj aktuale lidhur me proceset e punës lidhur me punën profesionale muzeale, por në të njëjtën kohë u përgatitën intensivisht dhe një sërë [aktivitetesh edukativo-muzeale](#). U përgatit broshurë e re interaktive për fëmijët e moshës shkollore “Detektivi i Muzeut” dhe fletushka edukative, fletore dhe lapsa për fëmijët e moshës shkollore. Në proces shtypjeje është publikimi⁹⁶ nga paneli i vitit të kaluar mbi këtë temë “Vlefshmëria dhe vlerat” në Muzeun e Bankës Popullore, që u organizua për nder të kremtimit të 30-vjetorit të pavarësisë monetare. Katalogu profesional i muzeut “Monedhat e Argeadëve” nga Koleksioni Numizmatik i NBRSM u promovua me sukses, si dhe punimin hulumtues “Mesjeta: lajmëtarja e sistemit monetar të mirëorganizuar” („The Middle Ages: the Precursor to a Well-organised Monetary System”) në konferencën e 4-të të Muzeut të Bankës së Shqipërisë, e cila u mbajt më 8 shkurt 2023. Muzeu i Bankës Popullore u vizitua rregullisht nga vizitorë vendas dhe të huaj, duke promovuar kështu trashëgiminë numizmatike për publikun e gjerë.



Biblioteka e Bankës Popullore si **bibliotekë e specializuar në shtet** pasuron vazhdimisht fondin me botime të reja dhe aktuale të botuara nga botues eminentë të huaj dhe vendas dhe me botime të autorëve emra të shquar në fushën e shkencës ekonomike. Kështu, gjatë vitit 2022, fondi i bibliotekës u pasurua me literaturë profesionale nga tituj periodikë dhe monografikë të autorëve të huaj dhe vendas dhe me botimet më të fundit të bankave qendrore të vendeve të tjera dhe institucioneve e organizatave ndërkombëtare. Katalogimi dhe regjistrimi i rregullt në aplikacionin e bibliotekës dhe në COBISS.MK kontribuan në disponueshmëri më të madhe të literaturës profesionale si për punonjësit e Bankës Popullore ashtu edhe për përdoruesit e jashtëm. Gjithashtu është arritur bashkëpunimi me BKU “Shën Klimenti i Ohrit” për katalogimin e botimeve serike. **Fondi i arkivës** u pasurua me material arkivor të digjitalizuar nga veprimtaria e Bankës Popullore dhe me materiale që plotësojnë koleksionet me materiale arkivore konvencionale. Gjatë muajit tetor është nënshkruar memorandum

⁹⁵ NOIS-i përcakton drejtimit dhe prioritetet strategjike në fushën e teknologjisë së informacionit dhe të sigurisë së sistemit informativ të Bankës Popullore, mbikëqyr zhvillimin dhe zbatimin e planeve strategjike për sigurinë e sistemit të informacionit, shqyrton dhe miraton rregulloren e brendshme për zbatimin e politikës së sigurisë së sistemit të informacionit, i prioritetëve dhe investimeve të mëdha në teknologjinë e informacionit, mbikëqyr statusin e projekteve kryesore të TI-së dhe analizon dhe miraton kërkesat për përjashtime nga Politika e Sigurisë së Sistemit të Informacionit. Mënyra e punës së NOIS-it rregullohet me rregulloren e punës.

⁹⁶ Përmbledhje e përbashkët e eseve akademike në fushën e ekonomisë, kulturës, artit.

bashkëpunimi me Arkivin Shtetëror të RMV-së dhe janë mbajtur disa takime për të përcaktuar bashkëpunimin në të ardhmen.

Qëllimi Strategjik 7 – Edukim financiar dhe përfshirja



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut vazhdoi me aktivitete për mbikëqyrje e sjelljes së bankave dhe kursimoreve në treg dhe promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve të shërbimeve financiare. në fund të marsit 2023 u miratua **Qarkore për mbrojtjen e konsumatorëve – përdorues të shërbimeve financiare nga sektori bankar**. Qarkori⁹⁷ përmban praktika të mira në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit, që synojnë marrëdhënie të drejta dhe transparente, bazuar në informacione të qarta dhe të kuptueshme për produktet dhe shërbimet e ofruara nga bankat. Gjithashtu, është përgatitur një pasqyrë krahasuese për çmimet e shërbimeve që lidhen me llogarinë e pagesave që bankat ofrojnë për klientët e tyre privatë. Gjatë vitit 2023, Banka Popullore, së bashku me rregullatorë të tjerë financiarë, ka punuar në përgatitjen e Projektligjit për Avokatin e Popullit Financiar/Arbitër.

Gjatë vitit 2023 janë kryer dy kontrollet e para në terren në fushën e mbrojtjes së konsumatorit. Në të njëjtën kohë, Banka Popullore ka pranuar gjithsej 198 ankesa për funksionimin e bankave dhe kursimoreve përmes postës dhe postës elektronike, kryesisht të udhëhequra nga grupi i bankave të mëdha. Kjo përfaqëson rritje prej 60% në vitin 2023 kundrejt vitit 2022. Rritjen më të madhe e kanë shënuar ankesat në fushën e arkëtimit të tarifave për llogaritë e pagesave bankare.

Në vitin 2023, Banka Popullore vazhdoi me aktivitete të intensifikuara në fushën e edukimit financiar, përmes të cilave kontribuon në rritjen e edukimit financiar dhe përfshirjes financiare të popullsisë në vendin tonë, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbrojtjes së konsumatorëve të shërbimeve financiare. Në kuadër të “Ditëve të edukimit financiar” përfaqësuesit e Bankës Popullore morën pjesë në ngjarje dhe programe publike të mediave publike për promovimin e aktiviteteve në fushën e edukimit financiar.

⁹⁷ Qarkorja është përgatitur mbi bazën e standardeve ndërkombëtare, direktivave dhe praktikave europiane për mbrojtjen e konsumatorit, duke marrë parasysh karakteristikat e sistemit bankar vendas dhe rregulloren bankare.

Organizimi i ngjarjeve në fushën e edukimit financiar

JAVA GLOBAL E PARAVE


Kuiz edukativ për nxënës të një shkolle të mesme ekonomike, **leksion virtual** për studentë të një fakultet dhe **9 leksione për shkolla nga zona të ndryshme rurale të vendit**.

391 EKIPE NGA 76 SHKOLLA

Në garën kombëtare morën pjesë **391** ekiye nga **76** shkolla, që tregon për interesimin e madh tek të rinjtë për të marrë pjesë në këtë konkurs. Skuadra fituese përfaqësoi vendin tonë në finalen e Europës në Bruksel të Belgjikës.

KUIZI EUROPIAN I PARAVE

Finalja e garës kombëtare **"Kuizi european të parave"** (në bashkëpunim me Shoqatën e Bankave të Maqedonisë, KLV-në dhe me mbështetjen e Ministrisë së Financës dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës).



KONKURSI I STUDENTËVE ME RASTIN E DITËS SË KURSIMIT

Në konkursin e rregullt për nxënës të shkollave fillore me temë: **"Kursoj me zgjuarsi - jetoj më mirë: investoj në të ardhmen time"** erdhën gjithsej **325** punime studentore, nga të cilat **54** ishin vepra letrare - poezi, **50** vepra letrare – tregime dhe **221** vepra artistike – vizatime.

Konkursi i shpallur për nxënësit e shkollave të mesme në temën e dhënë: **"Kursimi - hap drejt pavarësisë financiare"**, arritën **50** ese. Ndarja e diplomave për studentët e shpërblyer u bë në Bankën Popullore më 27 nëntor 2023.

DITËT E EDUKIMIT FINANCIAR

Edicioni i shtatë i "Ditëve të edukimit financiar" u zhvillua nga data 21 deri më 23 nëntor 2023 në organizim të institucioneve rregullatore financiare dhe në bashkëpunim me sektorin financiar privat. Banka Popullore bëri thirrje publike për të gjithë qytetarët e interesuar që të marrin pjesë në prezantime edukative përmes video-konferencës me temat e mëposhtme:

- Edukim financiar për nxënësit e shkollave të mesme;
- Politika monetare e Bankës Popullore;
- Informacioni i nevojshëm gjatë zgjedhjes së kredisë;
- Referimi në Ligjin e Shërbimeve Pagesore dhe Sistemeve të pagesave, dhe
- Struktura e sistemit financiar dhe referenca e lëvizjeve në sistemin bankar.

Interesimi më i madh për të vizituar Bankën Popullore ka pasur në periudhën tetor - dhjetor ku vizitorët e Bankës Popullore patën mundësinë të vizitojnë Muzeun e Bankës Popullore dhe për të parë koleksionin e pasur numizmatik të monedhave që janë përdorur në territorin e vendit tonë gjatë shekujve e deri më sot.



Në prill të vitit 2023, Banka Popullore publikoi broshurë të posaçme informative për qytetarët për t'i informuar ata për mundësitë e hapjes dhe përdorimit të llogarisë së pagesave me funksione bazë me titull: "[Llogaria pagesore me funksione bazë](#)". Në muajin europian të sigurisë kibernetike - tetor, Banka Popullore për sqarimin e avantazheve dhe rreziqeve rreth shërbimeve financiare digjitale, si dhe masat paraprake që qytetarët duhet të marrin për të zbutur ose eliminuar pasojat e padëshiruara, thuhej në broshurë "[Siguria gjatë përdorimit të produkteve dhe shërbimeve financiare digjitale](#)".



Në vitin 2023, aktivitetet për zbatimin e [Strategjisë për edukim financiar dhe përfshirje financiare e Republikës së Maqedonisë së Veriut 2021-2025](#). Janë mbajtur dy takime pune të Grupit Punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Strategjisë me përfaqësues nga rregullatorët financiarë, sektorin privat dhe civil, me qëllim ndërmarrjen e aktiviteteve të koordinuara për rritjen e edukimit financiar dhe përfshirjes financiare, si dhe rritjen e mbrojtjes së konsumatorëve të shërbimeve financiare. Në të parën nga dy takimet mori pjesë një përfaqësues i Rrjetit Ndërkombëtar për Edukim Financiar në Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (INFE – OECD), i cili paraqet rezultatet e një ankete të realizuar në vitin 2022 mbi edukimin financiar të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (MSME) në Europën Juglindore (EJL). Raporti, i titulluar "Shkëlqimi financiar dhe digjitalizimi për MSME-të në EJL-së: Vegla për rritjen e kapaciteteve të pronarëve dhe menaxherëve" është përgatitur në kuadër të projektit rajonal të INFE - OECD dhe Ministrisë së Financave të Holandës. Në takimin e dytë gjatë vitit 2023, ishte i pranishëm edhe një përfaqësues i Ministrisë së Financave të ShBA-së, i cili përcolli përvojën e aktiviteteve të kryera në fushën e edukimit financiar, përfshirjes dhe mbrojtjes së konsumatorëve në ShBA dhe më gjerë. Në pajtueshmëri me dispozitat e Strategjisë, janë forcuar edhe aktivitetet në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve.

Për shkak të përforcimit të edukimit financiar të popullsisë, Banka Popullore ndërmerr iniciativa dhe aktivitete të ndryshme ndër të cilat është edhe mbështetja përmes përgatitjes së studentëve tanë si përfaqësues të Olimpiadës Ekonomike Ndërkombëtare, përmes mbajtjes së një sërë leksionesh për studentët në ambientet e Bankës Popullore. Këto leksione janë në pajtim me Memorandumin e nënshkruar të Bashkëpunimit në fushën e edukimit financiar, për nevojat e Olimpiadës Ekonomike Ndërkombëtare, ndërmjet Bankës Popullore dhe Unionit të Matematikanëve. Qëllimi i bashkëpunimit me Unionin është zbulimi, mbështetja dhe inkurajimi i frymës konkurruese të studentëve me talent dhe njohuri të veçanta në fushën e ekonomisë, financës dhe biznesit.

Në shtator të vitit 2023, në Bankën Popullore u mbajt takim me Unionin e Nxënësve të Shkollave të Mesme. Përfaqësuesit e Unionit theksuan edukimin financiar si një nga prioritetet e nxënësve të shkollave të mesme, duke theksuar nevojën për futjen e edukimit financiar në procesin formal arsimor. Takimi me Unionin e gjimnazistëve është pjesë e përkushtimit të përgjithshëm të Bankës Popullore për edukimin financiar të të rinjve, prandaj rregullisht zhvillohen disa aktivitete për nxënësit e shkollave të mesme. Për këtë qëllim, Banka Popullore ka ofruar mbështetje përmes një ligjërate të përshtatshme edukative për nxënësit e një shkolle të mesme në përgatitje për pjesëmarrjen e ekipit në aktivitetin edukativ "Kam një mendim!" i Institutit Parlamentar, i cili paraqet procesin e shqyrtimit të një projektligji në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Tema për të cilën përgatiteshin nxënësit ishte: "Studimi i edukimit financiar në shkollat e mesme si parakusht për ndërtimin e qytetarëve aktivë".

Gjatë vitit, Trupi Koordinues i Rregullatorëve Financiar për Edukimin Financiar dhe Përfshirjen Financiare, i udhëhequr nga Banka Popullore, mbajti një takim pune me përfaqësuesit e Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, gjatë të cilit u përcaktua qasja në lidhje me shqyrtimin e përfaqësimit aktual të financave të edukimit në procesin arsimor, për të cilin do të punohet në periudhën e ardhshme.

Në nëntor 2023 filloi zyrtarisht faza e dytë e projektit rajonal të edukimit financiar të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe Rrjeti i tij Ndërkombëtar për Edukimin Financiar (INFE), i zbatuar me mbështetjen financiare të Ministrisë së Financave të Holandës, i cili do të zhvillohet në periudhën 2023 - 2027. Prioriteti kryesor i fazës së dytë është të mbështesë vendet për të përmirësuar nivelin e edukimit financiar të popullsisë së tyre duke mbështetur përcaktimin dhe zbatimin e strategjive kombëtare për edukimin financiar, duke prodhuar analiza, raporte dhe rekomandime për ngritjen e kapaciteteve të përshtatura me nevojat përkatëse institucionale dhe prioritetet strategjike. Gjatë vitit 2023, nisën aktivitetet përgatitore për pjesëmarrje në projektin pilot të mbështetur nga BERZh-i në vend, që synon mbështetjen e sipërmarrjes femërore dhe përfshirjen financiare të grave sipërmarrëse.



Banka Popullore i kushton shumë vëmendje **rritjen e ndërgjegjësimit për ndryshimet klimatike**, si dhe “**rritja e gjelbër**” dhe financimi i saj për shkak të **arritjes së ekonomisë së qëndrueshme të gjelbër**. Në tremujorin e tretë të 2023, u miratua i **Plani afatmesëm i parë për aktivitetet e Bankës Popullore në fushën e menaxhimit të rreziqeve që lidhen me ndryshimet klimatike për periudhën 2023 - 2025**. Ky plan përcakton një kuadër gjithëpërfshirës, sistematik dhe konsistent për aktivitetet që lidhen me menaxhimin e rrezikut nga ndryshimet klimatike, dhe me zbatimin e tij pritet një kuptim më i mirë i rreziqeve klimatike, përfshirja e tyre në analizat e sistemit bankar dhe politikës monetare, si dhe përmirësimi i potencialit të sistemit bankar për të mbështetur kalimin drejt ekonomisë së gjelbër dhe të zhvillimit të qëndrueshëm.

Efektet e ndryshimeve klimatike prekin të gjitha sferat sociale, duke përfshirë financat, kjo është arsyeja pse një numër në rritje i bankave qendrore përfshijnë në mandatin e tyre aktivite për t'u marrë me ndryshimet klimatike dhe për të mbështetur tranzicionin e gjelbër. **Banka Popullore njeh rëndësinë e rreziqeve klimatike, si për ekonominë në tërësi, ashtu edhe për sistemin financiar** dhe në kuadër të kompetencave të veta, vitet e fundit ka punuar në mënyrë aktive në këtë fushë, duke përfshirë financat e gjelbra në synimet strategjike të Bankës Popullore, anëtarësim aktiv në rrjet ndërkombëtar të bankave qendrore dhe rregullatorëve, duke vendosur të dhëna të rregullta mbi financat e gjelbra, si dhe ndryshimet në instrumentet monetare për të mbështetur financimin e qëndrueshëm.

Duke filluar me zbatimin e këtij plani afatmesëm, Banka Popullore miratoi **Udhëzimet se si të menaxhohen rreziqet që lidhen me ndryshimet klimatike nga bankat** dhe i zbatoi **analizat e para të ekspozimit të sistemit bankar ndaj rreziqeve fizike dhe të tranzicionit të shkaktuara nga ndryshimet klimatike dhe politikat klimatike**. Përmes zbatimit të mëtutjeshëm të aktiviteve nga plani, Banka Popullore do të forcojë edhe qasjen mbikëqyrëse, me përfshirje graduale aktive të rreziqeve klimatike në vlerësimin e profilit të rrezikut të bankave individuale. Duke marrë parasysh rëndësinë e qëndrueshmërisë së sistemit financiar ndaj rreziqeve që lidhen me ndryshimet klimatike, banka qendrore do të thellojë dhe avancojë analizat e ndikimit të këtyre rreziqeve në sistemin bankar dhe të krijojë një kuadër për kryerjen e testeve të stresit. Plani thekson gjithashtu rëndësinë e koordinimit të aktiviteve në vend dhe nevojën e bashkëpunimit me institucionet dhe organet e tjera shtetërore, duke pasur parasysh se çështjet klimatike kërkojnë qasje të koordinuar kombëtare.

Gjatë vitit 2023, **Banka Popullore ka marrë pjesë në mënyrë aktive në punën e rrjetit ndërkombëtar për sistemin financiar të gjelbër (NGFS)**, në veçanti grupet e investimeve të qëndrueshme dhe zbulimit të investimeve të qëndrueshme, duke forcuar kështu kapacitetin e brendshëm për të përmirësuar kornizën për matjen e rreziqeve dhe avantazheve dhe disavantazheve të krijimit të një portofoli të veçantë të obligacioneve të gjelbra. Në të njëjtën kohë, rregullisht mbikëqyrën përvojat e bankave qendrore që janë anëtare të rrjetit për gjelbërimin e sistemit financiar (NGFS) në fushën e menaxhimit të portofolit dhe mënyrën e integritetit të treguesve të qëndrueshmërisë.

⁹⁸ Shtojca 3. Ekspozimi ndaj rreziqeve klimatike dhe efektet e investimeve të qëndrueshme në rezervat valutore.

Qëllimi Strategjik 9 - Forcimi i udhëheqjes me rreziqet në nivel të Bankës Popullore



Menaxhimime rrezikun është element i domosdoshëm i [menaxhimit korporativ](#) të mirë i cili kontribuon në realizimin efikas dhe efektiv të synimeve të përcaktuara strategjike, mandatit dhe vizionit.

Rreziqet financiare⁹⁹ ndaj të cilave është e ekspozuar Banka Popullore, në pjesën më të madhe janë në sferën e investimeve të rezervave valutore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe mund të rrjedhin edhe nga realizimi i operacioneve monetare¹⁰⁰.

Ekspozimi i Bankës Popullore ndaj [rreziqeve operacionale](#) është mbikëqyrur dhe raportuar rregullisht dhe u zbatuan në mënyrë aktive masat e vendosura, të cilat synojnë të sigurojnë reduktimin e rreziqeve të mundshme operacionale. Vlerësimi i thelluar vjetor i rreziqeve operacionale mbikëqyr profilin e rrezikut të Bankës Popullore në lidhje me rreziqet operacionale, si dhe strategjitë dhe masat për përballimin e rreziqeve operacionale për t'u mbrojtur nga ngjarjet që mund të ndikojnë në arritjen e qëllimeve, rezultatin financiar dhe reputacionin e Bankës Popullore. Komiteti i menaxhimit të rrezikut operacional rregullisht çdo gjashtë muaj dhe çdo vit e informoi Këshillin e Bankës Popullore për ekspozimin ndaj rreziqeve operacionale. Banka Popullore është duke punuar vazhdimisht në përmirësimin e kapaciteteve për menaxhimin e rreziqeve operative dhe zbatimin e praktikave më të mira ndërkombëtare¹⁰¹. Rregullisht ndërmerren aktivitete për të përmirësuar procesin e menaxhimit të rrezikut operacional, për të rritur ndërgjegjësimin e punonjësve për menaxhimin e rrezikut operacional dhe kulturën e rreziqeve në operacionet e përditshme përmes konsultimeve të vazhdueshme me punonjësit.

